



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI

“Auditimin e Përputhshmërisë”

Bashkia Tropojë

TIRANË, shkurt 2026

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4-8
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	8-10
II. HYRJE	10
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit	11
2. Identifikimi i çështjes:	11
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditor:	11
4. Përgjegjësia e edituesve të KLSH:.....	11-12
5. Kriteret e vlerësimit:.....	12-13
6. Standardet e auditimit	13
7. Metodologjia e auditimit	13-14
8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:.....	14
III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT	14
1. Informacion i përgjithshëm	14-15
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT	15-112
2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	15-29
2.2. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....	29-82
2.3. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.....	82-91
2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.....	91-102
2.5. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).....	102-111
2.6. Të ndryshme të dala gjatë auditimi.....	111-112
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME	112-130

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

a. Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit Nr.777/1 Prot Tiranë, më 17.07.2025, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Bashkinë Tropojë, për periudhën 01.01.2023 deri me datën 31.12.2024.

Bashkia Tropojë ka funksionuar sipas strukturës organizative sipas vendimit të Kryetarit të Bashkisë dhe Miratimi i Strukturës për vitin 2024 me VKB-në nr.60 datë 22.12.2023, “Për miratimin e strukturës organizative” konfirmuar nga Prefekti me nr.3/2 datë 14.01.2024. Buxhetin e vitit 2024, është miratuar me VKB-në nr.60 datë 22.12.2023. si dhe është konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Kukës me shkresën nr.3/1 datë 14.01.2024. Në total të ardhurat konstatohen në vlerën 463,142 mijë lekë dhe shpenzimet në vlerën 463,142 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Tropojë administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit, për të siguruar qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Bashkia Tropojë me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë do të jepet një vlerësim objektiv, profesional e i pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme::

- planifikimi, zbatimi e monitorimi i planit të buxhetit.
- funksionimi i kontrollit të brendshëm financiar.
- planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.
- administrimi i pronës publike
- organizimi dhe funksionimi i planifikimit dhe zhvillimit të territorit
- organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit
- realizimi i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimi i kontratave të punimeve

Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave. nga audituesit gjatë auditimit:

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike të kampionuara ose në tërësi sipas rastit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

e. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Tropojë për periudhën në auditim, paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 28 gjetje dhe ka dhënë 28 rekomandime nga të cilat 17 masa organizative, 5 masa shpërblim dëmi dhe 6 masë për eliminimin e efekteve financiare negative.

2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore.

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Tropojë për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar në 28 gjetje dhe janë lënë 28 rekomandime. Në vijim paraqiten ato më kryesoret:

Gjetjet kryesore:

- Nga auditimi i 5 procedurave të prokurimit të përzgjedhura nga prokurimet e vitit 2023, rezultoi se në 3 raste. Burimi i financimit: janë të ardhurat e Bashkisë Tropoje, vlera e pritshme kontratës së punimeve do të shlyet në periudhën e 2 ose 3 viteve, miratuar edhe me Vendim të Këshillit Bashkiak. Kontratat e lidhura me OE shpallur fitues, afatin e realizimit të kontratës është nga 1 muaj deri në 12 muaj dhe sipas nenit 3 të kontratës shlyerja e detyrimit bëhet me ekzekutimin e punimeve.

- Nga auditimi i 11 procedurave të prokurimit të përzgjedhura, u konstatuan mangësi sa i takon hartimit të kriterëve të kualifikimit dhe konkretisht: aplikimi në mënyrë të gabuar i masës së vlerës për paraqitjen e punëve të ngjashme, në të gjitha rastet; në 2 raste për procedurat e prokurimit vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, nuk përputhet me natyrën dhe volumin e punës të prokuruar; në 1 rast, kërkesa për disponimin e mjeteve nuk argumentohet se mbulon të gjithë zërat e punimeve lidhur për objektin që prokurohet; në 1 rast, kërkesa për posedimi i certifikatave ISO është e pa azhurnuar pasi OE duhet të disponojnë/paraqesin edhe certifikatën për standardin e përditësuar (ISO 45001-2023); në 1 rast, vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit, nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, janë kërkesa në mospërputhje pasi për punimet sipas licencës NP.1A nuk është kërkuar që OE të disponojë drejtues teknik Inxhinier Ndërtimi, kërkesë e zërave të punimeve përcaktuar në zërin e licencës; në 1 rast, vendosja e kriterëve të Licencës në kategorinë NS-18 A kjo e përcaktuar edhe nga karakteristikat dhe llojin e punimeve të parashikuara në preventiv nuk ishte shoqëruar edhe me disponimin e Inxhinier Topograf (ose gjeodet); në 1 rast, vendosja e kriterëve për disponimin e 3 tre punëtorë (specialistë dhe të thjeshtë) nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, nuk është e përcaktuar qartë ndarja midis punëtorëve të thjeshtë ose punëtorëve specialistë për të mundësuar një konkurrencë të drejtë dhe deklarim sa me real të disponibiliteteve të pjesëmarrësve në konkurrim.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit me vlera të vogla u konstatua: Titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim. Konstatohet se nuk është mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim si dhe nuk është dokumentuar me foto dhe dokumenta të tjerë vërtetues kryerja e procedurës së prokurimit.

- Referuar faturës së lëshuar e cila në këtë rast ka vlerën e kontratës, nuk ka respektuar grafikun i punimeve sipas dokumenteve të tenderit ku parashikohet si afat 1 muaj për realizimin e procedurës.
- Nga AK nuk është vendosur si kriter kualifikues fuqia punëtore dhe mjete pune duke qenë se, procedura e prokurimit është “Furnizim Vendorsje”.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurat e prokurimit, u konstatua: nga komisioni për blerjet e vogla nuk janë mbajtur në procesverbal treguesit e çmimeve për përcaktimin e fondit limit; Nga komisioni për blerjet e vogla nuk është mbajtur një procesverbal ku të argumentohen specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për këtë procedurë; Nga AK është vendosur në DST si kriter kualifikues “Afati i lëvrimit të mallit do të jetë 24 orë, duke filluar nga momenti i publikimit në Sistemin Elektronik të njoftimit të fituesit”. Ky kriter nuk është argumentuar dhe ka qenë penalizues për operatorët ekonomikë që janë shpallur fitues, duke i detyruar të tërhiqen nga kjo procedurë për arsye të pamjaftueshmërisë së kohës për realizimin e saj.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit: Nga Komisioni për Blerjet e Vogla nuk është mbajtur një procesverbal ku të argumentohet teknikisht dhe ligjërish vendosja e specifikimeve teknike; Nga evidencat e marra nga auditimi rezulton se, Ing.E.M. dhe Tek.M.V. nuk janë të pajisur me licencën e projektimit.
- Nga auditimi i prokurimeve me vlerë të vogël u konstatua se Autoriteti Kontraktor Bashkia Tropojë, në vitin 2023 ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, duke u nisur nga ngjashmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokurtoheshin bashkë nëpërmjet procedurës “E hapur e thjeshtuar”.
- Nga auditimi dokumentacionit të Sektorit të Pronave në Bashkinë Tropojë rezulton se nuk ka regjistër me të dhënat dhe modalitetet për secilën pronë të paluajtshme shtetërore. Për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë. Gjatë vitit 2024, nga titullari i Bashkia Tropojë nuk janë ngritur grupe pune për administrimin dhe monitorimin e aseteve. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Tropojë dhe Njësi Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë kontabilizuar në bilancin përkatës të bashkisë. Përgjatë vitit 2024, Sektori i Pronave dhe Hartografisë si dhe Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Tropojë nuk kanë certifikuar asnjë pronë, si dhe nuk kanë aplikuar në DVASHK Kukës për regjistrim të aseteve të bashkisë.
- Nga auditimi dokumentacionit të kontratave të qirasë lidhur nga Bashkia Tropojë gjatë vitit rezulton se nuk është ngritur njësi e monitorimit të kontratave të qirasë, e cila pas lidhjes së kontratës bën dorëzimin të qiramarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Gjithashtu konstatohet se, nuk është mbajtur procesverbal për dorëzimin e ngastrave subjektit qiramarrës.
- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se: dy raste, dokumentacioni teknik dhe shoqëruar i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë; në një rast, objekti i miratuara nuk respekton kondicionet urbane, siç është lartësia minimale dysheme -dysheme e lejuar për përdorim shërbimi; në dy raste, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Tropojë, jo gjithmonë ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; në dy raste, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Tropojë ka miratuar leje ndërtimi në njësi strukturore në të cilat nuk lejohet të ndërtohen.
- Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur nga Kryeinspektori i IMT Tropojë, blloqet e vendimit të prishjes u konstatua se, nga 20 raste gjithsej në 8 raste, nga Kryeinspektori i IMT-së Tropojë nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm“, që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishje, vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Tropojë. Në 7

raste, nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Prishje e Objektivit të Kundërligjshëm”; në 2 raste, nuk është vijuar procedura me nxjerrjen e vendimit për “Pezullimin e Punimeve”; në 5 raste, nuk ka vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm”, nuk është bërë kallëzim penal për subjekte që kanë kryer ndërtime informale pa leje ndërtimi; Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga IMT gjatë viteve 2023-2024, në 20 raste nga 20 kontrole të kryera, kundërvajtja e konstatuar nga IMTV Tropojë nuk është dokumentuar me fotografi ose video si dhe nuk është hapur dosje individuale për secilën praktikë apo subjekt.

- të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit për punime të pa kryera në vlerën 5,583,541.50 lekë: Në lidhje me objektin “Rikonstrukcion i rrugës së fshatit “Kasaj””; me objektin “Rikonstrukcion i shkollës 9-Vjeçare Beslidhja e Malësisë””; Në lidhje me objektin “Rikonstrukcion sistemim asfaltim rruga Bukovë-Qendër Luzhë””; Në lidhje me objektin “Sistemim asfaltim i lagjes Dardania”, me objekt: “Blerje mobilje për sallën e muzeut”.
- Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë të Taksave vendore u konstatua se: ushtrimi i aktivitetit gjatë vitit 2024 të subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore, ka sjell të ardhura të munguara për Bashkinë Tropojë në vlerën prej 5,201,096 lekë; Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018 , e ndryshuar.
- Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë të Taksave vendore u konstatua se për Bashkinë Tropojë, konstatohet se nga drejtoria e PZHT, nuk është ndërmarrë asnjë masë, qoftë edhe komunikim shkresor me ASHK-në, për tu informuar dhe për të përditësuar regjistrat për ndërtimet të cilat janë legalizuar vitet e fundit, me qëllim vjeljen e taksës.
- Nga auditimi i administrimit të pronave u konstatua se Bashkia Tropojë ka dhënë me qira ish Hotelin e punëtorëve për banesa sociale ku ka lidhur 15 kontrata qiradhënie. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arkëtimet për këto 15 kontrata qiraje rezultoi se, në fund të vitit 2024 janë debitorë 3 familje në vlerën 81,600 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit, rezultoi se në 2 raste janë skualifikuar operatorë ekonomikë të cilët kanë patur mangësi të ngjashme me operatorë të tjerë, të cilët edhe pse me të njëjtat mangësi, janë shpallur fitues, kryesisht sa i takon vetëdeklarimeve.

Rekomandimet më kryesore: Për përmirësimin e situatës që lidhen me sistemimet përkatëse në llogaritë kontabël, për mangësitë e konstatuara, masat për arkëtimin e debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore, masa për shmangien e mangësive të konstatuara në procedurat e prokurimeve dhe lejeve të ndërtimit, etj si vijon:

- Autoriteti Kontraktor në prokurimin e fondeve të marrë masa, që për rastet kur financimi parashikohet të realizohet në më shumë se një vit buxhetor, përpara shpalljes së fituesit dhe lidhjes së kontratave, të përcaktojë në kontratë një nen të posaçëm ku të specifikohet qartë mënyra e financimit dhe pagesës, përfshirë pagesat me këste, afatet përkatëse, si dhe lidhja e tyre me planin buxhetor/vjetor apo afatmesëm të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
- Njësia e prokurimit, gjatë përcaktimit të kriterëve të kualifikimit, të marrë masa që ato të mos kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, duke argumentuar kërkesat jo vetëm në funksion të objektivit të prokurimit, por edhe sipas zërave të preventivit dhe specifikimit përkatës nga ekspertët e fushës rast pas rasti.
- Nga Titullari i Bashkia Tropojë të merren masa në vijimësi që, për çdo procedurë prokurimi të nxirret urdhër për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim edhe për procedurat e prokurimit me mjete elektronike për punë, mallra dhe shërbime.

Komisioni për blerjet e vogla Bashkia Tropojë në vijimësi, për çdo procedurë prokurimi duhet të listojë treguesit e çmimeve në përcaktimin e fondit limit. Komisioni për blerjet e vogla të marrë masa që hartimi i kriterëve në vijimësi të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht dhe sipas udhëzimeve të APP.

- Bashkia Tropojë të marrë masa që në të ardhmen për çdo projekt zbatimi, të hartohen nga Inxhinierë të pajisur me licencën përkatëse për projektim, ose në mungesë të inxhinierëve të licencuar, projektet e zbatimit t'i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik, duke siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në regjistrin e parashikimeve të bëhen përcaktime të sakta, që mallrat apo shërbimet me natyrë të njëjtë nuk duhet të prokurohen veçmas, në mënyrë që të shmanget copëzimi i fondit të prokurimit.

- Titullari i Bashkisë Tropojë duhet të ngrëjë menjëherë një grup pune për verifikimin në terren dhe përditësimin e statusit të të gjithë aseteve që kjo bashki ka në administrim, sëbashku me njësitë administrative. Grupi i punës duhet të përditësojë listën e inventarit dhe ta nisi për miratim në organet përkatëse. Në vijimësi për çdo aset të përfshirë në listën e inventarit, duhet të aplikohet pranë DVASHK Kukës për marrjen e certifikatës së pronësisë.

- Titullari i Bashkia Tropojë të ngrëjë menjëherë një grup pune për monitorimin e kontratave të qirave që administrohen nga kjo bashki dhe njësitë administrative. Grupi i punës duhet të raportojë për monitorimin e të gjithë kontratave ekzistuese.

Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Tropojë, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi: të shqyrtojnë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore; të merren të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Specifikisht, miratimi i lejeve të ndërtimit të bëhet vetëm pas marrjes së mendimit pozitiv nga DV ASHK (statusin juridik të pronave në zhvillim ose kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën); të merren të gjitha masat për të respektuar të gjitha kufizimet ligjore që janë vendosur në njësitë strukturore, kufizime të cilat duhet të jenë të padiskutueshme; Të miratoj vetëm ato leje të cilat përmbushin kriteret që janë të lejuara në njësinë strukturore përkatëse.

Kryeinspektori IMT-së Bashkia Tropojë, të nxjerrë Urdhër Ekzekutimi për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për subjekte që janë me Vendim për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm".

Kryeinspektori IMT-së Bashkia Tropojë, në çdo rast të konstatimit të ndërtimeve pa dokumentacion tekniko ligjor të nxjerrë menjëherë Urdhër për pezullimin e punimeve të ndërtimit; në vijimësi të nxjerrë Vendim për prishjen e objekteve të kundërligjshëm brenda afatit 10 ditor nga data e mbajtjes së akt konstatimeve dhe në të gjitha rastet kur konstatohen punime pa leje ndërtimi për banesa apo njësi shërbimi, të referohen me kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës; të marrë masa të menjëhershme që për çdo subjekt të konstatuar në shkelje të krijojë dosje personale dhe shkeljet të dokumentohen me foto dhe video si dhe dokumente të tjera vërtetuese; të marrë masa të menjëhershme që të pajiset me blloqet zyrtare për mbajtjen e konstatimeve sipas standarteve kombëtare; të kryejë kontrolle në subjektin më sipër duke marrë dhe masa administrative sipas rastit.

- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës 956,587.5 lekë pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria OE "N." ShPK; të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **3,051,619 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria BOE

“M./S” ShPK & “N.” ShPK; të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **778,512 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria OE “SH.” ShPK; të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **621,823 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria OE “Z.” ShPK.

- Nga Titullarit të njësisë publike Bashkisë Tropojë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme, në vlerën **175,000 lekë** si penalitet për vonesën e dorëzimit të mallrave nga Subjekti “K.B.”

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, nga subjektet: “P.” në vlerën 480,000 lekë, “A.A” në vlerën 800,000 lekë, “H.I” në vlerën 900,000 lekë, “S.” (L.Dardania) në vlerën 800,000 lekë, “S.” (Sopot) në vlerën 721,096 lekë, “E.O.” në vlerën 900,000 lekë, “D.-O” në vlerën 900,000 lekë si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve. Bashkia Tropojë të ndërpresë praktikën e hartimit të aktmarrveshjeve për pagesën me këste të detyrimit të për paisjen me autorizim për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë.

- Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, në bashkëpunim me Administratorët e Njësisë Administrative, të marrin masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2024, rezultojnë 13,030,000 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Tropojë, të marrin masa konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjorë të parashikuar për mbledhjen me forcë të detyrimeve të papaguara me qëllim uljen e borxhit nga taksat dhe tarifat vendore.

- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja që janë legalizuar.

- Sektori i Pronave në bashkëpunim me Sektorin Juridik Bashkia Tropojë të marrin masa të menjëhershme dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerave 81,600 lekë, 2,367,435 lekë, 606,520 lekë, 6,305,112 lekë, 3,128,000 lekë të subjekteve të trajtuara më sipër. Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrejë një grup pune për verifikimin e pasaktësive dhe identifikimin e shkaqeve dhe përgjegjësive që kanë shkaktuar problematikën me efekt financiar negativ në buxhetin e Shtetit.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për garantimin e përdorimit me efektivitet të fondeve në dispozicion, duke vlerësuar me kujdes dhe paanshmëri mangësitë që çojnë në skualifikimin e operatorëve ekonomik, sidomos në rastet kur kjo vendimmarrje shoqërohet me pasoja financiare.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

Opinion i mbi përputhshmërinë.

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të

Përputhshmërisë, ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit me kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin e nevojave për shpenzime, procedurat e prokurimit publik, hartimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit dhe veprimtarinë lidhur me planifikimin dhe zhvillimin e tij. Bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Tropojë për vitet 2023 dhe 2024, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të kualifikuar*¹.

Baza për opinion:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 Kodi Etik. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

- Në Bashkinë Tropojë nga ushtrimi i aktivitetit gjatë vitit 2024 të subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore, ka rezultuar të ardhura të munguara në vlerën prej 5,201,096 lekë.

- Nga auditimi u konstatua se nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, nuk është hartuar një regjistër i përditësuar për kategorinë “Familjar”. Konstatohet se referuar regjistrin të gjendjes civile me pagesat e kësaj takse vlere totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2024 në Bashkinë Tropojë është në vlerën 35,098,853 lekë.

- Nga drejtoria e Planifikim Zhvillimit të Territorit nuk është ndërmarrë asnjë masë, qoftë edhe komunikim shkresor me ASHK-në, për tu informuar dhe për të përditësuar regjistrat për ndërtimet të cilat janë legalizuar vitet e fundit, me qëllim vjeljen e taksës së infrastrukturës për ndërtimet e legalizuara, duke krijuar një të ardhur të munguar në vlerën 1,864,879 lekë.

-Sa i takon procedurave të prokurimit, nga auditimi me përzgjedhje i 11 procedurave me vlerë të lartë, rezultoi se: në 3 raste me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tropoje, miratuar edhe me Vendim të Këshillit Bashkiak vlere e pritshme kontratës së punimeve parashikohet të shlyet në periudhën e 2 ose 3 viteve. Kontratat e lidhura me OE shpallur fitues në vlerë totale 86,366,537 lekë, kanë afatin e realizimit të kontratës dhe shlyerjen e detyrimit për punimet e kryera nga 1 muaj deri në 12 muaj; në 5 raste në projektin dhe preventivin e punimeve nuk ka referencë për çmimet e vendosura a janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015; ose manuali on-line, si dhe në dosje nuk administrohet projekt ideja e propozimit për miratimin në buxhet; në 2 raste vendosja e kritereve të veçanta të kualifikimit nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, nuk përputhet me natyrën dhe volumin e punës të prokuruar; në 2 raste vendosja e kritereve të Licencës në kategorinë e përcaktuar edhe nga karakteristikat dhe llojin e punimeve të parashikuara në preventiv nuk ishte shoqëruar edhe me kërkesën për disponimin e Inxhinier Topograf (ose gjeodet) dhe Inxhinier Ndërtim; në 1 rast kërkesa për disponimin e mjeteve nuk argumentohet se mbulon të gjithë zërat e punimeve lidhur për objektin që prokurohet; në 1 rast kërkesa për posedimi i certifikatave ISO është e pa azhurnuar; në 1 rast vendosja e kritereve për disponimin e 3 tre punëtorë (specialistë dhe të thjeshtë) nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, nuk është e përcaktuar qartë ndarja midis punëtorëve

¹ **Opinion i modifikuar/ kualifikuar:** Referuar Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-së (vendim nr. 24, datë 29.12.2022 fq.104) *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.*

të thjeshte ose punëtorëve specialistë për të mundësuar një konkurrencë të drejtë dhe deklarim sa me real të disponibiliteteve të pjesëmarrësve në konkurrim.

-Nga auditimi i prokurimeve me vlerë të vogël u konstatua se Autoriteti Kontraktor Bashkia Tropojë, ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit,

- Në tërësi nga veprimet dhe mos veprimet lidhur me procedurat e prokurimit publik apo shmangien e tyre është shkaktuar një efekt financiar negativ në vlerën 1,943,468.4 lekë, si dhe nga zbatimi i kontratave të punime dhe shërbimeve një dëm ekonomik në vlerën 5,408,541.50 lekë, për punime të pa kryera.

- Nga titullari i Bashkisë Tropojë gjatë vitit 2024, nuk janë ngritur grupe pune për administrimin dhe monitorimin e aseteve. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Tropojë dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë kontabilizuar në bilancin përkatës të bashkisë, nuk kanë certifikuar, si dhe nuk kanë aplikuar në DVASHK Kukës për regjistrim të aseteve të Bashkisë.

- Nga Bashkia Tropojë Sektori i Pronave dhe Hartografisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor Kullotave e Bujqësisë nuk janë kryer veprime apo procedura për regjistrimin dhe krijimin e një regjistri për pyjet në nivel vendor,

-Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, u konstatua se në të gjitha rastet, e audituara, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, nuk është i plotë, mungon studimi gjeologo-inxhinierik dhe studimi sizmiko-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues, në një rast, objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane, në dy raste Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, nuk ka kërkuar mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

- Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur nga Kryeinspektori i IMT Tropojë, blloqet e vendimit të prishjes u konstatua se, nga 20 raste gjithsej, në 8 raste, nga Kryeinspektori i IMT-së Tropojë nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm”; në 7 raste, nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditore për nxjerrjen e vendimit për “Prishje e Objektivit të Kundërligjshëm”; në 5 raste, nuk është bërë kallëzim penal për subjekte që kanë kryer ndërtime informale pa leje ndërtimi; në të gjitha rastet e audituara në kontrollin e kryera, kundërvajtja e konstatuar nga IMTV Tropojë nuk është dokumentuar me fotografi ose video si dhe nuk është hapur dosje individuale për secilën praktikë apo subjekt.

II. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 777/1 prot., datë 17.07.2025, i ndryshuar, nga data 17.07.2025 deri më datë 24.11.2025 në subjektin Bashkia Tropojë, u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. A.M, *përgjegjës grupi*;
2. T.A, *auditues*;
3. R.F, *auditues*;
4. A.S, *auditues*;
5. B.B, *auditues*.

Nga grupi i auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit, një kopje e të cilit i dërgohet Bashkisë Tropojë dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Tropojë.

2. Identifikimi i çështjes:

Projekt Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafeve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Projekt Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Tropojë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Titullari i Bashkisë, dhe Nëpunësi Zbatues sipas rastit, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

Gjithashtu, stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe gjithë veprimtarisë.

4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë e të kryejnë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar me objekt: dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të

rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Bashkisë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojnë.

5. Kriteret e vlerësimit:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Ligji nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.

Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;

VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;

Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.;

Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;

Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”,

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar me ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”;

VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;

Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.;

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar

VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;

Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në fushën e prokurimeve publike:

Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore për prokurimin publik;

Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;

UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:

Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”;

VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;

Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodatat e auditimit

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analiza të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike si dhe në kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të Bashkisë Tropojë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur

në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimit dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve , procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat, etj.

8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë mbledhur dhe shqyrtuar dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, dhe Projekt Raporti i Auditimit të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet / përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Bashkia Tropojë kufizohet në veri me Republikën e Kosovës dhe Malin e Zi, në perëndim me Bashkinë Shkodër, në jug me Bashkitë Vau i Dejës dhe Fushë-Arrëz, dhe në jug-lindje me Bashkinë Has. Qendra e kësaj bashkie është qyteti Bajram Currit, që shërben si nyja kryesore administrative. Bashkia Tropojë përbëhet nga qendra dhe shtatë njësi administrative dhe është pjesë e Qarkut të Kukësit. ka një popullsi prej 28,254 banorësh dhe një sipërfaqe prej 1043 km² Asetet kryesore ekonomike të qytetit është Industria minerare e përqendruar në mineralin e kromi (3 milion ton të pa shfrytëzuar), kuarci (300 mijë tonë të pa shfrytëzuar), boksitet (3 milion ton të pa shfrytëzuar), olivinitet (50 milion ton të pa shfrytëzuar), por Tropoja shërben si një urë lidhëse ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, dhe historikisht ka qenë pjesë e rrugëve tregtare dhe kulturore në rajon. Pozita e saj në Alpet Shqiptare e bën atë të rëndësishme për turizmin malor dhe ekoturizmin. Shtrirja gjeografike e Tropojës e bën këtë zonë një nga vendet më të veçanta në Shqipëri për natyrën dhe potencialin e saj turistik.

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat:

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
BAJRAM CURRI	QYTETI BAJRAM CURRI
FIERZË	QYTETI FIERZË, FSHATRA: TPLA, DUSHAJ POSHTËM, DEGË, BREG-LUM
LEKBIBAJ	BRISË, SALCË, PALÇ, PERAJ, GJONPEPAJ, LEKBIBAJ, TETAJ, SHËNGJERGJ, CURRAJ I POSHTËM, BETOSHE, QERREÇ MULAJ, CURRAJ I SIPËRM
MARGEGAJ	MARGEGAJ, FUSHË LUMI, KOÇANAJ, SHOSHAN, LAGJA PAQËS, BRADOSHNICË, DRAGOBI, ÇEREM, VALBONË, Rragam
LLUGAJ	BUKOVË, JAHO SALIHI, LLUGAJ, LUZHË, RRËZ-MALI, Rragam
BUJAN	BUJAN, ROSUJË, DOJAN, MARKAJ, GRI, LEKURTAJ, SELIMAJ, BLLATË, GRI E RE

BYTYÇ	PAC, ZHERKË, VLAD, ÇORRAJ-VELIÇ, BERISHË, VISOÇE, MASH, ZOGAJ, PRUSH, KEPENEK, KAM, LENIQ
TROPOJË	ASTË, KOJEL, VIÇIDOL, KASAJ, GEGAJ, BUÇAJ, PAPAJ, SOPOT, BABINË, BEGAJ, SHUMICË-AHMETAJ, MYHEJAN, KOVAÇ, KËRRNAJË, SHKËLZEN

Forma dhe mënyra e organizimit:

Bashkia Tropojë ka funksionuar sipas strukturës organizative me vendim të Kryetarit të Bashkisë dhe Miratimi i Strukturës për vitin 2024 me VKB-në nr.60 datë 22.12.2023, “Për miratimin e strukturës organizative” dhe konfirmimi i Prefektit me nr.3/2 datë 14.01.2024, ku janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore

Struktura Organizative.

Për vitin 2024 struktura dhe organika institucionit Bashkia Tropojë, ka parashikuar 396 pozicione pune gjithsej, ku 68 pozicione pune, rregullohen nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; 7 pozicione pune, janë të zgjedhur dhe funksionarë kabineti; 321 pozicione pune, janë punonjës administrativë (punonjës që kryejnë veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtje, shërbimi, ruajtje etj.) dhe rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Të dhëna në lidhje me ndarjen e pozicioneve të shërbimit civil sipas kategorive të shërbimit civil: 1 pozicion të shërbimit civil, janë pozicione të kategorisë së lartë drejtuese (sekretar i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i përgjithshëm, pozicione të barasvlershme me tre të parat); 4 pozicione të shërbimit civil, janë pozicione të kategorisë së mesme drejtuese (drejtor drejtorie, pozicione të barasvlershme me të); 13 pozicione të shërbimit civil, janë pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (përgjegjës sektori/shef sektori, pozicione të barasvlershme me të); 50 pozicione të shërbimit civil, janë pozicione të kategorisë ekzekutive (specialistë); Nga këto pozicione janë të lira (të paplotësuara); 1 që i për ketë kategorisë së lartë drejtuese; 2 që i përkasin kategorive ekzistuese;

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.

2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Në zbatim të nënpikave 1.1-1.6, të Programit të Auditimit nr. 777/1 prot., datë 17.07.2025, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni sa më poshtë:

- Dokumentacioni i hartimit të PBA 2024-2026, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
- Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;
- Akt-Rakordomi i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit;
- Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve;
- Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
- Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët;
- Vendimet e Këshillit Bashkiak Tropojë për miratimin e paketës fiskale të vitit 2024;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifat vendore;

- Dokumentacioni i Drejtorisë së të Ardhurave, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifat vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Sektori Taksave;

2.2.1. Programimi i PBA 2024-2026 dhe programimi i buxhetit Vjetor për vitin 2024.

PBA dhe buxheti i vitit janë miratuar në Këshillin Bashkiak, konkretisht:

-PBA 2024-2026 bashkë me buxhetin e vitit 2024, janë miratuar me VKB-në nr.60 datë 22.12.2023. Buxheti vjetor është miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe është konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Kukës me shkresën nr.3/1 datë 14.01.2024, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33/1. Për realizimin e fazave të përgatitjes me shkresën nr. 2618/5 date 08.12.2023, nga Kryetari i Bashkisë Tropojë është krijuar ekipi i menaxhimit të programeve brenda afatit të përcaktuar, për përgatitjen e PBA 2024-2026.

-Me shkresën nr.1659/4 datë 12.05.2023 titullari i njësisë ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Programin për Buxhetin Afatmesëm(PBA 2024-2026) brenda afatit të përcaktuar në UMF nr. 6, datë 28.02.2023, “Për përgatitjen e PBA-së Vendor 2024-2026”, Kreu I, pika 9(brenda datës 01.06.2023).

Fondet e trashëguara dhe të miratuara nga Këshilli bashkiak me VKB-në nr.18 datë 29.02.2024, si dhe të konfirmuara nga Prefektura e Qarkut Kukës me shkresën 3/8 datë 20.03.2024, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2024 në lekë	
		Të ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	31,598,195	
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	38,672,171	
3	Trashëguar nga transferata specifike		
4	Të trashëguara nga FZHR		
5	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	57,000,000	
6	Granti	272,814,000	
7	Transferta specifike	133,328,000	
11	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)		302,595,757
12	Shpenzime operative (602)		82,951,528
13	Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar		135,242,521
14	Fondet emergjencë dhe fondet rezervë		12,622,560
Totali i buxhetit		533,412,366	533,412,366

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë.

Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2024-2026 me planin buxhetor 2024, paraqitet në tabelën e mëposhtme

Në 000/lekë

Nr .	Përshkrimi	Plan përfundimtar 2024	Sipas PBA 2024-2026	Diferenca
1	Shpenzimet për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	272,711	302,595	-29,884
2	Shpenzimet (602, 604, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	117,372	43,815	73,557
3	Investime – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	143,329	104,110	39,219
4	Investime nga FZSHH			
Total i planit fillestar & Fondet e Trashëgume		533,412	450,520	82,892
Shtesat dhe ndryshimet gjatë vitit				
5	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	14,657		
6	Shpenzime (602, 604, 606,609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	500		
7	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	3,610		
8	Investime nga FZSHH			
9	Pagesa 5 % garanci			
10	Shtese me akt.Normativ per lik.e detyrimeve te prapambetura 21 007			

Nr .	Përshkrimi	Plan përfundimtar 2024	Sipas PBA 2024-2026	Diferenca
	Totali shtesa + ndryshime	18,767	0	0
	Plani përfundimtar			
1	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	287,368		
2	Shpenzime (602, 604,606, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	117,872		
3	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	146,939		
4	Investime nga FZSHH			
5	Pagesa 5 % garanci			
	Shuma e planit vjetor	552,179	450,520	101,659

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë.

2.1.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura:

Për vitin 2024, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB-në nr. 60 datë 22.12.2023, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Kukës me shkresën nr.3/2 datë 14.01.2024.

Në këtë VKB-ë, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2024 kanë vlerën 57,000,000 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 272,814,000 lekë dhe transfertat specifikë ka vlerën 133,328,000 lekë. Në total të ardhurat konstatohen në vlerën 463,142,000 lekë dhe shpenzimet në vlerën 463,142,000 lekë.

Gjatë vitit 2024, Bashkia Tropojë me VKB-në nr.18, datë 29.02.2024 ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë (miratuar në Dhjetor 2023). Këto ndryshime paraqiten sa më poshtë vijonë:

- Janë alokuar fondet e trashëguara nga viti 2023, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 70,270,366 lekë (Akt Rakordimi me Degën e Thesarit për të ardhurat e trashëguara).
- Me VKB-në nr.46, datë 29.04.2024 ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë (miratuar në Dhjetor 2023) për donacionin në vlerën 500,000 lekë (për blerje veshje kombëtare).
- Me VKB-në nr.71, datë 05.08.2024 ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë, për donacionin në vlerën 3,609,855 lekë (për riparim trotuarit).
- Me VKB-në nr.85, datë 31.10.2024 ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë për rritjen e pagave në vlerën totale 14,657,201 lekë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:
 - Janë alokuar fonde shtesë transferte specifikë për arsimit parashkollor, për efekt të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si efekt rritjes së pagës në vlerën 5,428,954 lekë, (Shkresa nr. 8098/2 prot. datë 25.07.2024 e Min.Fin.).
 - Janë alokuar fonde shtesë, transfertë specifikë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, për efekt të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si efekt rritjes së pagës në vlerën 1,409,639 lekë (Shkresa nr. 11788 prot. datë 04.09.2024 e Min.Fin.).
 - Janë alokuar fonde shtesë, për efekt të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si efekt rritjes së pagës minimale në vlerën 7,818,608 lekë (Shkresa nr. 11788 prot. datë 04.09.2024 e Min.Fin.).
 - Janë alokuar fonde për lilkujdimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 21,006,794 lekë (Shkresa nr.17526/2 prot. datë, 23.12.2024 në zbatim të Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024).

-Për vitin 2024, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr.60 datë 22.12.2023. Konstatohen se gjithsej fonde për 2024 janë miratuar në buxhetin fillestar 463,142 mijë lekë, gjatë vitit fondet e planifikuara u shtuan me 110,044 mijë lekë (Sipas VKB-ve të sipërcituara).

Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimitor 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela e ndryshimeve buxhetore (ndryshime brenda programeve Buxhetore):

Buxheti Fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
				SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma
Nr. 723 datë 07.02.2024	463,142,000	Nr.812,dt. 12.2.2024	3,500,000	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0
				602- 609 ShP. te tjera	3,500,000	602, ShP. operative	
				230+231 (Investime)	0	230+231 (Investime)	3,500,000
		Nr.1599,dt. 04.04.2024	2,607,017	606 tr.per buxh,familjare e individ.	2,596,280	604 tr.korr.brend e.	2,596,280
				602- 609 ShP. te tjera		602, ShP. operative	10,737
				230+231 (Investime)	10,737	230+231 (Investime)	
		Nr.1734,dt. 12.04.2024	8,241,582	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0
				602, ShP. operative		602, ShP. operative	7059928
				230+231, investime	8241582	230+231 (Investime)	1181654
		Nr.2573,dt. X07.06.2024	1,000,719	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0
				602, ShP. operative	0	602, ShP. operative	
				230+231, investime	1,000,719	230+231 (Investime)	1,000,719
		Nr.2943,dt. 04.07.2024	1,487,517	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0
				602, ShP. operative	1,487,517	602, ShP. operative	0
				230+231, investime		230+231, investime	1,487,517
		Nr.3811dt. 23.09.2024	300	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0
				602- 609 ShP. te tjera		602, ShP. operative	
				230+231 (Investime)	300	230+231 (Investime)	300
		Nr.4190,dt. 16.10.2024	2,048,294	606 tr.për buxh,familjare e individ.		604 tr.korr.brend e.	
				602- 609 ShP. të tjera		602, ShP. operative	
230+231 (Investime)	2,048,294			230+231 (Investime)	2,048,294		
Nr5443,dt. 27.12.2024	27,888,990	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	27,593,553		
		602, ShP. operative	27,698,916	602, ShP. operative			
		230+231, investime	190,074	230+231 (Investime)	295,437		
Nr.5485,dt. 31.12.2024	63,457	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	0		
		606, Transferte per buxh.Familjare e Individuale	63,457	604, Transf. Korente te brendshme	63,457		
		230+231, investime		230+231 (Investime)			
Nr.5500,dt. 31.12.2024	928,037	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0		
		602, ShP. operative		602, ShP. operative	928,037		
		230+231, investime	928,037	230+231, investime			

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë.

Nga sa më sipër konstatohet se, për vitin 2024 kanë ndodhur 10 ndryshime brenda programeve me një total prej 47,766 mijë lekë. Këto ndryshime sikurse shihet nga tabela janë rialokime shpenzimesh, ndërmjet programeve.

2.1.3 Auditimi mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Në të gjithë

periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2024, të miratuar me VKB-ë ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qëndror. Nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me Degën e Thesarit u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit 2024, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Viti 2024		
		Plan	Fakt	%
1	600 – Paga	255,397	255,397	100%
2	601 – Sigurime shoqërore	42,151	42,095	99.8%
3	602 – Shpenzime operative	109865	92,509	84.1%
4	Totali shpenzime të tjera – (606, 604, 609) me 00	9,325	5,628	60.3%
5	Ndihma ekonomike Min.	348865	348,466	99.8%
6	Investimet (230 + 231)	212,156	185,036	87%
7	Shpërblime lindje – 606			
8	466 – Garancitë			
	Emergjencat (AKMC)	4,983	4,983	100%
	Akti Normativ Nr.5 datë 19.12.2024			
	Totali	982,742	934,113	95 %

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë.

Referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit për aparatën e Bashkisë paraqitet:

Për vitin 2024 janë miratuar në buxhetin fillestar 463,142 mijë lekë ku fondet e planifikuara për këtë vit u shtuan me 540,607 mijë lekë dhe u pakësuan (këto fonde të deleguara me destinacion të ministrive të pa përdorura në fund të vitit të cilat nuk trashgohen për vitin pasardhës) me 12,618 mijë lekë. Buxheti total për vitin për vitin 2024 është 934,113 mijë lekë. Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, nga të gjithë burimet e financimit janë 982,742 mijë lekë me një realizim 95 %. Në këtë masë realizimi kanë ndikuar:

-Shpenzimet operative llogaria 602 janë realizuar në masën 84% i cili tregon për planifikim me rezervë të tij;

-Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është realizuar në masën 87%. Niveli i ulët vjen nga realizimi me vonesë i procedurave të prokurimit dhe si rrjedhojë dhe lidhjes me vonesë e kontratave për to, duke mos i financuar brenda vitit buxhetor.

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Bashkinë Tropojë, jepet nga pasqyrat në vijim:

Miratimi i Strukturës për vitin 2024 është miratuar me VKB-në nr.60 datë 22.12.2023, “Për miratimin e strukturës organizative” dhe konfirmimi i Prefektit me nr.3/2 datë 14.01.2024, ku janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore.

Pasqyra e pagave për vitin 2024 Bashkia Tropojë:

Emërtimi		Plan	Fakt
Kap.1 (Granti)	600	238,422,882	238,422,879
	601	39,964,514	39,964,514
Kap. 5 (Të ardhurat)	600	8,274,403	82,74,402
	601	706,420	70,6420

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë.

Ndarja e strukturës:

Emërtimi	Viti 2024	
	Plan	Fakt
Administrata(Aparati+Njësi adm,mbrojtja civile,tatim taksa, kontrolli i ushqimit,shërbime mbështetëse , kultura , muzeu , biblioteka , klubi sportiv)	92	89
Punonjës të Policisë Bashkiake	5	5

Ujitja dhe Kullimi	25	18
Punonjës të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin	17	15
Rrugët Rurale	17	15
Shërbimet publike	103	90
Punonjës të Pyjeve dhe Kullotave	26	26
Gjendja civile	9	9
Arsimi bazë (Qendër kulturore ,sektori arsimit)	90	82
Arsimi i mesëm	6	6
Çerdhja e fëmijëve	6	6
Punonjës me kontratë sezonale	-	-
Shuma	396	361

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë.

Nga verifikimi për raportin e punonjësve me status dhe me kontratë pune rezulton se: Për vitin 2024 struktura dhe organika institucionit Bashkia Tropojë, ka parashikuar 396 pozicione pune gjithsej, ku:

- 68 pozicione pune, rregullohen nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- 7 pozicione pune, janë të zgjedhur dhe funksionarë kabinetit.
- 321 pozicione pune, janë punonjës administrativë (punonjës që kryejnë veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtje, shërbimi, ruajtje etj) dhe rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Të dhëna në lidhje me ndarjen e pozicioneve të shërbimit civil sipas kategorive të shërbimit civil:

- 1 pozicion të shërbimit civil, janë pozicione të kategorisë së lartë drejtuese (sekretar i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i përgjithshëm, pozicione të barasvlershme me tre të parat);
- 4 pozicione të shërbimit civil, janë pozicione të kategorisë së mesme drejtuese (drejtor drejtorie, pozicione të barasvlershme me të);
- 13 pozicione të shërbimit civil, janë pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (përgjegjës sektori/shef sektori, pozicione të barasvlershme me të);
- 50 pozicione të shërbimit civil, janë pozicione të kategorisë ekzekutive (specialistë);

Nga këto pozicione janë të lira (të paplotësuar);

- 1 që i për ketë kategorisë së lartë drejtuese;
- 2 që i përkasin kategorive ekzistuese;

Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Tropojë

Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se Bashkia Tropojë ka marrë subvencion për bonus qiraje për periudhën objekt-auditimi. Për vitin 2024, është subvencionuar vlera prej 4,425,042 lekë, vlerë e cila i përket subvencionit për bonus qiraje, fond nga MF, Drejtoria e Strehimit ku janë trajtuar 57 familje.

Të ardhurat e veta.

Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2024 është realizuar në vlerën 78,293 mijë lekë, ose 8.4% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2024, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime dhe shpenzime operative.

Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në 25 Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 443 , të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për vitin 2024, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin, objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

- Janë dërguar raportet 4-mujore të monitorimit, shkresa nr.2284/2 datë 22.05.2024;
- Janë dërguar raportet 8-mujore të monitorimit, shkresa nr.3920 datë 27.09.2024;
- Si dhe raporti vjetor i monitorimit me shkresën nr.1542 prot datë 25.03.2025.

2.1.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimeve gjyqësore dhe detyrimet kontraktore.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Tropojë, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2024 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2024:

Shuma e detyrimeve të prapambetura në fund të periudhës 31.12.2024:

Detyrime	Detyrimi në 31.12.2023	Detyrimi i krijuar 01.01-31.12.2024	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë 2024	Mbetja e Detyrimeve në 31.12.2024
Investime	29,119,584	10,074	29,129,658	710,000	28,419,658
Investime nga FZHSH					
Mallra dhe shërbime	9,770,495		9,770,495	3,995,000	5,775,495
Vendime gjyqësore	16,166,103		16,166,103	9,319,234	6,846,869
Të tjera	424,600		424,600	424,600	
TOTALI	55,480,782	10,074	55,490,856	14,448,834	41,042,022

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë.

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Tropojë ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2024, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykatë) që krijon detyrimin përkatës.

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2024, përcjellë në MF me e-mail datë 28.02.2025, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Tropojë ndaj palëve të treta raportuar në MF është **në vlerën 41,042,022 lekë**.

Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, ç'ka do të thotë se Bashkia Tropojë në fund të vitit 2024 rezulton në një situatë normale.

Detyrimet nga vendimet gjyqësore.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2024, Bashkia Tropojë rezulton se ka detyrime nga Vendimet Gjyqësore.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2024, janë likuiduar 12,458,952 lekë (9,319,234 lekë vendim gjyqësor për "H." sh.p.k detyrim i prapambetur dhe vlera 3,139,718 lekë për vendime të tjera gjyqësore që kanë qenë të planifikuara për likuidim në vitin 2024) dhe mbetur ende shuma për të likuiduar prej 6,846,869 lekë.

2.1.5 Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfutuara nëpërmjet FZHSH/Ministrisë së linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria Ekonomike për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, në lidhje me investimet publike, u konstatua se Bashkia Tropojë ka marrë 53,701,931 lekë financime projektsh nga FSHZH/FZHR.

Në tabelën më poshtë ndodhen fonde të deleguara për vitin 2024 për investime të cilat kanë filluar në vitin 2023 (rik.urash lik.2023 shuma 15,217,473 lekë dhe në vitin 2024 shuma 3,222,140 lekë), kanë vazhduar në vitin 2024 dhe kontrata të vitit 2023 dhe janë në proces gjatë vitit 2025:

Nr	Objekti kontratës	OE fitues	Vlera total me tvsh	Likuiduar 31.12.2024	Mbetet për likuidim	Burim financimi
1	Rik.i Shkollës 9-vjecare Beslidhja e Malsisë kon.datë 26.09.2024	BOE M.&N. shpk	66,333,241	30,000,000	36,333,241	Min.Arsimit
2	Rikonstruksion i kanalit Vigi i Vakes Cernicëkon.26.09.2024	G. shpk	32,399,560	10,000,000	22,399,560	Min.Buj.ZH.R
3	Rikonstruksion i ujëmbledhësit Zherkë 1&2 kon. Datë 2.10.2024	A.I. shpk	9,709,084	3,001,355	6,707,729	Agj.Komb.Mbrojtjes Civile
4	Rikonstruksion i ujëmbledhësit Degë kon.datë 16.10.2024	K. shpk	6,210,477	4,972,284	1,238,193	Agj.Komb.Mbrojtjes Civile
5	Rikonstruksion i ujëmbledhësit Rodogosh Kon.datë 4.12.2024	H. shpk	3,535,207	2,506,152	823,490	Min.Buj.ZH.R
6	Rikonstruksion i ujëmbledhësit Vlad kon.date 06.12.2024	A.I. shpk	3,054,744	0	3,054,744	Min.Buj.ZH.R
7	Rikonstruksion i ujëmbledhësit Visoçe kon.datë 06.12.2024	V. shpk	1,742,898	0	1,742,898	Min.Buj.ZH.R
8	Ndertim dhe rikonstruksion urash kon. datë 4.12.23	R.G.	19,183,239	18,439,613	0	Agj.Komb.Mbrojtjes Civile

Burimi: Drejtoria e Financës Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Për financimet nga Ministritë e linjës, FZHR dhe donatorë të tjerë, për periudhën objekt auditimi, për kontratat e vitit 2024 në vlerën 130,422,793 lekë. Likuiduar në vitin 2024 vlera prej 57,917,337 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 72,507,456 lekë.

Për financimet nga buxheti Bashkisë Tropojë dhe Grande, janë lidhur për periudhën objekt auditimi gjithsej 10 kontrata në vlerën 136,765,656 lekë. Likuiduar në vitin 2024 vlera prej 62,153,696 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 74,611,960 lekë.

Grantet e specifike (602, 230+231) për vitin 2024:

Nr.	Emërtimi objektit	Shuma gjithsej	Financuar buxhet shteti,FZHR, Të tjera	Financim ardhura veta
1	Rikonstruksion kanalet vaditese kontrat datë 28.06.2024	2,748,806		2,748,806
2	Rikonstruksion rruga Hysenukaj kontrat datë 28.06.2024	2106540		
3	Rikonstruksion i Muzeut Historik kontrat datë 28.06.2024	8,925,099	7,437,582	1,487,517
4	Rik.i Shkolles 9-vjecare Beslidhja e Malsise kon.datë 26.09.2024	66,333,241	30,000,000	
5	Rikonstruksion i kanalit Vigi i Vakes Cernice kon. datë 26.09.2024	32,399,560	10,000,000	
6	Rikonstruksion i ujembledhesit Zherke 1&2 kon. datë 2.10.2024	9709084	3,001,355	
7	Rikonstruksion i ujmbledhesit Dege kon.datë 16.10.2024	6,210,477	4,972,284	
8	Rikonstruksion i ujembledhesit Rodogosh Kon.datë 4.12.2024	3,535,207	2,506,152	
9	Rikonstruksion i ujembledhesit Vlad kon.datë 06.12.2024	3,054,744		
10	Rikonstruksion i ujembledhesit Visoçe kon.datë 06.12.2024	1,742,898		

2.1.6 Organizimi dhe funksionimi i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore (STT):

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se, Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore(STT) në Bashkinë Tropojë, në përbërjen e tij ka 7 punonjës, 1 Përgjegjës Sektori dhe 6 specialistë, kjo bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 125, datë 22.12.2022, ku është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar edhe nga Prefekti Qarkut Kukës me shkresën nr.3/2, datë 10.01.2023, të ndarë sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. II.6: Struktura organizative e Sektori Taksave dhe Tarifave;

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore	Struktura	Fakt
Përgjegjës Sektori	1	1
Specialistë	6	6
Punonjës gjithsej	7	7

Burimi: të dhëna nga Bashkia Tropojë.

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2024, STT ka funksionuar me strukturë të plotë, kjo në përputhje me strukturën organike, të miratuar me Vendimin nr. 125, datë 22.12.2022.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Për vitin 2024 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tropojë është miratuar me VKB-në nr. 47, datë 11.12.2023 për “Miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave Vendore”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr.68/1 Prot. datë.15.01.2024”.

Tabela nr.II.6.1:Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Tropojë, viti 2024, në 000/lekë;

Lloji i taksës, Tarifës	PLAN	FAKT	%
	Janar-Dhjetor - 2024	Realizim Janar-Dhjetor 2024	Realizimi ne % 2024
Të ardhurat e veta gjithsej	64,000	68,558	107.1
Të ardhurat nga taksa vendore	35,580	34,310	96.4
Nga tatim mbi të ardhurat personale (2%)	7,000	8,836	126.2
Nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për bv	50	236	472.0
Nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	3,400	4,001	117.7
Nga taksa mbi ndërtesat	2,600	3,255	125.2
Ndërtesa banimi	400	260	65.0
Ndërtesa të tjera	2,200	2,995	136.1
Ndërtesa në pronësi apo në përdorim..	-	-	0.0
Nga taksa mbi tokën bujqësore	300	98	32.7
Nga taksa mbi truallin	500	648	129.6
Nga taksa e fjetjes në hotel	1,500	2,107	140.5
Nga taksa e ndikimit në infrastrukturë...	10,000	4,201	42.0
Nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë..	50	5	10.0
Nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	12,000	13,422	111.9
Nga taksa e rentës minerare	50	-	0.0
Nga taksa e tabelës dhe reklamës	1,480	1,502	101.5
Taksa të tjera	50	-	0.0
Të ardhurat nga tarifat vendore	19,620	25,116	128.0
Tarifa e shërbimeve publike...	13,900	16,049	115.5
Nga familjet	1,800	1,268	70.4
Nga institucione institucione	1,100	998	90.7
Nga biznesi	11,000	13,783	125.3
Tarifa të shërbimit administrativ...	2,800	2,841	101.5
Nga vërtetime, autorizime,dokumenta të tjera	150	88	58.7
Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive ..	50	-	0.0
Nga tarifat e licënsimit ...	1,500	1,779	118.6
Nga tarifat parkimi për mjetet e licënuara...	500	490	98.0
Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyj.kull...	600	484	80.7
Tarifa për shërbimin në institucione ...	2,920	6,226	213.2
Pallati i kulturës	50	-	0.0
Pallati i sportit	50	-	0.0
Kopshtet	950	1,455	153.2
Cerdhet	170	165	97.1
Tarifa për zënien e hapësirave publike	300	359	119.7
Nga gjendja civile	-	-	0.0
Të ardhura të tjera	1,400	4,247	303.4
Gjobat	800	691	86.4
Të ardhura jo tatimore	8,000	8,441	105.5
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve...	8,000	8,441	105.5
Të ardhura nga shitja e aktiveve ...	-	-	0.0

Burimi: të dhëna nga Bashkia Tropojë.

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Tropojë paraqitet në masën 107%, nga 64,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 68,558 mijë lekë (4,558 mijë lekë më shumë), duke arritur objektivat e përcaktuara në planifikimin e vitit 2024.

Pajisja me autorizime të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Grupi i auditimit, auditori dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Tropojë, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 10 subjekte, të cilët (sipas informacioneve dërguar nga Bashkia Tropojë) ushtrojnë aktivitet me autorizimin përkatës.

Tabela nr.II.6.2; subjektet që tregtojnë lëndë djegëse në B. Tropojë, viti 2024.

Nr.	Subjekti	NIPT	Fillimi i autorizimit	Mbarimi i autorizimit	Likujduar	Sistemi (Pakësime)	Debitor
1	G.C. Gkg	K....T	16.03.2022	15.03.2025	600,000		-
2	P.	L....K	21.09.2020	20.09.2025	520,000		480,000
3	A.A.	K....K	28.10.2018	27.10.2023			800,000
4	K.	J.....P	02.02.2022	01.02.2027	1,000,000		-
5	H.I	K.....F	09.08.2019	08.08.2024	100,000		900,000
6	Sh.	L.....F	19.09.2023	18.09.2028	1,000,000		-
7	S.	J.....J	19.03.2023	18.03.2028	200,000		800,000
8	S.	J.....J	16.05.2021	15.05.2026	278,904	721,096	-
9	E.O.	L.....C	11.01.2019	10.01.2024	100,000		900,000
10	D.-Oil	L.....G	12.03.2021	11.03.2026	400,000	600,000	-
11	Totali				4,878,904	1,321,096	3,880,000

Burimi: Sektori Taksave, përpunuar nga KLSH.

Sipas tabelës më sipër dhe dokumentacionit ndodhur në dosjet respektive, rezulton se:

- Subjekti “G.C. ”, është pajisur me Autorizim nga ana e Bashkisë Tropojë, në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, pika 2/9, kjo pasi tarifa e aplikuar është në vlerën 600,000 lekë dhe jo 1,000,000 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë, në vlerën prej **400,000 lekë**.

- Subjekti “P”, është pajisur me Autorizim nga ana e Bashkisë Tropojë, në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, pika 9, pasi Autorizimi është dhënë pa u kryer pagesa e plotë nga ana e subjektit.

- Subjekti “A.A. ”, nga verifikimi i dosjes kontatohet se subjekti **nuk** ka rinovuar autorizim për tregtimin me pakicë të karburantit, pas përfundimit të tij më datë 27.10.2023, edhe pse nga ana e Bashkisë është përpiluar fatura për arkëtim prej 200,000 lekë më datë 22.01.2024 dhe e paguar nga subjekti (për pagesën e autorizimit nga 27.10.2024-26.10.2025). Sa më sipër jemi në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, kreu II, pika 14 ku citohet se “Përsëritja e licencave bëhet nga organi që ka dhënë licencën, kundrejt një kërkesë të personit juridik, e cila shqyrtohet njësoj si një kërkesë e re, duke paraqitur dokumentet përcaktuara në shkronjat “a”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g”, të pikës 2, të këtij kreu”, si dhe në VKM nr. 344, datë 19.04.2017, pika 2/9, ku subjekti duhej të paraqiste dokumentacionin përkatës, të kryente pagesën prej 1,000,000 lekë dhe më pas të pajisej me Autorizimin përkatës. Si përfundim, bazuar në aktet ligjore e nënligjore, subjekti deri në fund të vitit 2024 rezultojnë të jetë debitorë në vlerën prej 800,000 lekë.

- Subjekti “H.I”, rezulton debitor në vlerën prej 900,000 lekë. Pajisur me Autorizim nga ana e Bashkisë Tropojë, në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, pika 9, pasi Autorizimi është dhënë pa u kryer pagesa e plotë nga ana e subjektit.

- Subjekti “S.” (L.Dardania), nga dokumentacioni rezulton se është pajisur me Autorizim në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, pika 9, pasi Autorizimi është dhënë pa u kryer pagesa e plotë nga ana e subjektit. Subjekti ka kryer pagesën prej 200,000 lekë dhe është debitor për shumën prej 800,000 lekë.

- Subjekti “S” (Sopot), nga informacioni dhe dokumentacioni konstatohet se subjekti nuk ushtron aktivitet që prej datës 07.10.2022, autorizimi i lëshuar nga Bashkia Tropojë, i përket periudhës 16.05.2021-15.05.2026. Nga grupi auditimit konstatohet se Autorizimi është dhënë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, pika 9, pasi nuk është kryer asnjë pagesë nga ana e subjektit. Pas raportit të KLSH-së, me nr.572/12 të datës 22.09.2022, subjekti rezultonte ende debitor në vlerën 1,000,000 lekë dhe Bashkia Tropojë ka nxjerr njoftimin dhe kërkesën për pagesë, por pa rezultat.

Për këtë subjekt nga ana e Drejtorisë Ekonomike, është kryer një akt-vlerësim i detyrimit (pa u bazuar në asnjë akt ligjor apo nënligjor) me shkresën nr.2399 datë 12.05.2023 dhe nga 1,000,000 lekë është vlerësuar në 278,904 lekë(duke përlogaritur ditët aktive të subjektit nga 16.05.2021-07.10.2022). Më pas, kryetari i Bashkisë Tropojë ka nxjerr urdhërin nr.202 të datës 12.05.2023 ku urdhëron zhblokimin e llogarive bankare si dhe sistemimin/pakësimin e vlerës nga 1,000,000 në 278,904 lekë, në gjykimin e grupit të auditimit duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën prej 721,096 lekë.

- Subjekti “D.-Oil”, nga informacioni dhe dokumentacioni konstatohet se subjekti nuk ushtron aktivitet që prej datës 27.02.2023, nga autorizimi i lëshuar nga ana e Bashkisë Tropojë, vlefshmëria e tij ka qenë nga 12.03.2021-11.03.2026. Edhe për këtë subjekt konstatohet se Autorizimi është dhënë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, pika 9, pasi nuk është kryer asnjë pagesë nga ana e subjektit. Vetëm pas akt-vlerësimit të datës 12.05.2023 dhe urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tropojë nr.202 datë 12.05.2023, detyrimi nga 1,000,000 lekë u pakësua në 400,000, duke krijuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën 600,000 lekë.

Konstatim: Ushtrimi i aktivitetit gjatë vitit 2024 të subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore, ka sjell **të ardhura të munguara për Bashkinë Tropojë në vlerën prej 5,201,096 lekë**. Këto detyrime të cilat konsiderohen të ardhura të munguara(dhe dëm ekonomik), janë krijuar nga mos zbatimi i përcaktimeve ligjore të sipërcituara, pasi subjektet duhej të pajiseshin me autorizimin përkatës vetëm pas kryerjes së plotë të pagesës prej 1,000,000 lekë.

Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. R.B. Kryetar i Bashkisë Tropojë dhe znj. Z.I. në cilësinë e zv. Kryetar i Bashkisë Tropojë.

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Bashkia Tropojë në fillim të vitit 2024 ka patur në total 395 subjekte tregtarë, dhe gjatë vitit ka patur 78 subjekte të cilët janë pezulluar/ç’regjistruar dhe 68 subjekte të reja ose 10 subjekte më pak se viti 2023, nga të cilët 293 janë biznes i vogël dhe 92 operojnë si biznes i madh.

Tabela nr.II.6.3; Numri i bizneseve në Bashkinë Tropojë deri më datë 31.12.2024

Nr	Lloji biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja gjatë vitit 2024	Mbyllur aktivitetin gjatë vitit 2024	Gjendja në fund të vitit 2024
1	Biznesi i madh viti 2024	106	3	17	92
2	Biznesi i vogël viti 2024	289	61	65	293
(1+2)	Gjithsej viti 2024	395	78	68	385

Burimi: Sektori Taksave.

Taksat dhe tarifrat e biznesit:

Në Bashkinë Tropojë subjektet tregtarë ngarkohen me detyrime vendore për taksën e regjistrimit, mbi truallin, pasuri, pastrim, ndriçim, tarifën e gjelbërimit, etj., në tabelën në vijim paraqiten detyrimet e subjekteve në fund të vitit 2023, shtesat dhe pakësimet gjatë vitit 2024 si dhe detyrimi në fund të periudhës 2024;

Tabela nr.II.6.4; Subjektet debitor nga 01.01.2024 deri më datë 31.12.2024; në lekë

Nr.	Natyra e debitoreve	Debitor deri më 31.12.2023	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Debitor deri më 31.12.2024
1	Biznesi vogël	19,678,585	3,011,463	2,055,717	20,634,331
2	Biznes i madh	6,238,415		1,105,194	5,133,221
	Kamatvonesat 2012-2019	2,332,326		83,000	2,249,326
1+2	Total	28,249,326	3,011,463	3,160,911	28,016,878

Burimi: Bashkia Tropojë.

Sipas të dhënave të subjektit rezultojnë se për vitin 2024 bizneset kanë krijuar një borxh prej 28,016,878 lekë detyrime, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Tropojë. Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se Sektori Taksave nuk ka aplikuar penalitetet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 114 ku përcaktohet se: “Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

Sa më sipër, Sektori Tatim-Taksave duhet të kryejë përlllogaritjen e kamatvonesës sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor në fuqi dhe detyrimi i rezultuar duhet të kontabilizohet në mënyrë të rregullt në evidencat financiare të Bashkisë Tropojë.

Taksat dhe tarifrat familjare:

Në Bashkinë Tropojë familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifën e gjelbërimit, tarifën e pastrimit dhe tarifën e ndriçimit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Tropojë për vitin 2024 janë taksuar 1399 familje ose 22 familje më pak, krahasuar me një vit më parë ku ishin taksuar 1421 familje. Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohen si më poshtë:

Tabela nr.II.6.5; Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen

Lekë

Nr.	Nj.Adm	Nr. Familje taksuara 2024	Vlera e paguar	Nr. Fam taksuar 2023	Familjet sipas Gjëndjes Civile	Diferenca familjet e pa taksuara për vitin 2024
1	Bajram Curri	354	656,175	426	2727	2373
2	Bujan	180	145,660	201	928	748
3	Margegaj	170	139,599	149	1083	913
4	Tropojë	325	244,443	326	1872	1547
	Llugaj	155	115,897	177	782	627
	Fierzë	70	56,986	74	825	755
	Lekbibaj	63	40,257	68	558	495
	Bytyc	82	72,314	0	675	593
5	Total	1399	1,471,331	1421	9450	8051

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

-Sipas gjëndjes civile në Bashkinë Tropojë dhe NJA janë 9450 familje, ndërkohë në vitin 2024 janë taksuar/tarifuar 1399 familje, ose 8051 familje më pak. Në të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e Shërbimit (pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit) për qytetin Tropojë dhe NJA, për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim mesatarisht 2500 lekë tarif/taksë (për familje sipas paketës fiskale për NjA Bajram Curri) * 2373 familje të pa taksuara = 5,932,500 lekë, si dhe 1250 lekë tarif/taksë (për familje sipas paketës fiskale për NjA të tjera) * 5678 familje të pa taksuara = 7,097,500 lekë. **Pra në total, për mos tarifimin/taksimimin e të gjitha familjeve të Bashkisë kemi të paktën 13,030,000 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.**

–Situata e mësipërme, vazhdonë të tregojë se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018 , e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në këtë drejtim kërkohet më tepër përkushtim nga Bashkia Tropojë duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Tropojë dhe NJA.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; kapitulli II pika II.1 Tabela 11 në Paketën Fiskale të Bashkisë Tropojë.

Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. R.V. në cilësinë e specialistes për menaxhimin e taksave familjare, z. K.S. në cilësinë e ish përgjegjësit të Sektorit të TTV si dhe z. K.B. në cilësinë e përgjegjësit të Sektorit të TTV.

Dinamika e borxhit:

Nga auditimi konstatohet se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2023 është në vlerën 33,117,410 lekë, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2024 është 6,490,214 lekë dhe pakësimet gjatë vitit 2024 janë 4,508,771 lekë, gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2024 është në vlerën **35,098,853 lekë**.

Sa më sipër, në krahasim me vitin 2023, borxhi është ritur me 6,364,038 lekë (rreth 7%), e cila mund të krijohet si rezultat i mos njoftimit në mënyrë të rregullt i individëve apo i subjekteve të cilët mund të mos jenë të vetëdijshëm për borxhin e krijuar.

Nr.	Debitor më 31.12.2023	Lëvizja viti 2024		
	Vlera	Arkëtuar	Shtuar	Gjendje 31.12.2024
1	33,117,410	4,508,771	6,490,214	35,098,853

Masat e marra për uljen e borxhit:

Nga auditimi u konstatua se, dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, Sektori Taksave ka njoftuar bizneset/familjarët debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifave vendore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për vitin 2024 për debitorët, janë marrë masat sa më poshtë vijonë:

- Njoftim dhe kërkesë për të paguar, dërguar subjekteve debitore me shkresat nr. 4992-4992/194 prot. datë 04.12.2024.
- Urdhërblokimet e llogarive bankare, dërguar bankave të nivelit të dytë me shkresat nr. 5455-5455/188 prot. datë 27.12.2024.
- Njoftim për vendosjen e Barrës hipotekore dhe Barrës siguroese, dërguar subjekteve debitore me shkresat nr.5456-5456/188 prot. datë 30.12.2024.

Sektori Taksave, pas dërgimit të njoftimeve për pagesat e taksave vendore, për subjektet që vijojnë të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, masat e marra nga ana e STT nuk duhen të ndalen por duhet të vijojnë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. Masat e ndërmarra për uljen e borxhit janë të pjesshme dhe jo mjaft efektive.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, pika 2/1 “Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.” dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë,

për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësité e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtorité e Aluizni-t, të vënë në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

Në Bashkinë Tropojë struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Urbanistikës Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Sektori Tatim-Taksave.

Duke u bazuar në të dhënat që disponon kjo drejtori në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se për vitin 2024 ashtu si edhe në vitin 2023, nuk ka të dhëna për legalizime të reja, por vetëm debitorët e pajisur me leje legalizimi, në vitet 2017-2018 sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr.II.6.6: Lejet e legalizimit dhe vlera e taksës

në lekë

Nr.	Adresa	Subjekti	Nr. i Lejes	Data e lejes	Sipërf. në m ²	Kosto mesatare Sipas EKB	Vlera e Ndërtimit	Shuma e Taksës
1	Koçanaj	A. D.	55370	17.01.2017	166.32	32899	5,471,762	27,359
2	B.Curri	M. H.	55833	19.04.2017	140.5	32899	4,622,310	23,112
3	B.Curri	B. P.	56256	30.06.2017	19.74	32899	649,426	3,247
4	Rrogam	Ç. A.	56276	28.07.2017	379.86	32899	12,497,014	62,485
5	Jaho Salih	F. B.	55307	08.11.2017	274.83	32899	9,041,632	45,208
6	Sopot - Tropojë	D. Q.	56410	29.12.2017	369.76	32899	12,164,734	60,824
7	Lagje "28Gushti"	U. I.	56413	29.12.2017	228.72	32899	7,524,659	37,623
8	Fierzë Tropojë	R. Sh.	56426	15.01.2018	239.61	32899	7,882,929	39,415
9	Margegaj Tropojë	H. A.	56429	15.01.2018	290.92	32899	9,570,977	47,855
10	Sopot – Tropojë	H. M.	56432	15.01.2018	284.69	32899	9,366,016	46,830
11	Sopot – Tropojë	I. B.	56317	13.02.2018	670.39	32899	22,055,161	55,138
12	Bujan - Tropojë	S. B.	38962	18.02.2018	180	32899	5,921,820	29,609
13	Bajram Curri	H. M.	90298	28.03.2018	59.76	32899	1,966,044	9,830
14	Nimaj B. Curri	A. H.	90265	24.05.2018	116.13	32899	3,820,561	19,103
15	Nimaj B. Curri	S. H.	90266	24.05.2018	25.8	32899	849,781	4,249
16	Bujan Tropojë	A. M.	94733	24.05.2018	743.71	32899	24,467,315	122,337
17	Bajram Curri	N. A.	37327	25.07.2018	29.55	32899	972,165	4,861
18	Bajram Curri	D. K.	90297	25.07.2018	303.42	32899	9,982,215	49,911
19	Bajram Curri	I. B.	90259	25.07.2018	254.86	32899	8,384,639	41,923
20	Bajram Curri	P. S.	57573	26.07.2018	14	32899	460,586	2,303
21	Viçidol Tropojë	I. S.	57588	30.08.2018	245.7	32899	8,084,600	40,423
TOTALI								773,644

Burimi: Bashkia Tropojë.

Për Bashkinë Tropojë, sipas të dhënave vënë në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se nga drejtoria e PZHT, nuk është ndërmarrë asnjë masë, qoftë edhe komunikim shkresor me ASHK-në, për tu informuar dhe për të përditësuar regjistrat për ndërtimet të cilat janë legalizuar vitet e fundit, **me qëllim vjeljen e taksës**. Pasi taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësité e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, gjithashtu parashikuar edhe në Paketën Fiskale miratuar me nr.47 datë 11.12.2023, të Bashkisë Tropojë, pika 1.4, tabela nr.7 (0.5% e vlerës së investimit).

Sa më sipër, grupi i auditimit nga informacioni marrë nga DVASHK-së Kukës, konstatoj se nga Janar 2023-në Tetor 2024, janë legalizuar të paktën 11,337.13 m² ndërtim, duke e llogaritur me kosto mesatare sipas EKB me vlerën 32,899 lekë, rezulton një investim prej 372,975,963 lekë, nga i cili lind detyrimi taksës prej 0.5% **në vlerën 1,864,879 lekë, të cilat janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.**

Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. H.I. në cilësinë e ish drejtorit të PZHT si dhe z. E.M. në cilësinë e përgjegjësit të Sektorit të PZHT.

Taksa vjetore e mjeteve të transportit rrugor:

Sipas VKB-së me nr.47 datë 11.12.2023 Për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2024”, si agjent tatimor për vjeljen e kësaj takse është përcaktuar “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të

Transportit Rrugor (DRSHTRR)”, e cila derdh me anë të faturës për arkëtim përqindjen e përcaktuar të totalit mujor të të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit. Nga rakordimet mujore të bëra me këtë drejtori, konkludohet se realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura për vitin 2024 është 13,422,000 lekë, ose 19,5% e të ardhurave totale për Bashkinë Tropojë.

Për sa më sipër janë paraqitur observacionet: për Projekt Raportin e Auditimit nga Bashkia Tropojë me nr. 3219/36, datë 02.02.2026 ardhur në KLSH me nr. 467/7, datë 05.02.2026 nga përfaqësuesit e Bashkisë H.I. dhe E.M. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mos arkëtimin e taksës së infrastrukturës përcaktojmë se në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 si dhe Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 i ndryshuar, është detyrë e ALUIZNI-t të verë në dispozicion të Qeverisjes Vendore në momentin e dërgimit në ZVRPP të dhënat e ndërtimeve pa leje të legalizuara. Mangësia e dokumentacionit nuk lidhet me mos veprimin e Bashkisë por me mos dërgimin e të dhënave nga institucioni që është ngarkuar me ligj të bëjë këtë. Paketa fiskale e vitit 2025 përcakton DPZHT strukturë për llogaritjen e taksës së infrastrukturës për ndërtimet e reja dhe jo për ndërtimet e legalizuara.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Obsevacioni i paraqitur nuk merret në konsideratë pasi: Për Bashkinë Tropojë, sipas të dhënave vënë në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se nga drejtorja e PZHT, nuk është ndërmarrë asnjë masë, qoftë edhe komunikim shkresor me ASHK-në, për tu informuar dhe për të përditësuar regjistrat për ndërtimet të cilat janë legalizuar vitet e fundit, me qëllim vjeljen e taksës. Pasi taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, gjithashtu parashikuar edhe në Paketën Fiskale miratuar me nr.47 datë 11.12.2023, të Bashkisë Tropojë, pika 1.4, tabela nr.7 (0.5% e vlerës së investimit).

2.2. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

2.2.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Regjistri i parashikimeve/ realizimeve për vitin 2023, 2024;
- Urdhra/ Vendime të Titullarit të AK;
- Dosjet e procedurës së prokurimit;
- Dokumentacion i vënë në dispozicion nga Bashkia Tropojë.

a. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Tropojë për prokurimin e fondeve **në vitin 2023** ka rezultuar se: Nga ana e Autoritetit Kontraktor (AK), janë respektuar afatet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e app.gov.al. AK ka përgatitur regjistrin e veprimtarive të prokurimit të kryera, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja.

Bashkia Tropojë kishte programuar sipas nevojave të njësisë, duke hartuar Regjistrin e Parashikimeve dhe Realizimit të Prokurimit, për vitin 2023, Kështu:

Për vitin ushtrimor 2023 Bashkia Tropojë ka kryer gjithsej 46 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit 276,350,221 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur 214,208,140 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 62,142,081 lekë pa TVSh.

Procedurat e periudhës 01.01.2023-31.12.2023	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
Gjithsej	46	276,350,221	214,208,140
- Të hapura	6	234,481,113	177,716,493
- E hapur e thjeshtuar	6	18,360,786	17,815,859
- Të vogla	34	23,508,322	18,675,788

b. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Tropojë për prokurimin e fondeve në vitin 2024 ka rezultuar se: Nga ana e Autoritetit Kontraktor (AK), janë respektuar afatet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrimit vjetor të parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e app.gov.al. AK ka përgatitur regjistrin e veprimtarive të prokurimit të kryera, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja.

Bashkia Tropojë kishte programuar sipas nevojave të njësisë, duke hartuar Regjistrin e Parashikimeve dhe Realizimit të Prokurimit, për vitin 2024, Kështu:

Për vitin ushtrimor 2024, Bashkia Tropojë ka kryer gjithsej 41 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit 183,923,126 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur 140,422,625 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 43,500,501 lekë pa TVSh.

Procedurat e periudhës 01.01.2024-31.12.2024	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
Gjithsej	41	183,923,126	140,422,625
- Të hapura	3	130,500,521	94,777,333
- E hapur e thjeshtuar	9	43,383,904	36,023,686
- Të vogla	21	9,523,287	9,156,208
- Blerje nen 100 000 leke	8	515,414	465,398

2.2.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.),

Viti 2023

U audituan me zgjedhje 5 procedura, gjatë vitit 2023 me fond limit 123,821 mijë lekë ose rreth 50 %,

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e procedurës	OE fitues	Data e lidhjes se kontratës	Data e perfundimit kontrates
1	“Sistemim asfaltim Rruga: Bukovë-Nigegaj-Qendër Luzhë”	32,087,629	Hapur	23,266,167.8	12.04.2023	Sh.	04.05.2023	04.11.2023
2	Rikonstruksion i Rrugës Fshati Kasaj ,	79,863,397	Hapur	57,519,605.4	22.09.2023	N.	04.05.2023	04.05.2024
3	Rikonstruksion i Kanaleve Vaditëse	1,909,044	Hapur i Thjeshtë	1,905,971	03.04.2023	V.	26.04.2023	05.06.2024
4	“Shërbime rrugësh, mbushje gropash me asfalt, Bashkia Tropojë” me fond limit lekë pa TVSH	5,589,810	Hapur thjeshtë	5,580,765	21.03.2023	V. & G.	26.04.2023	26.05.2023
5	“Blerje dru Zjarri ”	4,373,289.05	I hapur mallra	4,370,000	16.10.2023		10.11.2023	30.04.2024

Konkretisht:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim Rruga: Bukovë-Nigegaj-Qendër Luzhë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.88 datë 20.02.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.88, datë 20.02.2023 1. H. G, Kryetar 2. F. M, Anëtar 3. M. G, Anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 89, datë 20.02.2023 ndryshuar me nr. 156 datë 31.03.2023 1. F. M. Kryetar 2. S. M. (E. B.), Anëtar 3. B. B. (J. Gj.), Anëtar

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur – Punë publike.”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 32,087,629lekë	6. Oferta fituese: OE “Sh.” ShPK me ofertë 23,266,167.8lekë pa TVSh, me kontratë nr. 10, datë 04.05.2023, me afat 6 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 8,821,461.2 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 30.03.2023	9. Burimi Financimit: Buxheti Shtetit+Buxheti Bashkiak	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 7 OE, BOE b) Kualifikuar 5 OE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Në zbatim të urdhrin nr. 87, datë 20.02.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” Grupi i punës përbëhet nga E.M, A. D. dhe M.K, të cilët kanë nënshkruar edhe deklarin e konfliktit të interesit po në datë 20.02.2023. Specifikimet teknike, Relacionin teknik dhe Projekti i zbatimit janë nënshkruar nga U.K, M.B. dhe H.I. Preventivi, Grafiku i punimeve është nënshkruar nga M.V. dhe B.B. Në kundërshtim me nenin 15 të VKM 285/2021 e ndryshuar grupi i punës “Për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” nuk ka administruar në dosjen e prokurimit miratimin e projektit të zbatimit si dhe projekt idenë për miratimin në buxhet. Nuk ka referencë për çmimet e vendosura a janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

- Sipas DST Seksioni 1.10 “Përshkrimi i shkurtër i kontratës” - Burimi i financimit: Të ardhurat e Bashkisë Tropoje për vitin 2023, miratuar me VKB Nr125 datë 22.12.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit dhe numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2023 si vit i parë i PBA-së 2023-2025”. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 32.087.629 lekë pa TVSH. Do të kryhet:

1. Për vitin 2023 shlyerja do të jete në masën 14.3% ose 4 579 074 lekë
2. Për vitin 2024 shlyerja do të jete në masën 40% ose 12 835 052 lekë
3. Për vitin 2025 shlyerja do të jete në masën 45.7% ose 14 673 504 lekë

-Në kontratën datë 04.05.2023 të lidhur midis Bashkisë Tropojë dhe OE “Sh.” neni 2 përcakton: -pagesën prej 23,266,167.8 lekë pa TVSH, AK është dakort të paguajë kontraktuesin në vlerën e kontratës mbi bazën e ekzekutimit e punimeve, neni 3 përcakton: afatin e realizimit të kontratës është 6 muaj, ose 180 ditë.

Për sa më lart në lidhje me financimin e kontratës është vepruar në kundërshtim me nenin 85 pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar ku përcaktohet:

Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Në auditimin e kriterëve të vendosura **janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin** nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Konkretisht:

Në pikën 2.3.1, në DST, është kërkuar që OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kriterëve 2.3.1. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, neni 39 pika 5/a, b ku përcaktohet se :

“a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllorë të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Me procesverbal datë 17.03.2023 Njësia e Prokurimit ka bërë ndryshimin e dokumenteve të tenderit kjo në bazë të sugjerimeve të APP dërguar me e-mail datë 10.03.2023. Me njoftimin për ndryshimin e dokumenteve të tenderit është vendosur edhe shtyrja e afatit kohor për dorëzimin e ofertave në datë 30.03.2023.

Referuar Procesverbalit datë 31.03.2023 “Për hapjen dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion Sistemim Asfaltim Rruga Bukovë-Qendër Luzhë” me fond limit prej 32,087,629 lekë pa TVSH, renditja e ofertuesve të paraqitur në tender është si më poshtë:

Nr	Subjektet	Vlera e ofertuar	Vëretje
1	SH.	23,266,167	Kualifikuar
2	C.	23,832,018	S’kualifikuar
3	V.&G.	24,725,892	Kualifikuar
4	H.&B.	25,477,200	Kualifikuar
5	O.&T.	26,350,674	Kualifikuar
6	B.&V.&N.	27,598,280	S’kualifikuar
7	R.G.	27,950,265	Kualifikuar
	Totali	179,200,496	
		MO =25,600,071	VAU=21,720,933.66

Me Vendim nr. 1819/3, datë 12.04.2023 është miratuar Klasifikimi i Ofertave sipas Raportit përmbledhës për zhvillimin e procedurës. Ankesa nuk ka pasur.

Me shkresën datë 12.04.2023 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit paraprak, shpallur në buletin e APP nr. 34 datë 18.04.2023.

Me shkresën datë 03.11.2023, është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit. Kontrata me Operatorin fitues është lidhur me nr. 10, datë 04.05.2024, me afat 6 muaj. Konkluzion: Nga auditimi, u konstatua se vlerësimi nga KVO është bërë në përputhje me LPP.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Rrugës Fshati Kasaj” me fond limit 79,863,397 lekë pa TVSH

1. Urdhër Prokurimi: Nr.128 datë 06.03.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr128, datë 06.03.2023 1. H.G, Kryetar 2. F.M, Anëtar 3. M.G, Anëtar	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 129, datë 06.03. (ndryshuar me Urdhrin nr. 160, datë 03.04.2023) 1. F.M. Kryetar 2. A.M. Anëtar (E.B.) 3. A.M. Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur – Punë publike.”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 79,863,397 lekë	6. Oferta fituese: OE “N.” ShPK me ofertë 57,519,605.4 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 13, datë 04.05.2023, me afat 12 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 22,343,791.6 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 03.04.2023	9. Burimi Financimit: Buxheti Shtetit+Buxheti Bashkiak	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 7 OE, BOE b) Kualifikuar 1 OE
11. Ankime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Në zbatim të urdhrit nr. 43, datë 24.01.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” Grupi i punës përbëhet nga E.M, A.D. dhe M.K, (të cilët kanë nënshkruar edhe deklarin e konfliktit të interesit po në datë 24.01.2023), ka bashkëlidhur dokumenteve të tenderit: Specifikimet teknike, Relacionin teknik dhe Projekti i zbatimit Preventivi, Grafiku i punimeve të hartuara nga subjekti “A.2.S.” përfaqësuar nga M.C.

Në dosjen e tenderit administrohet: Kontrata me subjektin “A.2.S.”; si dhe referenca për çmimet e vendosura në lidhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar; nuk administrohet projekt ideja e propozimit për miratimin në buxhet.

Sipas DST Seksioni 1.10 “Përshkrimi i shkurtër i kontratës” - Burimi i financimit: Të ardhurat e Bashkisë Tropoje për vitin 2023, miratuar me VKB Nr125 datë 22.12.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tropojës për vitin 2023”. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 79 863 397 (lekë pa TVSH. Do të kryhet:

1. Për vitin 2023 shlyerja do të jete në masën 14.6% ose 11 630 655

2. Për vitin 2024 shlyerja do të jete në masën 45.4% ose 36 287 384

3. Për vitin 2025 shlyerja do të jete në masën 40% ose 31 945 358

- Në kontratën datë 04.05.2023 të lidhur midis Bashkisë Tropojë dhe OE “N.” neni 2

përcakton: -pagesën prej 57,519,605.40 lekë pa TVSH, AK është dakort të paguajë kontraktuesin në vlerën e kontratës mbi bazën e ekzekutimit të punimeve, neni 3 përcakton: afatin e realizimit të kontratës është 12 muaj.

Për sa më lart në lidhje me financimin e kontratës është vepruar në kundërshtim me nenin 85 pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar ku përcaktohet:

Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Në auditimin e kriterëve të vendosura **janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin** nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Konkretisht:

Në pikën 2.3.1, në DST, është kërkuar që OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e suksesshme në realizimin e kontratës: a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, konkretisht 39,931,698.65 lekë pa TVSH; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kriterëve 2.3.1. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 pika 5/a, b ku përcaktohet se :

“a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Me procesverbal datë 23.03.2023 Njësia e Prokurimit ka bërë ndryshimin e dokumenteve të tenderit kjo në bazë të sugjerimeve të APP dërguar me e-mail datë 02.03.2023. Me njoftimin për ndryshimin e dokumenteve të tenderit afatit kohor për dorëzimin e ofertave mbetet në datë 03.04.2023.

Referuar Procesverbalit datë 03.04.2023 “Për hapjen dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Fshati Kasaj” me fond limit prej 79,863,397 lekë pa TVSH, renditja e ofertuesve të paraqitur në tender është si më poshtë:

Nr	Subjektet	Vlera e ofertuar	Vërejte
1	“SH.”	55,576,137.00	S’kualifikua
2	“E.K.”	56,349,767.40	S’kualifikua
3	“R.G.”	57,451,685.64	S’kualifikua
4	“N.”	57,519,605.40	Kualifikuar
5	BOE “H.&B.”	59,604,099.40	S’kualifikua
6	BOE “V.&G.”	62,057,933.10	S’kualifikua
7	B.&V.&N.	68,683,072.00	S’kualifikua
	Totali	417,242,299.94	
		MO = 59,606,042.85	VAU=59,897,547.75

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 03.04.2023 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike dhe në datë 18.04.2023 ka hartuar Raportin Përmbledhës.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin nr. 1, datë 18.04.2023 “Mbi miratimin e klasifikimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit” ka shpallur fitues OE “N.” dhe ka s’kualifikuar 3 OE “Sh.”, “E.K.” dhe “R.G.” si dhe 3 BOE pjesëmarrës “H.&B.”, “V.&G.” dhe “B.&V.&N.”.

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorit shpallur fitues “N.” u konstatua se:

a- në DST Kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.2.1, është kërkuar: Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021,2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel te Autorizuar.

- OE “N.” në SPE nuk ka paraqitur Bilancin e vitit 2022.

b.- Në vlerësim të ofertave ekonomike të OE, “N.” rezulton ofertë anomalisht e ulët pasi oferta e paraqitur në vlerë 57,519,605.40 lekë pa TVSH është ulur më shumë se 25% e fondit limit prej 79,863,397 lekë pa TVSH ($79,863,397 \text{ lekë} \times 75\% = 59,897,547.75 \text{ lekë}$)

Veprime në kundërshtim me pikën 2 dhe 4 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku përcaktohet:

....Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

....4 Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Për sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave dhe para shpalljes së fituesit duhet të kishte kërkuar sqarime si dhe dokumentacion plotësues për të argumentuar kualifikimin e OE “N.”.

2. Operatori ekonomik “Sh.” me ofertë ekonomike 55,576,137.00 lekë pa TVSH, sipas procesverbalit datë 03.04.2023 mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është shkualifikuar pasi: oferta e paraqitur nuk është në përputhje me të gjithë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit konkretisht:

1. Operatori Ekonomik ka mangësi/mos plotësim në dokumentacionin e paraqitur:

- Operatori "Sh." nuk ka vërtetimin e xhiros për vitin 2022, nuk ka bilancin e vitit 2022 të kërkuara në DST, disa sasi të paraqitura në preventiv janë ndryshe nga sasi të kërkuara tek preventivi i DST, mungon lejet e drejtimit "C" për shoferet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE rezulton se shkualifikimi i OE "Sh." nuk është i bazuar në prova e fakte të plota po për mangësi e devijime të vogla që mund të kërkohej sqarim me shkrim nga subjekti.

1.1.- Në lidhje me mos paraqitjen e vërtetimit të xhiros për vitin 2022, dhe të bilancit të vitit 2022. Komisionit i Vlerësimit të Ofertave nuk ka vepruar me marrjen e informacionet që merren lehtësisht me dokumente faktike me kërkesë zyrtare edhe ndaj Operatorit Ekonomik.

2.1.- Në lidhje me konstatimin se disa sasi të paraqitura në preventiv janë ndryshe nga sasi të kërkuara tek preventivi i DST. Vlera e gabimit e konstatuar nuk kalon shumë e 30,000 lekë dhe është e pa përfillëshme, në totalin e ofertës. nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka kërkesë zyrtare për njoftimin e Operatorit Ekonomik që ka paraqitur ofertën nëse e pranon korrigjimin, për të vazhduar kualifikimin ose jo.

3.1.-Në lidhje me mungesën e lejeve të drejtimit "C" për shoferët, Komisionit i Vlerësimit të Ofertave nuk ka vepruar me marrjen e informacionet që merren lehtësisht me dokumente faktike me kërkesë zyrtare edhe ndaj Operatorit Ekonomik.

Veprime në kundërshtim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku përcaktohet:

.....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

si dhe me pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet:

....Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjer në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

Referuar sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kishte kualifikuar Operatorin Ekonomik "Sh." duke renditur në vend të parë në klasifikimin e ofertuesve si dhe duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, mos veprim që ka sjellë **një efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Tropojë për 1,943,468.4 lekë pa TVSH** i ardhur nga diferenca e ofertës së shpallur fituese e OE "N." prej 57,519,605.40 lekë dhe ofertës të shkualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të OE "Sh." prej 55,576,137.00 lekë pa TVSH.

Çka ngarkon me përgjegjësi Komisionin e Vlerësimit të Ofertave F.M. Kryetar, A.M, A.M, Anëtar.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstrukcion i Kanaleve Vaditëse" me fond limit 1,909,044 lekë pa TVSH		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 136 datë 16.03.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.136, datë 16.03.2023 1. H. G, Kryetar 2. F. M, Anëtar 3. M. Gj, Anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 137, datë 16.03.2023 1. F. M. Kryetar 2., R. V. Anëtar 3., B. B. Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar – Punë publike."		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,909,044 lekë	6. Oferta fituese: OE "V." me ofertë 1,905,971 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 5, datë 26.04.2023, me afat 40 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 3,073 lekë pa TVSh

8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 03.04.2023	9. Burimi Financimit: Buxheti Bashkiak	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE, b) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Në zbatim të urdhrit nr. 134, datë 13.03.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” Grupi i punës përbëhet nga E.M, A.D. dhe M.K, (të cilët kanë nënshkruar edhe deklarinimin e konfliktit të interesit po në datë 13.03.2023), ka bashkëlidhur dokumenteve të tenderit:

Në auditimin e kriterëve të vendosura **janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin** nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Konkretisht:

Në pikën 2.3.1, në DST, është kërkuar që OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e suksesshme në realizimin e kontratës: b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit të kontratës që prokurohet.

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kriterëve 2.3.1. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 pika 5/ b ku përcaktohet se :

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Referuar Procesverbalit datë 03.04.2023 “Për hapjen dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Kanaleve Vaditës 2023” me fond limit prej 1,909,044 lekë pa TVSH, ka vetëm një ofertues si më poshtë:

OE “V.” me një vlerë të ofertuar prej 1,905,971 lekë pa TVSH

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 03.04.2023 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike dhe në datë 11.04.2023 ka hartuar Raportin Përmbledhës.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin nr. 1, datë 11.04.2023 “Mbi miratimin e klasifikimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit” ka kualifikuar OE “V.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemit SPE të OE “V.” me ofertë ekonomike prej 1,905,971 lekë pa TVSH shpallur fitues konstatua se:

- Në DT, “Kriteret e Veçanta” në pikën 2.2 “Kapaciteti financiar” nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2.1 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare, 2019,2020,2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Nr. 10091 date 05.03.2009.), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

2.2.2. *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020,2021 ku vlera e xhiros minimale vjetore duhet të jete jo me pak se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet.*

OE “V.” nuk plotëson kriteret, pasi: -Bilanci i vitit 2019 nuk është i shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar; - Vërtetimi (Për xhiron e tre viteve të fundit) lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës në datë 01.04.2023 ka të pasqyruar vetëm xhiron e viteve 2020 dhe 2021.

- Në DT, “Kriteret e Veçanta” në pikën 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të paktën si më poshtë: *1 Teknik ndërtimi; 1 Hidraulik; 2 Manovratorë; 1 Shofer; 7 Puntorë të thjeshtë.*

OE “V.” nuk plotëson kriteret, pasi: Në lidhje me stafin teknik të kërkuar nuk plotësohet me 1 Manovratorë.

- Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është marrë në konsideratë faktin që Operatori Ekonomikë “V.”, nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit pasi “personeli dhe drejtuesit teknik” (stafi Inxhinier-teknik) (kërkesat e pikës 2.3.3 të DST); “punonjësit e specializuar” (kërkesa të pikës 2.3.5 të DST) dhe “mjetet e deklaruara” (kërkesa të pikës 2.3.8 të DST), janë të angazhuar njëkohësisht edhe në dy kontrata aktive me Bashkinë Tropojë, konkretisht: kontrata nr. 4, datë 26.04.2023, me afat 1 muaj ose 30 ditë “Shërbime rrugësh, mbushje gropash me asfalt, Bashkia Tropojë” me fond limit 5,589,810 lekë pa TVSH; si dhe kontrata nr. 9, datë 04.05.2023, me afat 9 muaj, ose 270 ditë “Rikonstruksion i Rrugës Bylbyl Breçani, Lagjja Breçani, Fshati Markaj” me fond limit 54,502,005 lekë pa TVSH

KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “V.” sh.p.k dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, por të anulonte procedurën, veprime në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, ku përcaktohet:

“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

Si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2, ku përcaktohet:

“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.”

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbime rrugësh, mbushje gropash me asfalt, Bashkia Tropojë” me fond limit 5,589,810 lekë pa TVSH

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 115 datë 28.02.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.115, datë 28.02.2023 1. H. G, Kryetar 2. F. M, Anëtar 3. M. Gj, Anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 114, datë 28.02.2023 1. F. M. Kryetar 2., E. B. Anëtar 3., A. M. Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar – Punë publike.”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 5,589,810 lekë	6. Oferta fituese: BOE “V.& G.” ofertë 5,580,765 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 4, datë 26.04.2023, me afat 1 muaj ose 30 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 9,045 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 21.03.2023	9. Burimi Financimit: Buxheti Bashkiak	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE, b) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Në zbatim të urdhrin nr. 113, datë 28.02.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” Grupi i punës përbëhet nga E.M, A.D. dhe M.K, ka bashkëlidhur dokumenteve të tenderit:

-Sipas DST Seksioni 1.10 “Përshkrimi i shkurtër i kontratës” - Burimi i financimit: Të ardhurat e Bashkisë Tropoje për vitin 2023, miratuar me VKB Nr. 125 datë 22.12.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit

të Bashkisë së Tropojës për vitin 2023”. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 54,502,005 lekë pa TVSH. Do të kryhet:

1. Për vitin 2023 shlyerja do të jete në masën 30 % ose 1,666,667 lekë

2. Për vitin 2024 shlyerja do të jete në masën 70 % ose 3,923,143 lekë

- Në kontratën datë 26.04.2023 të lidhur midis Bashkisë Tropojë dhe OE “V.” neni 2 përcakton: -pagesën prej 5,580,765 lekë pa TVSH, AK është dakord të paguajë kontraktuesin në vlerën e kontratës mbi bazën e ekzekutimit e punimeve, neni 3 përcakton:- afatin e realizimit të kontratës është 1 muaj, ose 30 ditë.

Për sa më lart në lidhje me financimin e kontratës është vepruar në kundërshtim me nenin 85 pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021i ndryshuar ku përcaktohet:

Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Në auditimin e kriterëve të vendosura **janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin** nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Konkretisht:

Në pikën 2.3.1, - Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kriterëve 2.3.1. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55 pika 4 ku përcaktohet se :

a)Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemit SPE të BOE “V. & G.” me ofertë ekonomike prej 5,580,765 lekë pa TVSH shpallur fitues u konstatua se nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

Marrëveshja e bashkëpunimit datë 20.03.2023, BOE “V. & G.” në nenin 2 ka përcaktuar raportin në pjesëmarrje të operatorëve ekonomike ku: operatori ekonomik “G.” do të jetë pjesëmarrës me 10 % të punimeve dhe operatori “V.” do jetë pjesëmarrës me 90 % të punimeve, me përfaqësues zyrtar operatorin “V.”.

- Marrëveshja nuk është e shoqëruar me preventivin e ndarë sipas zërave të punimeve që do kryejë çdo operator pjesëmarrës.

- Nga subjekti “V.”, që ka marrë përsipër realizimit e 90 % të punimeve sipas të gjithë zërave në marrëveshjen e bashkëpunimit; në stafin teknik nuk ka ing. Ndërtimi, siç është kërkuar në DT –“Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës”.

- Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është marrë në konsideratë faktin që Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “V. & G.”, nuk plotëson kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi

“personeli dhe drejtuesit teknik” (stafi Inxhinier-teknik) (kërkesat e pikës 2.3.3 të DST); “punonjësit e specializuar” (kërkesa të pikës 2.3.5 të DST) dhe “mjetet e deklaruara” (kërkesa të pikës 2.3.8 të DST), janë të angazhuar njëkohësisht në dy kontrata aktive me Bashkinë Tropojë, konkretisht: kontrata nr. 4, datë 26.04.2023, me afat 1 muaj ose 30 ditë “Shërbime rrugësh, mbushje gropash me asfalt, Bashkia Tropojë” me fond limit 5,589,810 lekë pa TVSH; si dhe kontrata nr. 9, datë 04.05.2023, me afat 9 muaj, ose 270 ditë “Rikonstruksion i Rrugës Bylbyl Breçani, Lagjja Breçani, Fshati Markaj” me fond limit 54,502,005 lekë pa TVSH.

KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE “V. & G.” sh.p.k dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, por të anulonte procedurën, veprime në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, ku përcaktohet:

“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

Si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2, ku përcaktohet:

“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.”

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje dru Zjarri ” me fond limit 4,373,289.05 lekë pa TVSH		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.279 datë 07.08.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 279, datë 07.08.2023(ndryshuar me nr. 282, datë 11.08.2023) 1. T. K. Kryetar 2. A. N. anëtar 3. A. I. anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 280, datë 07.08.2023 1. J. Q. Kryetar 2., E. B. anëtar 3. A. S. Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur thjeshtë –Mallra		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,373,289.05 lekë	6. Oferta fituese: OE “L. A.”, me ofertë 4,370,000 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 17, datë 10.11.2023, me afat 6 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 3,289.05 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 16.10.2023	9. Burimi Financimit: Buxheti Buxheti Bashkiak	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Në zbatim të urdhrat nr. 254, datë 02.08.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” Grupi i punës përbëhet nga S.M, F.M. dhe B.H, ka përcaktuar Specifikimet teknike për 1363 m³ Dru zjarri me çmim për njësi 3208.5 lekë/m³ dhe çmim total për 5,247,946.89 lekë. Bashkëlidhur dokumenteve të tenderit: “Projekt shëndetësimi dhe pastrimi mbeturinash të vlefshme për dru zjarri” për ngastrat 108/a; 111/a; 124/a nga Projektuesi Inxh. S.M. dhe Grupi i Vlerësimit K.B. Drejtor, Inxh. S.M. dhe A.Q, F.M. punonjës të Pyjeve.

Në auditimin e kritereve të vendosura **janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.**

Konkretisht:

1. Nga Njësia e Prokurimit në **Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 2.3.1** është përcaktuar

se, *“Ofertuesi duhet të paraqesë”*:

Për të provuar përvojën e mëparshme OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ky argumentim nuk është bërë sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku citohet

"Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës".

Vendosja e këtij kriteri për kontrata të ngjashme jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës ka kufizuar pjesëmarrjen e OE në procedure e prokurimit e cila është në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, kreu V, neni 21, "Autoriteti dhe enti kontraktor" pika 1 ku Përcaktohet:

"Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj".

2. Nga Njësia e Prokurimit në **Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 2.1; pika 2.3.2, dhe të tjera**, është përcaktuar se, *“Ofertuesi duhet të paraqesë”*:

- të ketë në stafin teknik të paktën një inxh. Pyjesh, dhe të shoqëruar me diplomë ose Certifikatë kualifikimi/Leje profesionale, kontratë pune ose të figuroje në listë pagesat e operatorit ekonomik

- të ketë të punësuar jo më pak se 2 (dy) punonjës të thjeshtë të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Të tjera -Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin dëshmi për të paktën 2 (dy) automjete (pronësi ose me qira), automjet transporti jo më pak se 5 ton.

- Grupi i auditimit, konstaton se në vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit pika 2 dhe nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, nuk përputhet me natyrën dhe volumin e mallit të prokuruar “Dru Zjarri” në sasi prej 1363 m³.

Për realizimin me sukses të kontratës së prokuruar:

- nuk është marrë në konsideratë dhe nuk është vlerësuar disponimi i mjeteve apo pajisjet teknike të domosdoshme si dhe fuqia punëtore e disponueshme, për prerjen e druve të përcaktuara me damkosje, transporti ngastra pyjore në vend depozitimit për transport si dhe transporti deri në pikën e grumbullimit.

-nuk është kërkuar disponimi(në pronësi apo me qira) i një shesh depozitimi për drutë e zjarrit të gatshme për shpërndarje sipas kërkesës së AK.

Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 77 pika 4 ku përcaktohet:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie.....

3. në dokumentet e tenderit mungon **Grafiku i lëvrimit**, kjo në kundërshtim me përcaktimet të pikës 3/b të nenit 15, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

-Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën: Specifikimet teknike; Grafiku i lëvrimit dhe Kërkesat e veçanta për kualifikim dhe shpallja e fituesit.

Referuar Procesverbalit datë 03.09.2024 “Për hapjen dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje dru Zjarri ” me fond limit 4,619,173.54 lekë pa TVSH, renditja e ofertuesve të paraqitur në tender është si më poshtë:

Nr	Subjektet	Vlera e ofertuar	Vërtetje
1	A.	4,370,000	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 16.10.2023 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike dhe në datë 23.10.2023 ka hartuar Raportin Përmbledhës.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin nr. 1, datë 30.10.2023 “Mbi miratimin e klasifikimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit” ka shpallur fitues OE “A.”.

Konkluzion: Nga auditimi, u konstatua se vlerësimi nga KVO është bërë në përputhje me DST.

Për sa më sipër janë paraqitur observacionet: për Projektraportin e Auditimit nga Bashkia Tropojë me nr. 3219/36, datë 02.02.2026 ardhur në KLSH me nr. 467/7, datë 05.02.2026 nga Hartuesit e Dokumenteve të tenderit dhe Komisioni vlerësimit të ofertave: M.Gj, F.M, H.G, T.K, F.M, A.M, A.M, A.I, A.N, për sa më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Procedurat e Prokurimit me objekt: “ Sistemim asfaltim Rruga Bukovë-Nigegaj-Qendër Luzhë”; “Rikonstruksion i Rrugës Fshati Kasaj”; “ Rikonstruksion i Kanaleve Vaditëse”; “ Shërbime rrugësh, mbushje gropash me asfalt, Bashkia Tropojë”, nga Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit vendosja e kriterit që OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Ne lidhje me këtë konstatim bashkëlidhur ju dërgojmë e maili-n e APP ku ne si komision kemi kërkuar sqarime nëse përcaktimi a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet është shkelje dhe nga sqarimi APP na është thënë që ky përcaktim nuk është në shkelje sepse kufiri minimal është 50%.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë**; vendosja e kriterëve 2.3.1. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 pika 5/a.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me prokurimin me objekti “Rikonstruksion i Rrugës Fshati Kasaj” konstatimet nga ana e auditit dhe konkretisht:

Për kualifikimin e OE “N.”

-Bilanci 2022 nuk është kërkuar në DST nga njësia e prokurimit (kriteret e veçanta të kualifikimit) pasi afati i fundit i paraqitjes së bilanceve dhe auditit është 31 mars i çdo vit dhe në shumë raste kjo kërkesë nuk është e mundur nga firmat pjesëmarrëse për arsye të konfirmimit nga ana e tatimeve.

- Në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në bazë të pikës 4 neni 82 të VKM nr.285,datë 19.05.2021(i ndryshuar) thuhet "Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. Pjesëmarrja ka qenë mbi dy oferta.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **argumentimi Juaj merret pjesërisht në konsideratë**; nuk merren në konsideratë mos paraqitja e bilancit të

vitet 2022 pasi është kërkesë e kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe trajtimi i ofertës së OE “N.” jo si ofertë anomalisht e ulët, veprime në kundërshtim me pikën 2 dhe 4 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me prokurimin me objekt: “Rikonstruksion i Rrugës Fshati Kasaj” konstatimet nga ana e auditit dhe konkretisht: Arsyet e skualifikimit të “Sh.” shpk -Disa sasi të paraqitura në preventiv janë ndryshe nga sasi të kërkuara tek preventivi DST-së. -Mungojnë Lejet e Drejtimit të tipit C për shoferët;-Ka sjellë vërtetim xhiro Vjetore vetëm për dy vite;- Ka sjellë bilancet vetëm për dy vite.

Duke patur parasysh që ky Operator nuk plotëson kriteret e vendosura në DST Operatori ekonomik “Sh.” shpk është shkualifikuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë**, pasi:

- Në lidhje me mos paraqitjen e vërtetimit të xhiros për vitin 2022 dhe të bilancit të vitit 2022. Komisionit i Vlerësimit të Ofertave nuk ka vepruar me marrjen e informacioneve që merren lehtësisht me dokumente faktike me kërkesë zyrtare edhe ndaj Operatorit Ekonomik.

- Në lidhje me konstatimin se disa sasi të paraqitura në preventiv janë ndryshe nga sasi të kërkuara tek preventivi i DST. Vlera e gabimit e konstatuar nuk kalon shumën e 30,000 lekë dhe është e pa përfillëshme, në totalin e ofertës. nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka kërkesë zyrtare për njoftimin e Operatorit Ekonomik që ka paraqitur ofertën nëse e pranon korrigjimin, për të vazhduar kualifikimin ose jo.

-Në lidhje me mungesën e lejeve të drejtimit “C” për shoferet, Komisionit i Vlerësimit të Ofertave nuk ka vepruar me marrjen e informacionet që merren lehtësisht me dokumente faktike me kërkesë zyrtare edhe ndaj Operatorit Ekonomik. Veprime në kundërshtim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Pretendimi i subjektit: në lidhje me procedurat “Rikonstruksion i Kanaleve Vaditëse” dhe “Shërbime rrugësh, mbushje gropash me asfalt, Bashkia Tropojë” Sqarojmë se, në momentin që është bërë mbyllja e procedurës referuar raportit përmbledhës datë 11.04.2023 nuk ka qenë e lidhur asnjë kontratë për këtë operator por duke qenë në këto kushte operatorit ekonomik duhet ti ishte komunikuar nga personi përgjegjës që meqënëse është shpallur fitues në tre procedura të bënte zgjedhjen dhe heqjen dore nga dy procedura sepse KVO nuk mund të parashikojë nëse do lidhë kontrata apo jo, sepse në momentin e mbylljes së vlerësimit operatori ekonomik nuk ka pasur kontratë të lidhur me AK Bashkia Tropojë.

Dy procedurat e tjera ku janë lidhur kontratat me 26.04.2023 dhe 04.05.2023 ne nuk mund të paragjykonim nëse do bëhet finalizimi me lidhjen e kontratës nga operatori.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë**; pasi nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është marrë në konsideratë faktin që Operatori Ekonomikë “V.”, nuk plotëson kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi “personeli dhe drejtuesit teknik” (stafi Inxhinier-teknik) (kërkesat e pikës 2.3.3 të DST); “punonjësit e specializuar” (kërkesa të pikës 2.3.5 të DST) dhe “mjetet e deklaruar” (kërkesa të pikës 2.3.8 të DST), janë të angazhuar njëkohësisht edhe në dy kontrata aktive me Bashkinë Tropojë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Procedurat e Prokurimit me objekt: “Blerje Dru Zjarri”, komisioni i hartimit të dokumenteve në DST fillestare që është dërguar për tu hedhur në sistem nga njësia e prokurimit personit përgjegjës për sistemin . Sqarojmë se në fillim procedura është hedhur me të gjitha kriteret por për arsye se nuk është paraqitur asnjë operator jemi detyruar ti thjeshtojmë dhe e kemi rihedhur si procedurë. Përsëri nuk është paraqitur asnjë operator jemi detyruar ta hedhim për të tretën herë dhe të thjeshtojmë kriteret në mënyrë që tu japim mundësinë operatorëve të paraqesin ofertat e tyre sepse situata ishte urgjente se ishte shumë vonë për realizimin e kësaj procedure dhe rrezikonim që institucionet të mbeteshin pa furnizim me dru zjarri që është e vetmja mënyrë ngrohje gjatë dimrit.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë** pasi për realizimin me sukses të kontratës së prokuruar, nuk është marrë në konsideratë dhe nuk është vlerësuar disponimi i mjeteve apo pajisjet teknike të domosdoshme si dhe fuqia punëtore e disponueshme, për prerjen e druve të përcaktuara me damkosje, transporti nga ngastra pyjore në vend depozitimin për transport si dhe transporti deri në pikën e grumbullimit; nuk është kërkuar disponimi (në pronësi apo me qira) i një shesh depozitimi për drutë e zjarrit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 77 pika 4

Viti 2024

U audituan me zgjedhje 6 procedura, të zhvilluara gjatë vitit 2024 me fond limit 102,374 mijë lekë ose rreth 60 % e fondit limit të prokuruar nga autoriteti Kontraktor.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e procedurës	OE fitues	Data e lidhjes se kontratës	Data e perfundimit kontrates
1	“Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare “Beslidhja e Malësisë” Tropojë”	82,500,060.00	Hapur	55,277,700.44	12.04.2023	“M./S & N.”	26.09.2024	9 muaj
2	“Rikonstruksion i Kanaleve Vaditëse Ura Vigi i Vakës-Cernicë”	33,787,957.00	Hapur	26,999,633.44	07.08.2024	“G.”	26.09.2024	12 muaj
3	“Rehabilitimi i Ujëmbledhësit Radogosh”	3,433,064.52	Hapur e Thjeshtuar	2,775,235	11.11.2024	“H.”	04.12.2024,	45 ditë
4	“Rehabilitimi i Ujëmbledhësit Zherka 1-2”	9,739,487.45	Hapur e Thjeshtuar	8,090,904	13.08.2024	“A. I.”	02.10.2024	4 Muaj
5	“Rehabilitimi i Rrugës Lagjja Hysenukaj ”	2,083,279	Hapur e Thjeshtuar	1,755,450	02.05.2024	“V.&G.”	28.06.2024	1 muaj
6	“Blerje dru Zjarri ”	4,619,173.54	Hapur e Thjeshtuar	4,500,410	03.09.2024	“L.A.”	26.09.2024	6 muaj

Konkretisht:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare “Beslidhja e Malësisë” Tropojë” me fond limit prej 82,500,060 lekë pa TVSH		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.167 datë 15.04.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.167, datë 15.04.2024 1. T. K, Kryetar 2. A. I, Anëtar 3. M. G, Anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 168, datë 15.04.2024, (ndryshuar me Urdhër nr. 262, datë 20.08.2024) 1. J. Q. Kryetar 2. B. B. Anëtar (E. B.) 3. A. S, Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur – Punë publike.”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 82,500,060 lekë	6. Oferta fituese: OE “M./S & N.” me ofertë 55,277,700.44 lekë pa TVSh, me kontratë datë 26.09.2024, me afat 9 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 27,222,359.56 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 09.08.2024	9. Burimi Financimit: Buxheti Shtetit+Buxheti Bashkiak	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 10 OE, BOE b) Kualifikuar 5 OE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Me shkresën nr. 1815/5, datë 27.03.2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit. Lënda: “Transferim fondi për shpenzime kapitale në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore, Bashkia Tropojë” ka miratuar transferim fondi të miratuara në grupin e shpenzimeve kapitale për projektet e shpallura fitues për vitin 2024-2026. “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare “Beslidhja e Malësisë” Tropojë” për një vlerë totale të projektit prej 99,000,072 lekë. Financimi: Njësia e

Vetëqeverisjes Vendore për 14,850,011 lekë; Buxheti 2024 për 30,000,000 lekë dhe Buxheti 2025 për 54,150,061

Në zbatim të urdhrit nr. 166, datë 20.02.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” Grupi i punës përbëhet nga H.I, E.M, dhe M.K. Me procesverbalin, datë 08.07.2024 Komisioni ka pasqyruar llogaritjen e vlerave të punimeve për objektin që prokurohet.

Në kundërshtim me nenin 15 të VKM 285/2021 e ndryshuar grupi i punës “Për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” nuk ka administruar në dosjen e prokurimit miratimin e projektit të zbatimit si dhe projekt idenë për miratimin në buxhet apo konkurim.

Në auditimin e kritereve të vendosura **janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin** nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Konkretisht:

- Në pikën 2.3.4, në DST, është kërkuar që OE ofertues duhet të ketë në stafin e tij ose me kontrate pune te vlefshme për periudhën e realizimit te kontratës specialistë te certifikuar sipas profesioneve, te paktën si me poshtë: Si staf teknik: 5 Elektracist; 6 Manovrator; 1 karpentier; 1 bojaxhi; 2 Sovatues; 1 hekurkthyes; 1 murator; 1 pllakashtrues; 2 shofere me leje drejtimi te tipit C

Grupi i auditimit, konstaton se në vendosjen e kritereve 2.3.4 duhet të ishte përfshirë edhe 1-2 punonjës me profesion hidraulik pasi sipas preventivit rreth 10 % e vlerës totale janë punime Hidrosanitare, ngrohje, termoizolimi, kanalizimi. Nga njësia e prokurimit, miratuar nga Titullari i AK, është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 pika 6/c, ç ku përcaktohet se :

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

- Në pikën 2.3.4, në DST, është kërkuar që OE të paraqesë Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e kredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kritereve 2.3.2 për certifikatën ISO 45001-2018, është e pa azhurnuar pasi OE duhet të disponojnë/paraqesin edhe certifikatën për standardin e përditësuar (ISO 45001-2023). Nga njësia e prokurimit, miratuar nga Titullari i AK, është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 pika 7/c ku përcaktohet se :

7.Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

c) Operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

Me procesverbal datë 26.07.2024 Njësia e Prokurimit ka bërë ndryshimin e dokumenteve të tenderit kjo në bazë të sugjerimeve të APP dërguar me e-mail datë 01.08.2024. Me njoftimin për ndryshimin e dokumenteve të tenderit është vendosur edhe shtyrja e afatit kohor për dorëzimin e ofertave në datë 09.08.2024.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 09.08.2024 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike objektin:

"Rikonstruksion shkollës 9-vjeçare Besëlidhja e Malësisë" Tropojë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë sipas pasqyrës së mëposhtme:

Nr.	Operatori/et Ekonomik	OFERTA	Vërejtje
1	BOE: N. & M./S	55,277,700.44	Kualifikohet
2	G.	59,830,144.93	S'Kualifikohet
3	R.-C.	61,764,400.00	S'Kualifikohet
4	BOE: H. & B.N	63,417,991.77	S'Kualifikohet
5	C.	64,335,900.78	Kualifikohet
6	BOE: E. H. & H.	64,579,458.55	Kualifikohet
7	Z.	65,355,080.16	Kualifikohet
8	N.	65,875,222.00	Kualifikohet
9	F.	70,258,331.34	Kualifikohet
10	P.-V.-K.	77,513,326.38	S'Kualifikohet

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 09.08.2024 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike dhe me Procesverbalin datë 27.08.2024 ka mbyllur vlerësimin e ofertave, në datë 09.09.2024 ka hartuar Raportin Përmbledhës.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin nr. 1, datë 10.09.2024 "Mbi miratimin e klasifikimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit" ka shpallur fitues BOE: "N. & M./S",

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorit shpallur fitues BOE: "N. & M./S" u konstatua se:

a- në DST "Njoftimi i Kontratës" në pikën 2.3.2 "Stafi kryesor mbështetës..." është specifikuar A. Si staf Inxhinierik: 1 inxhinier Ndërtimi; 1 Inxhinier Elektrik; 1 Teknik Ndërtimi; 1 inxhinier Mekanik.

- BOE: "N. & M./S" në Deklarimin e shtojca 8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" në deklarimin e punonjësve është përfshirë në deklaram e OE "N.", F.T, Teknike ndërtimi, ndërsa në licencën e subjektit me nr. NZ.2798/17 nuk është e përfshirë në drejtuesit teknik. Çka përbën mos plotësimin e Kriterit të Veçantë pika 2.3.2.

KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE: "N. & M./S" dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, pa komunikuar më parë me Operatorin Ekonomik për plotësimin devijimeve të vogla dhe konkludimin në shpalljen fitues. Në të kundër të vazhdonte me shqyrtimin e dokumentacionit të OE të tjerë pjesëmarrës në garë ose të anulonte procedurën. Veprime në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3, ku përcaktohet:

"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji."

Si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 2, ku përcaktohet:

"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme."

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Kanaleve Vaditëse Ura Vigi i Vakës-Cerrnicë" me fond limit prej 33,787,957 lekë pa TVSH

1. Urdhër Prokurimi: Nr.227 datë 19.06.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.167, datë 15.04.2024 1. T. K, Kryetar 2. F. M, Anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 228, datë 19.06.2024, 1. J. Q. Kryetar 2. E. B. Anëtar
--	---	---

	3. M. Gj, Anëtar	3. A. S, Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur – Punë publike.”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 33,787,957 lekë	6. Oferta fituese: OE “G.” me ofertë 26,999,633.44 lekë pa TVSh, me kontratë datë 26.09.2024, me afat 12 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 6,788,323.56 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 07.08.2024	9. Burimi Financimit: Buxheti Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE, BOE b) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Me VKM nr. 226, datë 09.04.2024, Këshilli i Ministrave. “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të Bashkive nga programi “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” për Bashkinë Tropojë ka miratuar transferim fondi të miratuara për vitet 2024-2025. “Rikonstruksion i Kanaleve Vaditëse Ura Vigi i Vakës-Cerrnicë” me fond prej 42,600,553 lekë në vlerë totale Financimi: Buxheti 2024 për 10,000,000 lekë dhe Buxheti 2025 për 32,600,553 lekë

Në zbatim të urdhrin nr. 170, datë 16.04.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike”. Grupi i punës përbëhet nga H.I, E.M, dhe M.V. në zbatim të projektit zbatimit hartuar nga Inxh. M.B, ka pasqyruar llogaritjen e vlerave të punimeve për objektin që prokurohet ka hartuar preventivin dhe grafikun e punimeve.

Në auditimin e kriterëve të vendosura **janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin** nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Konkretisht:

- Në pikën 2.3.1, në DST, është kërkuar që OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kriterëve 2.3.1. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 pika 5/a, b ku përcaktohet se :

“a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

- Në përcaktimin e “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pikën 2.3.2 të DST është përcaktuar - Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë që përfshin kategoritë: NP.1A; NP.7A dhe N.S18A dhe në pikën 2.3.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës në konkurrim duhet të disponojë: 1 Inxhinier Hidroteknik dhe 1 Inxhinier Gjeodet/topograf.

-Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit sipas pikave 2.3.2 dhe 2.3.3, nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, janë kërkesa në mospërputhje pasi për punimet sipas licencës NP.1A duhet që OE të disponojë drejtues teknik

Inxhinier Ndërtimi kërkese e cila duhet të pasqyrohet edhe në kërkesën e veçantë sipas pikës 2.3.3. Ky arsyetim përputhet edhe në referencë të zërave të preventivi pasi rreth 50% e vlerës së preventivit janë punime që duhet të kenë drejtues teknik Inxhinier Ndërtimi. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, neni 39, pika 6. ku përcaktohet se :

6. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:
 a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;
 c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës;

Me procesverbal datë 24.07.2024 Njësia e Prokurimit ka bërë ndryshimin e dokumenteve të tenderit kjo në bazë të sugjerimeve të APP dërguar me e-mail datë 23.07.2024. Me njoftimin për ndryshimin e dokumenteve të tenderit është vendosur edhe shtyrja e afatit kohor për dorëzimin e ofertave në datë 07.08.2024. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 11.11.2024 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike:

Nr.	Operatori/et Ekonomik	OFERTA	Vërejtje
1	G.	26,999,633.44	Kualifikohet
2	N.	26,614,541.52	S’Kualifikohet nuk ka Inxh Hidroteknik,
3	BOE: H. & B. N	25,677,088.72	S’Kualifikohet, Vertetimin e mos dënimit 76/1KP e ka nga Tropoja e jo nga Elbasani sipas adresës; nuk ka Inxh. Hidro; pajisje mungon: tokmak elektrik.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 07.08.2024 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike dhe në datë 28.08.2024 ka hartuar Raportin Përmbledhës. Autoriteti Kontraktor me Vendimin nr. 1, datë 28.08.2024 “Mbi miratimin e klasifikimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit” ka shpallur fitues OE “G. ”, si dhe ka s’kualifikuar OE “N. ”, BOE “H.&B.N”.

Konkluzion: Nga auditimi, u konstatua se vlerësimi nga KVO është bërë në përputhje me LPP.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i Ujëmbledhësit Radogosh”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.314 datë 18.09.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.314, datë 18.09.2024 1. F. M, Kryetar 2. T. K, Anëtar 3. E. M, Anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 315 datë 18.09.2024 (Ndryshuar me urdhërin 357, datë 11.11.2024) 1. S. M. Kryetar 2. M. Gj, Anëtar 3. B. B, Anëtar (A. S.)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur e thjeshtuar – Punë publike.”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 3,433,064.52 lekë	6. Oferta fituese: OE “H.” ShPK me ofertë 2,775,235 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 4993, datë 04.12.2024, me afat 45 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 657,829.52 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 11.11.2024	9. Burimi Financimit: Fondi i ardhur nga Ministria e Bujqësisë dhe zhvillimit rural sipas shkrese nr. 6017/5 prot date 12/09/2024	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE, b) Kualifikuar 4 OE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Në zbatim të urdhrit nr. 304, datë 13.09.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” Grupi i punës përbëhet nga H.I, M.V. dhe E.M.

Specifikimet teknike, Projekti i zbatimit dhe Grafiku i punimeve janë nënshkruar nga B.D. përfaqësues i subjektit “D.-E” si hartues i Projektit të zbatimit.

Relacionin teknik, preventivi është nënshkruar nga H.I, M.V. dhe E.M, grupi i punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike”.

Në kundërshtim me nenin 15 të VKM 285/2021 i ndryshuar, grupi i punës “Për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” nuk ka administruar në dosjen e prokurimit kontratën e bashkëpunimit të Bashkisë me subjektin hartues të projektit, dorëzimin e projekt zbatimit nga subjekti “D.-E”, miratimin e projektit të zbatimit si dhe projekt idenë për miratimin në buxhet. Nuk ka referencë për çmimet e vendosura a janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Në auditimin e kriterëve të vendosura **janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin** nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Konkretisht:

Në pikën 2.1.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të DST është përcaktuar -Operatori ekonomik pjesëmarrës, Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të vetë deklarojnë punëtorinë dhe stafin teknik që disponojnë në formularin vetë përmbledhës të vetë deklarimit.

A)Stafi inxhinierik: -1 një inxhinier ndërtimi (si drejtues teknik); -1 një inxhinier ndërtimi I diplomuar në degën inxhinier për ndërtime qytetare industrial përpara vitit 1971 ose ekuivalente; 1 inxhinier profil hidroteknik; -1 një inxhinier gjeodet/topograf/markshajder.

B)Stafi teknik -1 një hidraulik; -2 dy manovrator; -1 një shofer me leje drejtimi të tipit C,- 3 tre punëtorë (specialistë dhe të thjeshtë).

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kriterëve 2.2.1. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, për disponimin e 3 tre punëtorë (specialistë dhe të thjeshtë) nuk është e përcaktuar qartë ndarja midis punëtorëve të thjeshtë ose punëtorëve specialistë për të mundësuar një konkurrencë të drejtë dhe deklarim sa me real të disponibiliteteve të pjesëmarrësve në konkurrim. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, neni 39, pika 6/c dhe ç.

Referuar Procesverbalit datë 11.11.2024 “Për hapjen dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitimi i Ujëmbledhësit Radogosh” me fond limit prej 3,433,064.52 lekë pa TVSH, renditja e ofertuesve të paraqitur në tender është si më poshtë:

Nr	Subjektet	Vlera e ofertuar	Vërtetje
1	H.	2,775,235	Kualifikuar
2	F.	2,843,316	Kualifikuar
3	V.	2,922,721	Kualifikuar
4	A.I.	2,950,668	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 11.11.2024 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike Autoriteti Kontraktor me Vendimin nr. 1, datë 18.11.2024 “Mbi miratimin e klasifikimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit” ka shpallur fitues OE “H.”

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorit shpallur fitues “H.” u konstatua se:

a- në DST “Njoftimi i Kontratës” në pikën 2.15.1 “Pranohet nënkontraktimi” është specifikuar me “jo”.

- OE “H.” në Deklarimin e shtojca 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” në “llojin e kapaciteteve në të cilën do të mbështet Operatori ekonomik” ka deklaruar mbështetje në “Makineri”, Staf teknik” dhe “Kontrata të realizuara” nga subjekti “S. V.”.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorit “F.” u konstatua se:

a- në DST “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.1 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetë deklaramit):

- OE “F.” në formularin e vetëdeklarimit të llojit të makinerive nuk ka deklaruar disponimin e mjeteve “Matrapik” dhe “Fadrom”

KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “F.” sh.p.k.

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i Ujëmbledhësit Zherka 1-2”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.241 datë 17.07.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.241, datë 17.07.2024 1. T. K. Kryetar 2. F. M, Anëtar 3. M. Gj, Anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 242, datë 17.07.2024(Ndryshuar me urdhrin 260, datë 20.08.2024) 1. J. Q, Kryetar 2. A. S, Anëtar 3. B. B, Anëtar (E. B.)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur e thjeshtuar – Punë publike.”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,739,487.45 lekë	6. Oferta fituese: OE “A. I.” ShPK me ofertë 8,090,904 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 3968, datë 02.10.2024, me afat 4 Muaj	7. Diferenca me fondin limit: 1,648,583.45 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 13.08.2024	9. Burimi Financimit: Fond i Ardhur nga F.D dhe AKZP me shkresë 2390 prot date 27/05/2024.	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE, BOE b) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Në zbatim të urdhrin nr. 239, datë 12.07.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” Grupi i punës përbëhet nga E.M, M.V. dhe H.I.

Specifikimet teknike, Projekti i zbatimit dhe Grafiku i punimeve janë nënshkruar nga B.D. përfaqësues i subjektit “D.-E” si hartues i Projektit të zbatimit.

Relacionin teknik, preventivi është nënshkruar nga H.I, M.V. dhe E.M, grupi i punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike”.

Në kundërshtim me nenin 15 të VKM 285/2021 i ndryshuar, grupi i punës “Për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” nuk ka administruar në dosjen e prokurimit kontratën e bashkëpunimit të Bashkisë me subjektin hartues të projektit, dorëzimin e projekt zbatimit nga subjekti “D.-E”, miratimin e projektit të zbatimit si dhe projekt idenë për miratimin në buxhet. Nuk ka referencë për çmimet e vendosura a janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Në auditimin e kriterëve të vendosura **janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin** nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Konkretisht:

- Në pikën 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të DST është përcaktuar: Licencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt do të jete:

- NP-1 A Punime gërmimi ne toke
- NP-6 A Diga dhe tunele hidroteknike
- NS-18 A Punime topogjeodezike

- Në pikën 2.3.4 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të DST është përcaktuar: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të vetë deklarojnë punëtorinë dhe stafin teknik që disponojnë në formularin vetë përmbledhës të vetë deklarimit.

A) Stafi inxhinierik:

-1 një inxhinier ndërtimi (si drejtues teknik)

-1 një inxhinier hidroteknik

-1 një teknik ndërtimi

-1 një inxhinier mekanik

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kriterëve të Licencës në kategorinë NS-18 A duhet të ishte shoqëruar edhe Inxhinier Topograf (ose gjeodet) kjo e përcaktuar edhe nga karakteristikat dhe llojin e punimeve të parashikuara në preventiv.

Veprim në kundërshtim Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 ku përcaktohet:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Si dhe me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 pika 6.

Referuar Procesverbalit datë 13.08.2024 “Për hapjen dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitimi i Ujëmbledhësit Zherka 1-2” me fond limit prej 9,739,487.45 lekë pa TVSH, renditja e ofertuesve të paraqitur në tender është si më poshtë:

Nr	Subjektet	Vlera e ofertuar	Vërtetje
1	R.G.	7,226,037.0	S’kualifikuar
2	G.	7,571,403.0	Kualifikuar
3	B.&H.	7,928,386.2	S’kualifikuar
4	A. I.	8,090,904.0	Kualifikuar
5	F.	8,140,690.0	S’kualifikuar
6	K.	10,285,808.0	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 13.08.2024 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike dhe në datë 06.09.2024 ka hartuar Raportin Përmbledhës.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin nr. 1, datë 06.09.2024 “Mbi miratimin e klasifikimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit” ka shpallur fitues OE “A. I.”; ka Kualifikuar OE “G.”, “K.”, si dhe ka s’kualifikuar OE “R. G.”, BOE “H.&B.”, OE “F.”.

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorit shpallur fitues “A. I.” dhe BOE “B. & H.” u konstatua se:

Operatori ekonomik “B. & H.” me ofertë ekonomike 7,928,386.2 lekë pa TVSH, sipas procesverbalit datë 22.08.2024 mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është shkualifikuar pasi u verifikua dokumentacioni dhe rezultoi se dokumentacioni në SSP nuk është në rregull dhe ky BOE është s’kualifikuar për arsye se nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, konkretisht:

-Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.3.6 pasi nuk ka mjetet/pajisjet teknike të nevojshme e të kërkuara në këtë kriter të DST-së, konkretisht pompë moto ose ekuivalent autobot uji dhe kompresor ose ekuivalent eskavator me çekiç.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE rezulton se shkualifikimi i BOE “B. & H.” nuk është i bazuar në prova e fakte të plota po për mangësi e devijime të vogla që mund të kërkohej sqarim me shkrim nga subjekti, ose paraqitjen e dokumentacioni shtesë.

1.1.- Në lidhje me autobot uji në Deklarimin e “shtojcës 8” subjekti “H.” ka deklaruar depozitë uji 1000 l dhe kamion.

1.2.- Në lidhje me eskavator me çekiç në Deklarimin e “shtojcës 8” subjekti “B.” ka deklaruar “Eskavator Tip Hitachi me çekiç”.

Të dy mjetet/pajisje teknike janë lehtësisht të verifikueshme si nga ana fizike ashtu edhe nga ana dokumentare me kërkesë zyrtare edhe ndaj Bashkimit të Operatorëve Ekonomik.

Veprime në kundërshtim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet:

.....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

si dhe me pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku përcaktohet:

....Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjer në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

Referuar sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kishte kualifikuar Operatorin Ekonomik “B. & H.” duke renditur në vend të parë në klasifikimin e ofertuesve si dhe duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, mos veprim që ka sjellë **një efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Tropojë për 162,517.8 lekë pa TVSH** i ardhur nga diferenca e ofertës së shpallur fituese e OE “A. I.” prej 8,090,904.0 lekë dhe ofertës të shkualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të BOE “B. & H.” prej 7,928,386.2 lekë pa TVSH.

Çka ngarkon me përgjegjësi Komisionin e Vlerësimit të Ofertave J.Q, Kryetar, A.S, Anëtar, dhe B.B. anëtar.

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i Rrugës Lagjja Hysenukaj” me fond limit 2,083,279 lekë pa TVSH		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.125 datë 08.04.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr125, datë 08.04.2024 1. M. Gj. Kryetar 2. A. I. anëtar 3. T. K. Anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 126, datë 08.04.2024 1. J. Q. Kryetar 2., E. B. anëtar 3. A. S. Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur thjeshtë – Punë publike.”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,083,279 lekë	6. Oferta fituese: BOE “V. & G.”, me ofertë 1,755,450 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 2843, datë 28.06.2024, me afat 1 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 327,829 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 02.05.2024	9. Burimi Financimit: Buxheti Buxheti Bashkiak	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 BOE b) Kualifikuar 1 BOE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Në zbatim të urdhrin nr. 99, datë 12.03.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” Grupi i punës përbëhet nga E.M, H.I. dhe M.K, ka bashkëlidhur dokumenteve të tenderit: Specifikimet teknike, Relacionin teknik dhe Projekti i zbatimit Preventivi, Grafiku i punimeve të hartuara nga Përfaqësuesit e Drejtorisë së Planifikim Zhvillimit të Territorit Bashkia Tropojë nga M.V, E.M. dhe H.I.

Në dosjen e tenderit Grupi i punës përbëhet nga E.M, H.I. dhe M.K, ndërsa në Specifikimet teknike janë nënshkruar nga E.M, H.I. M.V. ky i fundit nuk është pjesë e Grupit të punës ngritur me urdhrin nr. 99, datë 12.03.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike”. Në dosje nuk administrohet projekt ideja e propozimit për miratimin në buxhet.

Në auditimin e kriterëve të vendosura **janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin** nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Konkretisht:

- Në pikën 2.3.5 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të DST është përcaktuar -Operatori ekonomik pjesëmarrës, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë: Kamion 1, Eskavator 0,25 m³, 1; Rul me vibrim 1; Autobot uji 1; Grejder 1.

- Grupi i auditimit, konstaton se në vendosjen e kriterëve 2.3.5. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, për disponimin Kamion 1, Eskavator 0,25 m³, 1; Rul me vibrim 1; Autobot uji 1; Grejder 1, nuk është përfshirë skreper pasi edhe në preventivin e paraqitur zë kryesor punimesh është “Gërmim transport dheu me skreper”. Veprim në kundërshtim me neni 77 të ligjit nr. 162/2020.

Referuar Procesverbalit datë 02.05.2024 “Për hapjen dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitimi i Rrugës Lagjja Hysenukaj” me fond limit prej 2,083,279 lekë pa TVSH, renditja e ofertuesve të paraqitur në tender është si më poshtë:

Nr	Subjektet	Vlera e ofertuar	Vërtetje
1	V. & G.	1,755,450	Kualifikuar
2	T.	1,797,479	S’kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 02.05.2024 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike dhe në datë 08.05.2024 ka hartuar Raportin Përmbledhës.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin nr. 1, datë 09.05.2024 “Mbi miratimin e klasifikimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit” ka shpallur fitues BOE “V. & G.”, si dhe ka s’kualifikuar OE “T.”.

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje dru Zjarri ” me fond limit 4,619,173.54 lekë pa TVSH		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.255 datë 02.08.2024	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr, 255, datë 08.04.2024 1. T. K. Kryetar 2. M. G. anëtar 3. E. M. anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 256, datë 02.08.2024 (ndryshuar me Urdhrin nr256/1, datë 21.08.2024) 1. J. Q. Kryetar 2., B. B. anëtar 3. A. S. Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur thjeshtë –Mallra		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,619,173.54 lekë	6. Oferta fituese: OE “L. A.”, me ofertë 4,500,410lekë pa TVSh, me kontratë nr. 3891, datë 26.09.2024, me afat 6 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 118,763.54 lekë pa TVSh

8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 03.09.2024	9. Burimi Financimit: Buxheti Buxheti Bashkiak	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Fondi limit dhe Projekti:

Në zbatim të urdhrit nr. 254, datë 02.08.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimeve teknike” Grupi i punës përbëhet nga S.M, F.M. dhe E.M, ka përcaktuar Specifikimet teknike për 1151 m³ Dru zjarri me çmim për njësi 4013.18 lekë/m³ dhe çmim total për 4,619,173.54 lekë. Bashkëlidhur dokumenteve të tenderit: “Projekt shëndetësimi dhe pastrimi mbeturinash të vlefshme për dru zjarri” për ngastrat 51/a; 70; 88/a; nga Projektuesi Inxh. S.M. dhe Grupi i Vlerësimit K.B. Drejtor, Inxh. S.M. dhe R.S. punonjës i Pyjeve.

Në auditimin e kriterëve të vendosura **janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.**

Konkretisht:

1. Nga Njësia e Prokurimit në **Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 2 Germa “c”** është përcaktuar se, *“Ofertuesi duhet të paraqesë”*:

Për të provuar përvojën e mëparshme OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ky argumentim është bërë sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku citohet "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoritetilenti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës".

Vendosja e këtij kriteri për kontrata të ngjashme jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës ka kufizuar pjesëmarrjen e OE në procedurën e prokurimit, e cila është në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, kreu V, neni 21, "Autoriteti dhe enti kontraktor" pika 1 ku Përcaktohet:

“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj”.

2. Nga Njësia e Prokurimit në **Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 2 Germa “d” dhe pika 3**, është përcaktuar se, *“Ofertuesi duhet të paraqesë”*:

- të ketë ne stafin teknik të paktën një inxh. Pyjesh, dhe të shoqëruar me diplomë ose Certifikatë kualifikimi/Leje profesionale, kontratë pune ose të figurojë në listë pagesat e operatorit ekonomik.

- të ketë të punësuar jo më pak se 2 (dy) punonjës të thjeshtë nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

3. Të tjera -Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin dëshmi për të paktën 2 (dy) automjete (pronësi ose me

qira), automjet transporti jo më pak se 3.5 ton.

- Grupi i auditimit, konstaton se në vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit pika 2 dhe pika 3 nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, nuk përputhet me natyrën dhe volumin e mallit të prokuruar “Dru Zjarri” në sasi prej 1922 mst ose 1151 m³.

Për realizimin me sukses të kontratës së prokuruar:

- nuk është marrë në konsideratë dhe nuk është vlerësuar disponimi i mjeteve apo pajisjet teknike të domosdoshme si dhe fuqia punëtore e disponueshme, për prerjen e druve të përcaktuara me damkosje, transporti nga ngastra pyjore në vend depozitimit për transport si dhe transporti deri në pikën e grumbullimit.

-nuk është kërkuar disponimi(në pronësi apo me qira) i një shesh depozitimi për drutë e zjarrit Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 77 pika 4 ku përcaktohet:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....

Referuar Procesverbalit datë 03.09.2024 “Për hapjen dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje dru Zjarri ” me fond limit 4,619,173.54 lekë pa TVSH, renditja e ofertuesve të paraqitur në tender është si më poshtë:

Nr.	Subjektet	Vlera e ofertuar	Vërejte
1	L. A.	4,500,410	Kualifikuar Me 16% pune ngjashme ?
2	O. H.	4,602,849	S’kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Procesverbalit datë 03.09.2024 ka dokumentuar hapjen e ofertave ekonomike dhe në datë 12.09.2024 ka hartuar Raportin Përmbledhës.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin nr. 1, datë 12.09.2024 “Mbi miratimin e klasifikimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit” ka shpallur fitues OE “L. A. ”, si dhe ka s’kualifikuar “O.H.”.

Konkluzion: Nga auditimi, u konstatua se vlerësimi nga KVO është bërë në përputhje me DST.

Për sa më sipër janë paraqitur observacionet: për Projektraportin e Auditimit nga Bashkia Tropojë me nr. 3219/36, datë 02.02.2026 ardhur në KLSH me nr. 467/7, datë 05.02.2026 nga Hartuesit e Dokumenteve të tenderit dhe Komisioni vlerësimit të ofertave: M.Gj, T.K, F.M, A.I, A.N, B.B, E.M, S.M, E.M, J.Q, A.S, E.B, për sa më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Procedurat e Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare “Besëlidhja e Malësisë”;

-konstatimi se në vendosjen e kriterëve 2.3.4 duhet të ishte përfshirë edhe 1-2 punonjës me profesion hidraulik pasi sipas preventivit rreth 10% e vlerës totale janë punime Hidrosanitare, ngrohje, termoizolimi, kanalizimi, duke qenë se, asnjëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit nuk është me profesion inxhinier nuk mundemi të përcaktojmë se sa punonjës ose profilet e punonjësve të cilët duhen për realizimin e punëve, këto punonjës dhe makineri gjithmonë na kanë ardhur me shkresë nga komisioni i Hartimit të dokumenteve, bashkëlidhur llogaritja.

- vendosja e kriterëve 2.3.2 për certifikatën ISO 45001-2018, është e pa azhurnuar pasi OE duhet të disponojnë/paraqesin edhe certifikatën për standardin e përditësuar (ISO 45001-2023) se pavarësisht se janë kërkuar certifikata ISO të paazhurnuara asnjë operator nuk është penalizuar në lidhje me këto certifikata pra nuk ka patur efekte negative, Ky përcaktim i këtyre certifikatave është bërë vetëm sepse ne nuk kemi qenë të informuar se duhet ti kërkojmë të azhurnuara dhe me asnjë qëllim tjetër.

- F.T, është Teknike ndërtimi, dhe nuk është e përfshirë në drejtuesit teknik në licencën e subjektit me nr. NZ.2798/17.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë;**

- Grupi i auditimit, konstaton se në vendosjen e kriterëve 2.3.4 duhet të ishte përfshirë edhe 1-2 punonjës me profesion hidraulik pasi sipas preventivit rreth 10% e vlerës totale janë punime Hidrosanitare, ngrohje, termoizolimi, kanalizimi. Nga njësia e prokurimit, miratuar nga Titullari i AK, është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 39 pika 6/c, ç.

- Nga njësia e prokurimit, miratuar nga Titullari i AK, është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 39 pika 7/c.

- BOE: "N. & M./S" në Deklarimin e shtojca 8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" në deklarin e punonjësve është përfshirë në deklarin e OE "N.", F.T, Teknike ndërtimi, ndërsa në licencën e subjektit me nr. NZ.2798/17 nuk është e përfshirë në drejtuesit teknik. Çka përbën mos plotësimin e Kriterit të Veçantë pika 2.3.2.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Procedurën e Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Kanaleve Vaditëse Ura Vigi i Vakës-Cerrnicë", nga Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit vendasja e kriterit që OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Në lidhje me këtë konstatim bashkëlidhur ju dërgojmë e mail-n e APP ku ne si komision kemi kërkuar sqarime nëse përcaktimi a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet është shkelje dhe nga sqarimi APP na është thënë që ky përcaktim nuk është në shkelje sepse kufiri minimal është 50%.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë;** vendosja e kriterëve 2.3.1. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 39 pika 5/a.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Procedurat e Prokurimit me objekt: "Rehabilitim i Ujëmbledhësit Rodogosh"

- Operatorit "F." në formularin e vetë deklarimit të llojit të makinerive nuk ka deklaruar disponimin e mjeteve "Matrapik" dhe "Fadrom", bashkëlidhur ju dërgojmë pjesën e kriterëve që na është vënë në dispozicion nga njësia e prokurimit ku nuk kërkohen si makineri as Matrapiku dhe as Fadroma.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **argumentimi nuk merret në konsideratë** observacioni mbi mos disponimin e mjeteve "Matrapik" dhe "Fadrom" OE "F." kërkesë e DST.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Procedurat e Prokurimit me objekt: "Rehabilitim i Ujëmbledhësit Zherka 1-2" vendosja e kriterëve të Licencës në kategorinë NS-18 A duhet të ishte shoqëruar edhe Inxhinier Topograf (ose gjeodet) kjo e përcaktuar edhe nga karakteristikat dhe llojin e punimeve të parashikuara në preventiv. Theksojmë se duke qenë se asnjëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit nuk është me profesion inxhinier nuk mundemi të përcaktojmë se sa punonjës ose profilet e punonjësve të cilët duhen për realizimin e punëve këto punonjës dhe makineri gjithmonë na kanë ardhur me shkresë nga komisioni i Hartimit të dokumenteve bashkëlidhur shkresën që na është vënë në dispozicion nga komisioni i hartimit të dokumenteve ku përllogariten fuqia punëtore dhe makineritë.

-BOE "B. & H." nuk plotëson kriterin 2.3.6 pasi nuk ka mjetet/pajisjet teknike të nevojshme e të kërkuara në këtë kriter të DST-së, konkretisht pompë moto ose ekuivalent autobot uji dhe kompresor ose ekuivalent eskavator me çekiç.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë** pasi vendosja e kriterëve të Licencës në kategorinë NS-18 A duhet të ishte shoqëruar edhe Inxhinier Topograf (ose gjeodet) kjo e përcaktuar edhe nga karakteristikat dhe llojin e punimeve të parashikuara në preventiv. Veprim në kundërshtim Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4, si dhe me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 pika 6.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE rezulton se shkualifikimi i nuk është i bazuar në prova e fakte të plota po për mangësi e devijime të vogla që mund të kërkohej sqarim me shkrim nga subjekti, ose paraqitjen e dokumentacioni shtesë.

1.1.- Në lidhje me autobot uji në Deklarimin e “shtojcës 8” subjekti “H.” ka deklaruar depozitë uji 1000 l dhe kamion.

1.2.- Në lidhje me eskavator me çekiç në Deklarimin e “shtojcës 8” subjekti “B.” ka deklaruar “Eskavator Tip Hitachi me çekiç”.

Të dy mjetet/pajisje teknike janë lehtësisht të verifikueshme si nga ana fizike ashtu edhe nga ana dokumentare me kërkesë zyrtare edhe ndaj Bashkimit të Operatorëve Ekonomik.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Procedurat e Prokurimit me objekt: “Rehabilitim i Rrugës Lagjja Hysenukja” për mos përfshirje në kërkesat e mjeteve e makinerive skreper pasi edhe në preventivin e paraqitur zë kryesor punimesh është “Gërmim transport dheu me skreper”. Konstatohet se duke qenë se asnjëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit nuk është me profesion inxhinier nuk mundemi të përcaktojmë se sa punonjës ose profilet e punonjësve të cilët duhen për realizimin e punëve këto punonjës dhe makineri gjithmonë na kanë ardhur me shkresë nga komisioni i Hartimit te dokumenteve.

- BOE “V. & G.” për përmbushjen e kriterit punëtorinë dhe stafin teknik që disponojnë ka deklaruar 4 manovratorë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, për përfshirje në kërkesat e mjeteve e makinerive skreper pasi edhe në preventivin e paraqitur zë kryesor punimesh shprehemi se **argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë** pasi është veprimi në kundërshtim me neni 77 të LPP 162/2020.

- Në lidhje me përmbushjen e kriterit punëtorinë dhe stafin teknik që disponojnë **argumentimi Juaj merret në konsideratë** dhe është pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Procedurat e Prokurimit me objekt: “Blerje Dru Zjarri”, komisioni i hartimit të dokumenteve në DST fillestare që është dërguar për tu hedhur në sistem nga njësia e prokurimit personit përgjegjës për sistemin . Sqarojmë se, në fillim procedura është hedhur me të gjitha kriteret por për arsye se nuk është paraqitur asnjë operator jemi detyruar ti thjeshtojmë dhe e kemi rihedhur si procedurë. Përsëri nuk është paraqitur asnjë operator jemi detyruar ta hedhim për të tretën herë dhe të thjeshtojmë kriteret në mënyrë që tu japim mundësinë operatorëve të paraqesin ofertat e tyre sepse situata ishte urgjente se ishte shumë vonë për realizimin e kësaj procedure dhe rrezikonim që institucionet të mbeteshin pa furnizim me dru zjarri që është e vetmja mënyrë ngrohje gjatë dimrit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë** pasi për realizimin me sukses të kontratës së prokuruar, nuk është marrë në konsideratë dhe nuk është vlerësuar disponimi i mjeteve apo pajisjet teknike të domosdoshme si dhe fuqia punëtore e disponueshme, për prerjen e druve të përcaktuara me damkosje, transporti nga ngastra pyjore në vend depozitimit për transport si dhe transporti deri në pikën e grumbullimit; nuk është kërkuar disponimi (në pronësi apo me qira) i një shesh depozitimi për drutë e zjarrit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 77 pika 4

2.2.4 Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave /punëve dhe shërbimeve.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave të punëve publike në Bashkinë Tropojë, në bazë të Programit të Auditimit nr. 777/1 prot., datë 17.07.2025, i ndryshuar; mbajtur më datë 14.11.2025, “Mbi Auditimin Përputhshmërisë “për periudhën nga data 01.01.2023-31.12.2024 dhe me afat të ri auditimi deri më datën 14.11.2025 rezultoi se: Nga Bashkia Tropojë për vitin 2023 dhe 2024 janë nënshkruar gjithsej **18** kontrata të punëve publike me fond limit pa tvsh në total **646,211** mijë lekë. Mbi bazën e materialitetit nga kontratat e mbetura për auditim me vlerë kontrate pa tvsh **251,568** mijë lekë, nga grupi i auditimit nga janë vlerësuar për auditim **4** kontrata me vlerë **195,699** mijë lekë pa tvsh, ose 78 % e vlerës së kontratave të zhvilluara, **tabela 1**. Janë kërkuar investimet e kryera për periudhën objekt auditimi të cilat janë për t’u audituar, paraqiten në tabelat më poshtë:

Tabela 1: Lista e kontratave të audituara, periudha 01.01.2023 – 31.12.2024

Nr.	Objekti i Prokurimit	Vlera e kontratës (Pa Tvsh)	Vlera e kontratës (Me Tvsh)	Operatori Ekonomik i Shpallur Fitues	Data e certifikatës së përkohshme	Vlerësuar për auditim
1	Objekti Sistemim- asfaltim I rrugës Bukove-Nigegaj –Qender-Luzhe	23,266,167	27,919,400.4	“Sh.”shpk	7/12/2023 0:00	PO
2	Projektim I rruges se fshatit Kasaj Bashkia Tropoje	57,519,605.4	69,023,526.48	“N.”shpk		PO
3	Sistemim asfaltim I lagjes Dardania	27,019,518	32,423,421.6	“Z.”shpk		PO
4	Ndertim dhe rikonstruksion urash Bashkia Tropoje	15,986,032.4	19,183,238.88			JO SPAK
5	Rikonstruksion I rruges Bybyl Breçani	42,425,171	50,910,205.2			JO SPAK
6	Rikonstruksion I kanaleve vaditese bashkia Tropoje viti 2023	1,905,971	2,287,165.2			JO
7	Asfaltim I rrugeve mbushje gropash viti 2023, per rruget e Bashkise Tropoje	5,580,765	6,696,918			JO
8	Rikonstruksion I 5(pese) segmenteve rrugore fshati Gri, Bujan Cernice, Tropoje	340,421,901	408,506,281.2			JO SPAK
9	Rikonstruksion I rrugës Blini I Grise-Lekurtaj	10,089,883	12,095,859			JO SPAK
10	Rikonstruksion I kanaleve vaditese Bashkia Tropoje 2024	2,290,672	2,748,806.4			JO
11	Ujesjellesi I fshatit Dragobi		68,269,460.11			JO SPAK
12	Rikonstruksion I shkollës së mesme Oso Dauti	37,728,928	45,274,714			JO SPAK
13	Rikonstruksion I thertores Shudenice + ndertimi I Tregut te bagetive	12,678,100	15,213,720			JO
14	Sistemim I tregut industrial Lagjia Dardania B.Curri	1,994,414	2,393,296			JO
15	Rrethimi dekorativ I stadiumit te lojrave me dore	3,321,287	3,985,544.4			JO
16	Rikonstruksion punime ndertimore sallën nr.1 e rinise tek muzeu	1,268,936	1,522,723			JO
17	Meremetim muzeu Historik Bajram Curri	7,437,582.62	8,925,099.14			JO
18	Rikonstruksion i shkollës 9-Vjeçare Beslidhja e Malësisë	55,277,700.44	66,333,240.44	BOE “N. M./S” shpk		PO
	Totali	199,560,718.46	251,568,720.6			
	Totali i përgjedhur	163,082,990.84	195,699,588.9			
	%	82%	78%			

Në mënyrë të detajuar situata e çdo kontrate paraqitet si vijon:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: **“Rikonstruksion i rrugës së fshatit “Kasaj”**, Bashkia Tropojë rezultoi se: Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së sipërmarrjes publike nr.2319 prot., datë 04.05.2023, lidhur midis AK Bashkia Tropojë dhe Kontraktorit OE “N.”shpk. Vlera e kontratës është 69,023,526.48

lekë me Tvsh. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj dhe punimet janë zbatuar në 12 muaj. -Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.2188/2 prot., datë 04.05.2023, midis AK Bashkia Tropojë dhe Mbikëqyrësit Mbikëqyrësit OE "M. P." shpk, me liçensë për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit MK.3752/4. -Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.2194/1 prot., datë 22.05.2023, midis AK Bashkia Tropojë dhe Kolaudatorit OE "V. E."sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3835/1. -Nga kontrolli i dokumentacioni tekniko-ligjor i vënë në dispozicion të GA rezultoi se: Dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 11.05.2023. Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 11.05.2023. Për këtë objekt kanë përfunduar sipas afateve kontraktuale. Afati i kontratës është parashikuar 12 muaj dhe punimet janë realizuar në 12 muaj. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 11.05.2024. Në dosjen teknike administrohet librezë e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar. Në dosjen teknike nuk janë shoqëruar me certifikata cilësie materialet e përdorura, gjithashtu mungojnë testimet dhe provat laboratorike për betonet, testet e ngjeshjes dhe provat granulometike për shtresat rrugore, kartotazhet. Në dosjen teknike administrohet librezë e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar. -Librezat e masave janë hartuar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" dhe udhëzimet nr.1 datë 16.06.2011, dhe nr.3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pasi ato nuk janë shoqëruara të gjitha me vizatime dhe skica ilustruese për çdo zë pune.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes tekniko-ligjore të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm rezultuan u konstatuan disa diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit, dhe projekt-preventivit të rishikuar si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës në kapitullin 1 Punime dherash prishje dhe riparime me nr analize An.164/1b "Mbushje me cakëll e gurë gurore në trupin e rrugës përhapur e ngjeshur me makieri për niveletë" i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 529.5m³ në vlerën 529,500 lekë; konstatohet se ky zë pune nuk është i justifikuar me vizatime dhe detaje se ku është përdorur. Referuar librezave të masave ky zë pune është raportuar në të njëjtat progresiva që janë raportuar gjurmimet në pjesën e trupit të rrugës, pra nuk mund të kemi si gjurmime dhe mbushje në të njëjtat progresiva. Vlera e përfutur padrejtësisht nga ana e Kontraktorit **529,500 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës në kapitullin 4 Vepra të vogla arti me nr analize 3.366 "Tombino me tuba betoni, mbi shtresë betoni" i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 63.8ml në vlerën 638,000 lekë, u konstatua se në terren gjatësia totale e tombinove ishte 58.9 ml, pra më e vogël sesa është raportuar kjo diferencë përbën vlerën **49,000 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Gjithashtu në lidhje me këtë zë pune u konstata se në terren tombinot ishin realizuar me Ø600 dhe jo me Ø800 siç është parashikuar në preventivin e punimeve. Sipas portalit të çmimeve dhe historikut të tij, ky zë pune në periudhën e firmosjes së situacionin përfundimtar rezultoi në vlerën 5,858.19 lekë/ml, pra ka një diferencë midis çmimit të fituar në tender 10,000 lekë/ml me çmimin me të cilin duhet të ishte korrigjuar preventive sipas punimeve faktike 5,858.19 lekë/ml. Vlerës 638,000 lekë duhet ti zbrisim vlerën 63.8mlx5,858.19 lekë/ml=373,753 lekë. Diferenca në vlerën 638,000 lekë -373,753 lekë = **264,247 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës në kapitullin 4 Vepra të vogla arti me nr analize 3.24 *Struktura monolite betoni me cakëll c12/15 shtresa*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 14.23m³ në vlerën 113,840 lekë, u konstatua se në terren tombinot nuk ishin realizuar me shtresë beton sipas përcaktimit në preventiv. Rrjedhimisht vlera **113,840 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik.**

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën 956,587.48 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve OE “M. P.” shpk, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: **“Rikonstruktion i shkollës 9-Vjeçare Beslidhja e Malësisë”** Bashkia Tropojë ku rezultoi se: - Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së zbatimit me nr. 3888 prot., datë 26.09.2024, lidhur midis AK Bashkisë Tropojë dhe Kontraktorit BOE “M./S”.shpk & “N.”shpk. Vlera e kontratës është 66,333,240.44 lekë me Tvsh. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 9 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr.3740/4 prot., datë 26.09.2024, midis AK Bashkisë Tropojë dhe Mbikëqyrësit të punimeve Mbikëqyrësit BOE PF D. Ll. & “A. MK”shpk, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.4327 dhe MK.2892/8. -Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.3610/1 prot., datë 15.08.2025, midis AK Bashkia Tropojë dhe Kolaudatorit OE “M. S”.sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit MK.1811/11. -Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i vënë në dispozicion të GA konstatohet se: Dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 07.10.2024. Për këtë objekt punimet nuk kanë përfunduar sipas afateve kontraktuale, pasi nuk është punar gjatë muajit janar për shak të reshjeve atmosferike dhe temperaturave të ulta. Për këto arsye është kryer një amendament i kontratës me zgjatje të afatit me një muaj nga afati fillestar i kontratës, amendamenti me nr.2558/2 prot., datë 18.06.2025. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 07.08.2025. Afati i kontratës është parashikuar 9 muaj dhe punimet janë pezulluar nga data 06.06.2023 deri në datën 14.08.2023, kjo për shkak të korigjimit të pasaktësive në projektin fillestar të zbatimit dhe miratimit të preventivit të rishikuar. Por kjo periudhë e pezullimit të punimeve nuk është materializuar me anë të akti juridik siç është amendamenti i kontratës, veprim për dijeni të kryetarit të Bashkisë Tropojë. Në dosjen teknike administrohet librezat e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.

-Në dosjen teknike nuk janë shoqëruar me certifikata cilësie materialet e përdorura, gjithashtu mungojnë testimet dhe provat laboratorike. Në dosjen teknike administrohet librezat e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar. -Librezat e masave janë hartuar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe udhëzimet nr.1 datë 16.06.2011, dhe nr.3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pasi ato nuk janë të sqaruara analitikisht, përmbajnë gabime dhe nuk janë shoqëruara me vizatime dhe skica ilustruese për çdo zë pune.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes tekniko-ligjore të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm u konstatuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si dhe

volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit, projekt-preventivit të rishikuar si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.426/12 Prishje suvatim solete ($h < 4m$)” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2,923 m², gjatë kontrollit të punimeve në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte realizuar pasi në një pjesë të madhe të klasave u vu re se nuk ishte ndërhyrë në prishjen e suvatimeve të soletës. Gjithashtu tek fotografitë e dosjes tekniko ligjore si dhe fotografi të gjetura në rrjetet sociale vihet re se nuk janë kryer prishjet e suvatimit. Sipas ligjit të mbikqyrjes së punimeve çdo proces pune në lidhje me punimet e maskuara duhet të jetë i shoqëruar me fotografi. Referuar situacionit përfundimtar konstatohet se kjo sasi 2,923 m² nuk përputhet as edhe me sasinë e raportuar për suvatimet e soletës 2,513 m². Rrjedhimisht volumi i raportuar prej 2,923 m² në vlerën **1,169,560 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.37/2a-Transport mat.ndertimi me auto deri 2km” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 327.7 m³, gjatë kontrollit të librezave të masave u vu re se në llogaritjen e këtyre volumeve janë futur disa zëra pune të cilat e kanë transportin të përfshirë në analizën e çmimit, rrjedhimisht sasia prej 213.9 m³ përbën dëm ekonomik i cili shkon në vlerën **32,085 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.326 Veshje me pllake majolike” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 524.9m², gjatë kontrollit në terren u konstatua se veshja e pllakave në tualete ishte realizuar në lartësinë 1.8m, ndërsa në librezat e masave kjo lartësi ishte llogaritur në mënyrë të gabuar me lartësinë 2m. Rrjedhimisht rezultuan diferenca në sasinë 71.96m² e cila përbën vlerën **158,312 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.196/b-Hidroizolim me nje shtrese astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komoonente A+B” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 510.7m². Gjatë kontrollit të librezave të masave rezultuan diferencat në volume në sasinë 230.72 m² e cila përbën vlerën **149,968 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.386/2-Dyer te blinduara importi” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 11.3m². Gjatë kontrollit në terren dhe librezave të masave rezultuan diferencat në volume në sasinë 4.3 m² e cila përbën vlerën **150,500 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.465-F.V. Ndricules tip plafoniere, emergjence, 1x18w, IP65” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 26 copë. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se nuk ishin vendosur ndriçues emergjence, vlera e tyre është përftuar padrejtësisht në situacionin përfundimtar në **vlerën 62,400 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.490/g F.V Kasete plastike KE me 48 modular (vende)” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 4 copë. Gjatë kontrollit në terren u konstatua kasetat plastike të automatëve ishin vendosur të tipit 24 modular pra më të vogla sesa preventivi i tenderuar duke pamundësuar Autoritetin Kontraktor për të shtuar automat të tjerë në rast nevojë. Vlera e tyre është përftuar padrejtësisht në situacionin përfundimtar në **vlerën 19,600 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “Pompa Riqarkulluese 65 PN 10 Temp. Punuese (-10..+120 °C) Presioni Nominal - max. 10 bar Lidhia e tubacionit: DN 65/PN10” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2 copë. Sipas preventivit janë parashikuar 2 pompa PN 65 dhe 1 pompë PN40 gjatë kontrollit në terren u konstatua ishin vendosur vetëm 2 pompa nga 3 të parashikuara. Rrjedhimisht vlera e pompës së gjetur në mangësi prej **90,000 lekë pa tvsh, përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës “2.375/1 F V dritare d/alumini plastike me dopio xham” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 290m², gjatë kontrollit në terren dhe librezave të masave u konstatua se ishin përfshirë në mënyrë të gabuar nga një dritare tualetesh shtesë

për të dy faqet anësore të objektit dhe për çdo kat. Sasia e dritareve llogaritet 4.48 m² e cila përbën vlerën **51,577.5 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës “*Shtrese betoni me stampim, me ngjyre*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 846.1m², gjatë kontrollit në terren dhe librezave të masave u konstatua kjo sasi nuk është llogaritur në mënyrë të saktë referuar matjeve faktike. Sipas matjeve sipërfaqja e betonit të stampuar është 585.4 m². Diferenca midis volumeve të raportuara dhe atyre faktike shkon në vlerën **646,498.8 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.239/a Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2,436.8 m², gjatë kontrollit të fotografive të dosjes tekniko ligjore vihet re se ky zë pune nuk është kryer në mënyrë korrekte pasi në korridore janë vendosur copa polisteroli në mënyrë jo të rregullt dhe të përzjerë me tuba dhe rërë (ref fotografisë në akt konstatimi). Ndërkohë që sipas preventivit të punimeve duhet të ishte kryer në fillim mbulimi i tubave dhe linjave sipas zërit rërë për nivelizim, pastaj duhej të realizohej shtresa e termoizolimit me polisterol. Për korridoret kryejmë zbritjet në sasinë 451.7 m² sasi e cila përbën vlerën **451,680 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës “2.404 *Boje hidroplastike*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 10,747.3 m², gjatë kontrollit të librezave të masave dhe gjatë kontrollit në terren u matën lartësitë e kateve Hk0=3.1m, Hk1=3.2m, Hk2=3.6m, Hk3=3.1m, ku u konstatua se në librezat e masave këto lartësi janë raportuar më të mëdha sesa fakti. Për rrjedhim rezultuan diferenca në sasinë 480.46m² sasi e cila përbën vlerën **69,438 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën 3,051,619 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër, mbikqyrësi i punimeve **BOE PF D. LI & “A. MK” shpk**, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Rikonstruksion sistemim asfaltim rruga Bukovë-Qendër Luzhë”, Bashkia Tropojë ku rezultoi:

-Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së zbatimit me nr.2319 prot., datë 04.05.2023, lidhur midis AK Bashkisë Tropojë dhe Kontraktorit OE “*Sh.*”shpk. Vlera e kontratës është 27,919,401.3 lekë me Tvsh. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj ose 180 ditë. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr.2186/2 prot., datë 04.05.2023, midis AK Bashkisë Tropojë dhe Mbikëqyrësit OE “*M.Ch.*”shpk dhe person fizik “*B.Y.*”, me liçensë për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit MK.3522/6 dhe MK.3877. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr.2194/1 prot., datë 22.05.2023, midis AK Bashkia Tropojë dhe Kolaudatorit të punimeve OE “*V.E.*” shpk, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3835/1. -Afati i kontratës për zbatimin e punimeve është parashikuar 6 muaj ose 180 ditë por punimet nuk kanë përfunduar brenda afateve fillestare kontraktuale. Për këtë objekt kanë ndodhur 2 zgjatje afatesh. Për arsye të reshjeve atmosferike është zgjatur afati i punimeve me 21 ditë nga data e rifillimit të punimeve sipas amendamentit nr.1 me nr.5156/1 prot., datë 16.11.2023. Ndërsa për shkak të mungesës së fabrikës së prodhimit të asfaltit në qarkun e Kukësit ka pasur vonesa të kalimit të asfaltit nga pika doganore e Kosovë, për këto arsye janë zgjatur afatet e punimeve sipas amendamentit nr.2 me nr.1716 prot., datë 11.04.2024. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi dhe mbajnë datën 03.05.2024 ndërsa këto njoftime janë protokolluar pranë bashkisë me nr.5628/2 datë

02.07.2024 dhe nr.5628/2 datë 02.07.2024 pra me rreth 2 muaj vonesë referuar amendamentit nr.2 të sipërcituar. Për këtë çështje nga ana e Bashkisë Tropojë dhe nga ana e kolaudatorit OE "V.E."shpk nuk janë mbajtur penaltete ndaj vonesave kontraktuale. Në dosjen teknike administrohet librezat e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar. -Librezat e masave janë hartuar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" dhe udhëzimet nr.1 datë 16.06.2011, dhe nr.3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pasi ato nuk janë shoqëruara me vizatime dhe skica ilustruese për çdo zë pune.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes tekniko-ligjore të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm u konstatuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit, projekt-preventivit të rishikuar si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "3.An-9 Mbushje me zhavorr pas mureve" i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 157.3m³ dhe në vlerën 163,120 lekë, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte realizuar. Rrjedhimisht vlera **163,120 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "3.212/c Shtresë stabilizant t=15 cm për trupin e rrugës", i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 5,901m² dhe në vlerën 2,065,350 lekë, gjatë kontrollit të dokumentacionit si dhe kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune është raportuar në mënyrë të gabuar në sasinë 5,901m², ndërkohë që duhet të ishte raportuar i barabartë me sasinë e shtresës së binderit 4,836.6m². Diferenca midis sasisë së raportuar me sasinë e llogaritur 5,901m²-4,836.6m²= 1,064 m² që përbën vlerën **425,760 lekë pa tvsh, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit, kjo vlerë përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "3.366-Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtresë betoni" në sasinë 31ml dhe në vlerën 303,769 lekë, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune ishte realizuar në sasinë 28.6 ml. Diferenca prej 2.4ml përbën vlerën **23,517.6 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën 612,398 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

-Mbikëqyrësi i punimeve OE "M.Ch."shpk &P.F "B.Y." nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet që:

<i>Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.</i>
--

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "Sistemim asfaltim i lagjes Dardania", Bashkia Tropojë ku rezultoi se: -Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së zbatimit me nr. 1215 prot., datë 24.20.2023, lidhur midis AK Bashkisë Tropojë dhe Kontraktorit OE "Z."shpk. Vlera e kontratës është 32,423,422 lekë me Tvsh. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj ose 180 ditë. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr.981/2 prot., datë 24.02.2023, midis AK Bashkisë Tropojë dhe Mbikëqyrësit OE "V.E." shpk, me licensë për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit MK.3835/1. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr.1493/1 prot., datë 28.03.2024, midis AK Bashkia Tropojë dhe Kolaudatorit të punimeve OE "E.-G"shpk, me licensë për mbikëqyrje

kolaudim punimesh MK.1015/16. Dorëzimi i sheshit të ndërtimit, procesverbali i fillimit të punimeve, akti i piketimit si dhe dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 24.03.2023. Afati i kontratës është parashikuar 6 muaj dhe punimet janë pezulluar nga data 06.06.2023 deri në datën 14.08.2023, kjo për shkak të korrigjimit të pasaktësive në projektin fillestar të zbatimit dhe miratimit të preventivit të rishikuar. Por kjo periudhë e pezullimit të punimeve nuk është materializuar me anë të akti juridik siç është amendamenti i kontratës. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 28.11.2023. Në dosjen teknike administrohet librezat e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar. -Në projektin e rishikuar mungojnë detajet teknike dhe vizatimet e profilet tërthore, detajet e mureve dhe detaje të tjera teknike sipas punimeve faktike në terren. -Librezat e masave janë hartuar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe udhëzimet nr.1 datë 16.06.2011, dhe nr.3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pasi ato nuk janë shoqëruara me vizatime dhe skica ilustruese për çdo zë pune. -Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes tekniko-ligjore të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm u konstatuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit, projekt-preventivit të rishikuar si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “3.212/b Shtresë stabilizant $t = 10$ cm për trupin e rrugës”, i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë $5,780.6\text{m}^2$ dhe në vlerën 1,271,732 lekë, gjatë kontrollit të dokumentacionit si dhe kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune është raportuar në mënyrë të gabuar në sasinë $5,780.6\text{m}^2$, ndërkohë që duhet të ishte raportuar i barabartë me sasinë e shtresës së binderit $5,414.2\text{m}^2$. Diferenca midis sasisë së raportuar me sasinë e llogaritur $5,780.6\text{m}^2 - 5,414.2\text{m}^2 = 366.4\text{m}^2$ që përbën vlerën **80,608 lekë pa tvsh, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit, kjo vlerë përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “3.158/5a-Transport dheu me auto deri në 5.0 km” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë $1,582.6\text{m}^3$ dhe në vlerën 69,634.4 lekë, ky zë pune është llogaritur në mënyrë të gabuar pasi duhet të ishte raportuar si rezultat i diferencës së zërave të gërmimeve me zërin “3.47/1b-Mbushje ,rrafshim,ngjeshje materialin të gërmuar më parë” pra do të kemi llogaritjen: $1,186.5\text{m}^3 + 396.1\text{m}^3 - 423.4\text{m}^3 = 1,159.2\text{m}^3$ kjo sasi përbën sasinë e llogaritur e cila duhet të ishte raportuar në situacion. Diferenca midis sasisë së raportuar me sasinë e llogaritur $1,582.6\text{m}^3 - 1,159.2\text{m}^3 = 423.4\text{m}^3 \times 44\text{lekë/m}^3 =$ **18,630 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.552-Tub betoni Ø 200 mm në bazament për montimin e shtyllave” i raportuar në situacionin përfundimtar në vlerën 15,435 lekë; sipas fotografive të vëna në dispozicion në dosjen tekniko-ligjore vihet re se ky zë pune nuk është realizuar me tuba betoni por me fikzimi i shtyllave është kryer me tuba korrogato. **Vlera 15,435 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “Analizë F.V Stola me skelet metalik dhe ndenjës druri” i raportuar në situacionin përfundimtar sasinë 15 copë në terren u konstatua se ishin vendosur 14 copë. **Vlera e një stoli i cili u gjet në mangësi prej 13,230 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “Analizë F.V Kosha për hedhjen e mbeturinave” i raportuar në situacionin përfundimtar sasinë 30 copë në terren u konstatua se ishin vendosur 14 copë. Vlera e 16 koshave të cilët u gjetën në mangësi llogaritet në vlerën **493,920 lekë pa tvsh, vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën 621,823 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

-Mbikqyrësi i punimeve OE “V.E.”shpk nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet që:

Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

2.2.5. Blerjet me vlerë të vogël:

Mbi Procedurat e prokurimit për blerje me vlerë të vogël për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar mbi blerjet e vogla, konstatohet që:

- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2023 është ngritur me Urdhër nr.11 të Kryetarit, nr.139 prot., datë 09.01.2023:

Komisioni i Blerjeve të vogla Viti 2023		
Emër Mbiemër	Pozicioni në komision	Njësia në strukturë
A. H.	Kryetare	Juriste
E. D.	Anëtare	Specialiste
F. M.	Anëtare	Specialiste

Punoi: Grupi auditimit

-Për vitin 2023 referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve në sistemin SPE janë kryer gjithsej 27 procedura prokurimi me vlerë të vogël për “Mallra” dhe “Shërbime”. Vlera totale e fondit limit 20,090,805 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur 15,548,283 lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit prej 4,542,522 lekë pa TVSh ose 22.6%.

-Janë përzgjedhur për tu audituar 6 procedura të kryera nëpërmjet sistemit SPE me vlerë 5,333,240 lekë pa TVSH, procedurat e prokurimit janë “Blerje me vlerë të vogël”, të dhënat sipas tabelës përmbledhëse mëposhtë:

Nr.	Objekti prokurimit	Procedura	Fondi limit pa TVSH	Vlera e Kontratës pa TVSH	Operatori Ekonomik	Urdhër Prokurimi
1	Riparim tubacionesh për vitin 2023	Blerje me vlerë të vogël	999,432	922,400	O. H.	Nr. 208 23.05.2023
2	Blerje mobilje për sallën e muzeut	Blerje me vlerë të vogël	788,200	700,000	K. B.	Nr. 210 25.05.2023
3	Blerje betoni për urën Kojel-Shumicë	Blerje me vlerë të vogël	952,200	931,040	V.	Nr. 243 20.06.2023
4	Blerje të gomave të makinës	Blerje me vlerë të vogël	990,000	862,000	N.	Nr. 378 09.11.2023
5	Shërbim mirëmbajtje automjesh	Blerje me vlerë të vogël	990,000	985,000	K. SHPK	Nr. 78 10.02.2023
6	Rikonstruksion i sinjalistikës së qytetit	Blerje me vlerë të vogël	999,853	932,800	“S. & R. S. S.”	Nr. 148 29.03.2023
	Shuma		5,719,685	5,333,240		

Burimi Bashkia Tropojë, pregatiti grupi i Auditimit

Procedurat e Prokurimit të kryera nëpërmjet sistemit SPE

1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit me objekt **“Riparim tubacionesh për vitin 2023”** Bashkia Tropojë, duke përfshirë dosjen fizike të prokurimit, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e disponueshme në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), u konstatua si më poshtë:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riparim tubacionesh për vitin 2023”		
Urdhër Prokurimi Nr.208, Dt 23.05.2023 REF-70082-05-23-2023	Njësia e Prokurimit - A. H. - E. D. - F. M.	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr.11 datë 09.01.2023 - A. H. - Kryetar - E. D. - Anëtar - F. M. - Anëtar
Lloji i Procedurës së Prokurimit Blerje me vlerë të vogël (mallra)		
Fondi Limit (pa TVSH) 999,432 lekë	Oferta fituese (pa TVSH) 922,400 Lekë Fitues “O. H.”	Diferenca me fondin limit 77,032 Lekë
Data e hapjes së tenderit 24.05.2023	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 16 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 15 OE
Ankimime Pranë AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka

Burimi, Bashkia Tropojë dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Burimi i financimit: Fonde të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Kërkesë: Nga sektori i urbanistikës në Bashkinë Tropojë është bërë Kërkesa me nr.2497 prot., datë 23.05.2023 drejtuar komisionit për blerjet e vogla, ku theksohet nevoja për riparim tubacionesh të dëmtuara si pasojë e përmbytjeve.

Nr.	Artikujt	Njësia	Sasia
1	F.V Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=110 mm	ml	200
2	F.V Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=500 mm	ml	48
3	F.V Tuba plastmasi për vaditje, Ø 25 mm	ml	1200
4	F.V Tuba plastmasi për vaditje, Ø 32 mm	ml	1000
5	F.V Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=200 mm	ml	234

Mbi përlllogaritjen e fondit limit: Për përlllogaritjen e fondit limit komisioni është bazuar në manualin e çmimeve të INSTAT. Grafiku i realizimit është 1 muaj.

-Në lidhje me vlerësimin e ofertave:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike pa TVSH	Arsyet e kualifikimit apo të s’kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	G. 001	583,300	<i>Kualifikuar</i>
2	A. B.	698,000	<i>Kualifikuar</i>
3	Sh. M.	758,120	<i>Kualifikuar</i>
4	B.	759,000	<i>Kualifikuar</i>
5	O. H.	922,400	<i>Kualifikuar</i>
6	K. B.	945,500	<i>Kualifikuar</i>
7	S. Rr.	950,000	<i>Kualifikuar</i>
8	J.	959,000	<i>Kualifikuar</i>
9	M. – M.	966,000	<i>Kualifikuar</i>
10	S. Xh.	969,990	<i>Kualifikuar</i>

Operatorë ekonomikë të skualifikuar: Nga KPVV është skualifikuar OE “V.” SHPK pasi ka paraqitur ofertë më të lartë se fondi limit.

Operatorë ekonomikë të kualifikuar:

- Nga KPVV është mbajtur renditja e OE në sistem ku ka rezultuar se, OE “G. 001”, me vlerë totale 583,300 lekë (pa tvsh), është renditur i pari.

- Procesverbal datë 25.05.2023 i mbajtur nga KPVV ku njoftohet se OE “G. 001” i renditur i pari, është skualifikuar pasi ka njoftuar tërheqjen nga procedura. Nga Autoriteti Kontraktor është njoftuar operatori ekonomik i renditur në vend të dytë.

- Procesverbal datë 30.05.2023 i mbajtur nga KPVV ku njoftohet se OE “A. B.” i renditur i dyti për këtë procedurë, është skualifikuar pasi nuk është paraqitur për dorëzimin e dokumentacionit. Nga Autoriteti Kontraktor njoftohet operatori ekonomik i renditur në vend të tretë.

- Procesverbal datë 31.05.2023 i mbajtur nga KPVV ku njoftohet se OE “Sh. M.” i renditur i treti për këtë procedurë, është skualifikuar pasi nuk është paraqitur për dorëzimin e dokumentacionit. Nga Autoriteti Kontraktor njoftohet operatori ekonomik i renditur në vend të katërt.

- Procesverbal datë 31.05.2023 i mbajtur nga KPVV ku njoftohet se OE “B.” i renditur i katërti, është skualifikuar pasi ka njoftuar tërheqjen nga procedura. Nga Autoriteti Kontraktor njoftohet operatori ekonomik i renditur në vend të pestë.

-Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël datë 31.05.2023 nëpërmjet sistemit SPE me Njoftim Fituesi ka shpallur fitues operatorin ekonomik renditur në vend të pestë “O. H.” me ofertë në vlerën 922,400 lekë pa tvsh, për procedurën me objekt “Riparim tubacionesh për vitin 2023”.

Zbatimi: Situacioni përfundimtar, është nënshkruar nga: z. Sh.V, z. I.H, z. I.Ç, z. F.N, z. E.H, z. S.H.

Urdhër shpenzimi Nr.444, datë 31.12.2024 referuar faturës Nr.76 datë 10.10.2023 me vlerë 1,106,880 lekë me TVSH. Është bërë likuidimi 100% i vlerës 1,106,880 lekë me TVSH.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion konstatohet se, nga AK nuk është vendosur si kriter kualifikues fuqia punëtore dhe mjete pune duke qenë se, procedura e prokurimit është “Furnizim Vendosje”. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe neni 78, pika 2 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim. Konstatohet se nuk është mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim si dhe nuk është dokumentuar me foto dhe dokumenta të tjerë vërtetues kryerja e procedurës së prokurimit. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, pika 35 “Dokumentimi i Lëvizjes së aktiveve”, pika 42 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

-Referuar faturës së lëshuar e cila në këtë rast ka vlerën e kontratës, duke qenë se nuk është mbajtur kontratë furnizimi, konstatohet se, OE “O. H.” nuk ka respektuar grafikun i punimeve sipas dokumenteve të tenderit ku parashikohet si afat 1 muaj për realizimin e procedurës. AK Bashkia Tropojë nuk kanë hartuar kontratë furnizimi me operatorin ekonomik fitues ku të ishin përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe penaltitetet ndërmjet palëve. Veprime në kundërshtim me me Kreu II i Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Neni 1, pika 2 dhe Neni 4, pika 14 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu 3.10 i Udhëzimit Nr.7, date 30.07.2021 i APP “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

- 1) Z. R. B. Kryetar i Bashkisë Tropojë
- 2) Znj. A. H. me detyrë Kryetare e komisionit për blerjet e vogla
- 3) Znj. E. D. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla
- 4) Znj. F. M. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla

2.Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje mobilje për sallën e muzeut**” Bashkia Tropojë, duke përfshirë dosjen fizike të prokurimit, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e disponueshme në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), u konstatua si më poshtë:

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje mobilje për sallën e muzeut”		
Urdhër Prokurimi Nr.210, Dt 25.05.2023 REF-70409-05-25-2023	Njësia e Prokurimit - A. H. - E. D. - F. M.	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr.11 datë 09.01.2023 - A. H. - Kryetar - E. D. - Anëtar - F. M. - Anëtar
Lloji i Procedurës së Prokurimit Blerje me vlerë të vogël (mallra)		
Fondi Limit (pa TVSH) 788,200 lekë	Oferta fituese (pa TVSH) 700,000 Lekë Fitues “K. B.”	Diferenca me fondin limit 88,200 Lekë
Data e hapjes së tenderit 26.05.2023	Burimi Financimit Donacione nga Banka Botërore	Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 27 OE b) S’kualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 23 OE
Ankimime Pranë AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka

Burimi, Bashkia Tropojë dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Burimi i financimit: Fonde të vëna në dispozicion prej donacione nga Banka Botërore.

Kërkesë: Nga Njësia e Integritimit Evropian dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj në Bashkinë Tropojë është bërë Kërkesa me nr.4295/2 prot., datë 18.05.2023 drejtuar komisionit për blerjet e vogla për mobilje për sallën e muzeut “Qendra Rinore” Tropojë.

Nr.	Artikujt	Njësia	Sasia
1	Tavolinë e gjatë për 5 kompjutera	copë	2
2	Tavolinë e thjeshtë për studim për një person pa sirtarë	copë	15
3	Karrige	copë	30
4	Etazher dy katësh me nga gjashtë kanate me xham dhe anësore katër kate me ndarje	copë	1

Mbi përlllogaritjen e fondit limit: Për përlllogaritjen e fondit limit nga komisioni për blerjet e vogla është mbajtur Procesverbal datë 25.05.2023 ku i është referuar çmimeve të tregut. Ky komision ka vendosur se vlera që nevojitet në total për këtë procedurë është 788,200 lekë pa TVSH.

-Në lidhje me vlerësimin e ofertave:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike pa TVSH	Arsyet e kualifikimit apo të s’kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	HB-G.	475,000	Kualifikuar
2	M. – M.	498,000	Kualifikuar
3	D. A	564,000	Kualifikuar
4	P.	588,000	Kualifikuar
5	A. D.	666,667	Kualifikuar
6	2R	680,000	Kualifikuar
7	K. B.	700,000	Kualifikuar
8	O. H.	711,000	Kualifikuar
9	S. N.	737,000	Kualifikuar
10	T. K.	740,700	Kualifikuar

Burimi, Bashkia Tropojë dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Operatorë ekonomikë të skualifikuar: OE “J. O. T. ”, OE “Sh. ”, OE “E. & E.” SHPK, OE “A.-K. ”, operatorët më sipër janë skualifikuar pasi, oferta e tyre ka rezultuar më e lartë se Fondi Limit i përcaktuar për këtë procedurë.

Operatorë ekonomikë të kualifikuar:

- Më datë 26.05.2023 Nga KPVV është mbajtur renditja e OE në sistem ku ka rezultuar se, OE “HB-G. ”, me vlerë totale 475,000 lekë (pa tvsh), është renditur i pari.

OE "HB-G." më datë 29.05.2023 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor se tërhiqet nga procedura për arsye të mos realizimit në kohë të procedurës.

-Procesverbal datë 29.05.2023 i KPVV ku njoftohet skualifikimi OE "HB-G." sipas njoftimit të tërheqjes në SPE. Nga Autoriteti Kontraktor është njoftuar operatori ekonomik i renditur në vend të dytë.

OE i renditur i dyti "M. – M.", më datë 30.05.2023 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor se tërhiqet nga procedura për arsye objektive (pamjaftueshmëri të kohës fizike).

-Procesverbal datë 30.05.2023 i KPVV ku njoftohet skualifikimi OE "M. – M." sipas njoftimit të tërheqjes në SPE. Nga Autoriteti Kontraktor është njoftuar operatori ekonomik i renditur në vend të tretë.

-Procesverbal datë 31.05.2023 i mbajtur nga KPVV ku njoftohet se OE "D. Albania" i renditur i treti për këtë procedurë, është skualifikuar pasi nuk është paraqitur për dorëzimin e dokumentacionit. Nga Autoriteti Kontraktor njoftohet operatori ekonomik i renditur në vend të katërt.

OE i renditur i katërti "P.", më datë 01.06.2023 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor se tërhiqet nga procedura për arsye objektive (pamjaftueshmëri të kohës fizike).

-Procesverbal datë 01.06.2023 i KPVV ku njoftohet skualifikimi OE "P." sipas njoftimit të tërheqjes në SPE. Nga Autoriteti Kontraktor është njoftuar operatori ekonomik i renditur në vend të pestë.

OE i renditur i pesti "A. D.", më datë 02.06.2023 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor se tërhiqet nga procedura për arsye të pamjaftueshmërisë së kohës për realizimin e kësaj procedure.

-Procesverbal datë 02.06.2023 i KPVV ku njoftohet skualifikimi OE "A. D." sipas njoftimit të tërheqjes në SPE. Nga Autoriteti Kontraktor është njoftuar operatori ekonomik i renditur në vend të gjashtë.

OE i renditur i gjashti "2R.", më datë 05.06.2023 ka njoftuar Autoritetin Kontraktor se tërhiqet nga procedura për arsye të paparashikuara teknike/shëndetsore.

-Procesverbal datë 05.06.2023 i KPVV ku njoftohet skualifikimi OE "2R." sipas njoftimit të tërheqjes në SPE. Nga Autoriteti Kontraktor është njoftuar operatori ekonomik i renditur në vend të shtatë.

-Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël datë 05.06.2023 nëpërmjet sistemit SPE me Njoftim Fituesi ka shpallur fitues operatorin ekonomik renditur në vend të shtatë "K. B." me ofertë në vlerën 700,000 lekë pa tvsh, për procedurën me objekt "Blerje mobilje për sallën e muzeut".

Marrja në dorëzim: Urdhër i Drejtuesit të Institucionit nr.329 prot., datë 22.09.2023, "Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave që blihen nga Bashkia Tropojë për vitin 2023", referuar ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji Nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik". Ky komision përbëhet nga: z. B.B, z. E.M, z. B.B. Ky grup do të funksionojë deri më datë 31.12.2023.

-Procesverbal nr.4182/1 prot., datë 05.10.2023 për marjen në dorëzim të mallrave mbajtur në magazinën e Bashkia Tropojë në prezencë të magazinierit z. N.D. ku evidentohet se, mallrat e paraqitur nga OE "K. B." janë konform ftesës për ofertë dhe listës së përcaktuar nga komisioni për blerjet e vogla.

Likujdimi është bërë sipas Urdhër Transferte datë 03.10.2023 në vlerën 670,000 lekë dhe Urdhër Transferte datë 31.12.2024 në vlerën 30,000 lekë. Forma e likujdimit është kryer nëpërmjet urdhër transfertave bankare, duke qenë se fondet kanë qenë donacione.

Konkluzion: Nga komisioni për blerjet e vogla nuk janë mbajtur në procesverbal treguesit e çmimeve për përcaktimin e fondit limit. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me neni 76, pika 2 "Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit" i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe pika 7, Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021

i APP “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

-Nga AK është vendosur në DST si kriter kualifikues “Afati i lëvrimit të mallit do të jetë 24 orë, duke filluar nga momenti i publikimit në Sistemin Elektronik të njoftimit të fituesit”. Ky kriter nuk është argumentuar dhe ka qenë penalizues për operatorët ekonomikë që janë shpallur fitues, duke i detyruar të tërhiqen nga kjo procedurë për arsye të pamjaftueshmërisë së kohës për realizimin e saj. Veprime në kundërshtim me pikën 1,2 c, neni 2 “Dokumentimi i procesit”, neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Referuar Procesverbalit të marrjes në dorëzim rezulton se, lëvrimi i mallit nga OE fitues “K.B.” nuk është bërë brenda 24 orëve duke filluar nga momenti i publikimit në Sistemin Elektronik të njoftimit të fituesit, sipas përcaktimit në DST. Njoftimi i Fituesit në SPE është mbajtur në datën 05.06.2023 dhe malli është lëvruar datë 05.10.2023, pra 4 muaj me vonesë. Bashkia Tropojë nuk ka lidhur kontratë furnizimi me operatorin ekonomik fitues ku të ishin përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe penalitetet ndërmjet palëve. Veprime në kundërshtim me Kreu II i Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin Nr.7, date 30.07.2021 i APP “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”, kreu 3.10 “Krijimi dhe dërgimi për publikim në SPE i njoftimit të lidhjes së kontratës”.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

- 1) Znj. A. H. me detyrë Kryetare e komisionit për blerjet e vogla
- 2) Znj. E. D. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla
- 3) Znj. F. M. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla

3.Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje beton për urën Kojel-Shumicë**” Bashkia Tropojë, duke përfshirë dosjen fizike të prokurimit, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e disponueshme në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), u konstatua si më poshtë:

3.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje beton për urën Kojel-Shumicë”		
Urdhër Prokurimi Nr.243, Dt 20.06.2023 REF-73222-06-21-2023	Njësia e Prokurimit - A. H. - E. D. - F. M.	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr.11 datë 09.01.2023 - A. H. - Kryetar - E. D. - Anëtar - F. M. - Anëtar
Lloji i Procedurës së Prokurimit Blerje me vlerë të vogël		
Fondi Limit (pa TVSH) 952,200 lekë	Oferta fituese (pa TVSH) 931,040 Lekë Fitues OE “V.” SHPK	Diferenca me fondin limit 21,160 Lekë
Data e hapjes së tenderit 22.06.2023	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 12 OE b) S’kualifikuar 6 OE, c) Kualifikuar 6 OE
Ankimime Pranë AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka

Burimi, Bashkia Tropojë dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Burimi i financimit: Fonde të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Kërkesë: Nga Sektor i Urbanistikës në Bashkinë Tropojë është bërë Kërkesa me nr.4801/1 prot., datë 08.11.2022 drejtuar komisionit për blerjet e vogla për blerje betoni për riforcimin e këmbëve të urës Kojel-Shumicë.

Nr.	Artikujt	Njësia	Sasia
1	Blerje Betoni M-200 + transport	M3	105.8

Mbi përlogaritjen e fondit limit: Për përlogaritjen e fondit limit komisioni është mbështetur në studimin e tregut.

-Në lidhje me vlerësimin e ofertave:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike pa TVSH	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	K. B.	850,000	Kualifikuar
2	V.	931,040	Kualifikuar
3	B.	935,000	Kualifikuar
4	A.	947,700	Kualifikuar
5	O. H.	950,084	Kualifikuar
6	3V A.	952,200	Kualifikuar
7	HB-G.	958,000	Skualifikuar, oferta mbi fondin limit
8	2-M.	969,000	Skualifikuar, oferta mbi fondin limit
9	J.	978,000	Skualifikuar, oferta mbi fondin limit
10	G. 001	979,000	Skualifikuar, oferta mbi fondin limit

Burimi, Bashkia Tropojë dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Operatorë ekonomikë të skualifikuar: OE “HB-G.”, OE “2-M.”, OE “J.”, OE “G. 001”, OE “O. M. M.”, OE “K.” SHPK, operatorët më sipër janë skualifikuar pasi oferta e tyre ka rezultuar më e lartë se Fondi Limit i përcaktuar për këtë procedurë.

Operatorë ekonomikë të kualifikuar:

- Më datë 22.06.2023 nga KPVV është mbajtur renditja e OE në sistem ku ka rezultuar se, OE “K. B.”, me vlerë totale 850,000 lekë (pa TVSH), është renditur i pari.

Procesverbal datë 22.06.2023 i KPVV ku konstatohet se, sipas renditjes OE “K. B.” rezulton e renditur e para me ofertë ekonomike 850,000 lekë pa TVSH.

Procesverbal për kalimin tek operatori ekonomik i radhës datë 26.06.2023 drejtuar OE “K. B.” i cili është skualifikuar nga procedura e prokurimit me objekt: “Blerje beton për urën Kojel-Shumicë” pasi nuk është paraqitur për dorëzimin e dokumentacionit.

-Procesverbal i KPVV datë 17.07.2023 për kalimin tek operatori ekonomik i radhës për procedurën “Blerje beton për urën Kojel-Shumicë”, ku njoftohet se pas skualifikimit të Operatorit Ekonomik të renditur i pari, komisioni vazhdoi njoftimin me operatorin e renditur në vend të dytë OE “V.” SHPK me ofertë ekonomike 931,040 lekë pa TVSH.

-Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël datë 17.07.2023 nëpërmjet sistemit SPE me Njoftim Fituesi ka shpallur fitues operatorin ekonomik renditur në vend të dytë “V.” SHPK me ofertë në vlerën 931,040 lekë pa TVSH, për procedurën me objekt: “Blerje beton për urën Kojel-Shumicë”.

Marrja në dorëzim: Urdhër i Drejtuesit të Institucionit nr.3807 prot., datë 28.08.2023, “Për caktimin e komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve për objektin Blerje beton Ura Kojel-Shumicë”, referuar ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimin e këshillit të ministrave Nr.1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr.3 datë 15.02.2001 të këshillit të ministrave, për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”. Ky komision përbëhet nga: z. B. S. Kryetar, z. M. V. Anëtar, z. B. H. Anëtar, z. F. N. Anëtar, z. A. C. Anëtar.

-Certifikatë e Marrjes në Dorëzim datë 29.08.2023 për marrjen në dorëzim të punimeve për objektin “Blerje beton Ura Kojel-Shumicë”, ku citohet se objekti është realizuar konform kriterëve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe është realizuar me cilësi koform ligjeve në fuqi dhe udhëzimeve përkatëse. Ky dokument është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim si më sipër.

-Situacioni përfundimtar, është nënshkruar nga: z. B. S, z. M. V, z. B. H, z. F. N, z. A. C. dhe përfaqësuesi i OE “V.” SHPK z. B. B.

Urdhër shpenzimi Nr.35, datë 13.02.2023 referuar faturës Nr.131 datë 13.09.2023 me vlerë 1,117,248 lekë me TVSH dhe sipas certifikatës të marrjes në dorëzim datë 29.08.2023 është bërë likuidimi 100% i vlerës 1,117,248 lekë me TVSH.

Konkluzion: Nga komisioni për blerjet e vogla nuk janë mbajtur në procesverbal treguesit e çmimeve për përcaktimin e fondit limit. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me neni 76, pika 2 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pika 7, Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 i APP.

-Nga komisioni për blerjet e vogla nuk është mbajtur një procesverbal ku të argumentohen specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për këtë procedurë. Veprime në kundërshtim me pikën 11, Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 i APP “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

- 1) Znj. A. H. me detyrë Kryetare e komisionit për blerjet e vogla
- 2) Znj. E. D. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla
- 3) Znj. F. M. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla

4.Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje goma të makinerive**” Bashkia Tropojë, duke përfshirë dosjen fizike të prokurimit, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e disponueshme në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), u konstatua si më poshtë:

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje goma të makinerive, Bashkia Tropojë”		
Urdhër Prokurimi Nr.378, Dt 09.11.2023 REF-86901-11-09-2023	Njësia e Prokurimit - A. H. - E. D. - F. M.	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr.11 datë 09.01.2023 - A. H. - Kryetar - E. D. - Anëtar - F. M. - Anëtar
Lloji i Procedurës së Prokurimit Blerje me vlerë të vogël (mallra)		
Fondi Limit (pa TVSH) 990,000 lekë	Oferta fituese (pa TVSH) 862,000 Lekë Fitues “N.”	Diferenca me fondin limit 128,000 Lekë
Data e hapjes së tenderit 10.11.2023	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 23 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 22 OE
Ankimime Pranë AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik- nuk ka

Burimi, Bashkia Tropojë dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Burimi i financimit: Fonde të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Kërkesë: Nga Drejtoria e Shërbimeve Bashkia Tropojë është bërë Kërkesa me nr.5051 prot., datë 08.11.2023 drejtuar komisionit për blerjet e vogla për blerje goma makinerishë për nevoja të Bashkisë Tropojë.

Nr.	Emërtimi i Mallit	Numri i Gomave	Njësia	Sasia
1	Fadromë JCB 3Cx	12.5.18; 18.4.26	Copë	1
2	Fadromë JCB 4Cx	16.9.28 14	Copë	4
3	Makinë Pastrimi Stayer	315/80 R 22.5	Copë	6
4	Kamion Volvo	11 R 22.5	Copë	4
5	Kamionçinë Benz	235 R 17.5	Copë	4
6	Autobot Uji Benz	10.00 R 20	Copë	4
7	Vinç Benz	235 R 17.5	Copë	4

8	Makinë Pastrimi Renault	315/80 R 22.5	Copë	4
9	Furgon Ducato	185 R 14 C	Copë	2

Mbi përlllogaritjen e fondit limit: Për përlllogaritjen e fondit limit nga komisioni për blerjet e vogla është mbajtur Procesverbal datë 09.11.2023 ku i është referuar çmimeve të tregut. Ky komision ka vendosur se vlera që nevojitet në total për këtë procedurë është 990,000 lekë pa TVSH.

-Në lidhje me vlerësimin e ofertave:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike pa TVSH	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	O&A	500,000	Kualifikuar
2	3V A.	585,000	Kualifikuar
3	K. 06	746,800	Kualifikuar
4	S. R.	768,000	Kualifikuar
5	N.	862,000	Kualifikuar
6	S. & C. C.	886,800	Kualifikuar
7	A. K.	895,000	Kualifikuar
8	T.L.	898,000	Kualifikuar
9	i.Auto	929,000	Kualifikuar
10	A.T.	937,700	Kualifikuar

Burimi, Bashkia Tropojë dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Operatorë ekonomikë të skualifikuar: OE "A. M.", është skualifikuar pasi, oferta ka rezultuar më e lartë se Fondi Limit i përcaktuar për këtë procedurë.

Operatorë ekonomikë të kualifikuar:

- Më datë 10.11.2023 nga KPVV është mbajtur renditja e OE në sistem ku ka rezultuar se, OE "O&A", me vlerë totale 500,000 lekë (pa TVSH), është renditur i pari.

Procesverbal datë 10.11.2023 i KPVV ku konstatohet se, sipas renditjes OE "O&A" rezulton i renditur i pari me ofertë ekonomike 500,000 lekë pa TVSH për procedurën me objekt: "Blerje goma të makinerive, Bashkia Tropojë".

Procesverbal i KPVV datë 10.11.2023 ku njoftohet se OE "O&A" i renditur i pari është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Procesverbal i KPVV datë 14.11.2023 ku njoftohet se OE "3V A." i renditur i dyti është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Procesverbal i KPVV datë 16.11.2023 ku njoftohet se OE "K. 06" i renditur i treti është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Procesverbal i KPVV datë 17.11.2023 ku njoftohet se OE "S. R." i renditur i katërti është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël datë 17.11.2023 nëpërmjet sistemit SPE me Njoftim Fituesi ka shpallur fitues operatorin ekonomik renditur në vend të pestë "N." SHPK me ofertë në vlerën 862,000 lekë pa TVSH, për procedurën me objekt: "Blerje goma të makinerive, Bashkia Tropojë".

Marrja në dorëzim: Urdhër nr.378/1 i Drejtuesit të Institucionit, 5072/2 prot., datë 04.12.2023, "Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave që blihen nga Bashkia Tropojë", referuar ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji Nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit Nr.162 datë 23.12.2002 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për rregullat e Prokurimit Publik", Udhëzimi Nr.7 datë 30.07.2021 "Për procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" i ndryshuar. Ky komision përbëhet nga: z. N. Gj. Kryetar, z. S. D. Anëtar, z. B. B. Anëtar.

-Akt Konfirmim i Marrjes në Dorëzim datë 04.12.2023 për marrjen në dorëzim të mallrave për procedurën me objekt "Blerje goma të makinerive, Bashkia Tropojë", ku citohet se nga verifikimi fizik i parametrave, cilësisë dhe sasisë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor rezulton se, mallrat i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara në ftesën për ofertë. Ky dokument

është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim si më sipër. Fletë-Hyrje në magazinë Nr.63 datë 04.12.2023.

Urdhër shpenzimi Nr.75, datë 27.03.2024 referuar faturës Nr.86 datë 04.12.2023 dhe Fletë-Hyrje Nr.63 datë 04.12.2023 me vlerë 1,034,400 lekë me TVSH dhe sipas akt-konfirmimit të marrjes në dorëzim datë 04.12.2023 është bërë likuidimi 100% i vlerës 1,034,400 lekë me TVSH.

Konkluzion: Nga komisioni për blerjet e vogla nuk janë mbajtur në procesverbal treguesit e çmimeve për përcaktimin e fondit limit. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me neni 76, pika 2 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pika 7, Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 i APP “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

-Referuar faturës së lëshuar nga AK rezulton se, nga ana e OE “N.” nuk është respektuar afati i shërbimit/punës sipas dokumenteve të tenderit ku parashikohet si afat 5 ditë për kryerjen e shërbimit/punës.

-AK Bashkia Tropojë nuk kanë hartuar kontratë furnizimi me operatorin ekonomik fitues ku të ishin përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe penaltitetet ndërmjet palëve. Veprime në kundërshtim me me Kreu II i Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin Nr.7, date 30.07.2021 i APP “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”, kreu 3.10 “Krijimi dhe dërgimi për publikim në SPE i njoftimit të lidhjes së kontratës”.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

- 1) Znj. A. H. me detyrë Kryetare e komisionit për blerjet e vogla
- 2) Znj. E. D. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla
- 3) Znj. F. M. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla

5.Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “**Shërbim për mirëmbajtje automjetesh për Bashkinë Tropojë**”, duke përfshirë dosjen fizike të prokurimit, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e disponueshme në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), u konstatua si më poshtë:

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim për mirëmbajtje automejetesh për Bashkinë Tropojë”		
Urdhër Prokurimi Nr.78, Dt 10.02.2023 REF-58681-02-10-2023	Njësia e Prokurimit - A. H. - E. D. - F. M.	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr.11 datë 09.01.2023 - A. H. - Kryetar - E. D. - Anëtar - F. M. - Anëtar
Lloji i Procedurës së Prokurimit Blerje me vlerë të vogël (mallra)		
Fondi Limit (pa TVSH) 990,000 lekë	Oferta fituese (pa TVSH) 985,000 Lekë Fitues “K.” SHPK	Diferenca me fondin limit 5,000 Lekë
Data e hapjes së tenderit 13.02.2023	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 10 OE b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 7 OE
Ankimime Pranë AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka

Burimi i financimit: Fonde të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Kërkesë: Nga Drejtoria e Shërbimeve Bashkia Tropojë është bërë Kërkesa me nr.89 prot., datë 05.01.2023 për pjesë këmbimi drejtuar komisionit për blerjet e vogla për mirëmbajtje automjetesh viti 2023.

Mbi përlogaritjen e fondit limit: Për përlogaritjen e fondit limit nga komisioni për blerjet e vogla është mbajtur Procesverbal datë 10.02.2023 ku i është referuar çmimeve të tregut. Ky komision ka vendosur se vlera që nevojitet në total për këtë procedurë është 990,000 lekë pa TVSH.

-Në lidhje me vlerësimin e ofertave:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike pa TVSH	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	S. R.	768,000	Kualifikuar
2	B.	917,700	Kualifikuar
3	HB-G.	945,000	Kualifikuar
4	J.	954,000	Kualifikuar
5	O. M. M.	968,000	Kualifikuar
6	B. A.	974,300	Kualifikuar
7	K.	985,000	Kualifikuar
8	B. C.	258,000	Skualifikuar, oferta anomalisht e ulët
9	S.	350,000	Skualifikuar, oferta anomalisht e ulët
10	T.	1,000,000	Skualifikuar, oferta mbi fondin limit

Burimi, Bashkia Tropojë dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Operatorë ekonomikë të skualifikuar: OE "B.C.", OE "S." janë skualifikuar pasi kanë paraqitur ofertë anomalisht të ulët. OE "T." është skualifikuar pasi oferta ka rezultuar më e lartë se Fondi Limit i përcaktuar për këtë procedurë.

Operatorë ekonomikë të kualifikuar:

- Më datë 13.02.2023 nga KPVV është mbajtur renditja e OE në sistem ku ka rezultuar se, OE "S. R.", me vlerë totale 768,000 lekë (pa TVSH), është renditur i pari.

Procesverbal datë 13.02.2023 i KPVV ku konstatohet se, sipas renditjes OE "S. R." rezulton i renditur i pari me ofertë ekonomike 768,000 lekë pa TVSH për procedurën me objekt: "Shërbim për mirëmbajtje automejetesh për Bashkinë Tropojë".

Procesverbal i KPVV datë 14.02.2023 ku njoftohet se OE "S. R." i renditur i pari është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Procesverbal i KPVV datë 15.02.2023 ku njoftohet se OE "B." i renditur i dyti është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Procesverbal i KPVV datë 16.02.2023 ku njoftohet se OE "HB-G." i renditur i treti është tërhequr nga procedura për arsye të pamundësisë për realizimin në kohë dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Procesverbal i KPVV datë 17.02.2023 ku njoftohet se OE "J." i renditur i katërti është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Procesverbal i KPVV datë 20.02.2023 ku njoftohet se OE "O. M. M." i renditur i pesti është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Procesverbal i KPVV datë 22.02.2023 ku njoftohet se OE "B. A." i renditur i gjashti është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël datë 22.02.2023 nëpërmjet sistemit SPE me Njoftim Fituesi ka shpallur fitues operatorin ekonomik renditur në vend të shtatë "K." SHPK me ofertë në vlerën 985,000 lekë pa TVSH, për procedurën me objekt: "Shërbim për mirëmbajtje automejetesh për Bashkinë Tropojë".

Marrja në dorëzim: Urdhër shpenzimi Nr.179, datë 17.05.2023 referuar faturës Nr.8 datë 21.03.2023 me vlerë 602,000 lekë me TVSH dhe Urdhër shpenzimi Nr.125, datë 04.04.2023 referuar faturës Nr.8 datë 21.03.2023 me vlerë 580,000 me TVSH. Është bërë likuidimi 100% i vlerës së faturës Nr.8 datë 21.03.2023 në vlerën 1,106,880 lekë me TVSH.

Konkluzion: Nga komisioni për blerjet e vogla nuk janë mbajtur në procesverbal treguesit e çmimeve për përcaktimin e fondit limit. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me neni 76, pika 2 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pika 7, Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 i APP “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

-Titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim. Konstatohet se nuk është mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim si dhe nuk është dokumentuar me foto dhe dokumenta të tjerë vërtetues kryerja e procedurës së prokurimit. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me, Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, pika 35 “Dokumentimi i Lëvizjes së aktiveve”, pika 42 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

-AK Bashkia Tropojë nuk kanë hartuar kontratë furnizimi me operatorin ekonomik fitues ku të ishin përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe penalitetet ndërmjet palëve. Veprime në kundërshtim me Kreu II i Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Neni 1, pika 2 dhe Neni 4, pika 14 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

- 1) Z. R. B. Kryetar i Bashkisë Tropojë
- 2) Znj. A. H. me detyrë Kryetare e komisionit për blerjet e vogla
- 3) Znj. E. D. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla
- 4) Znj. F. M. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla

6.Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i sinjalistikës horizontale të qytetit faza-1”, Bashkia Tropojë duke përfshirë dosjen fizike të prokurimit, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e disponueshme në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), u konstatua si më poshtë:

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i sinjalistikës horizontale të qytetit faza-1”		
Urdhër Prokurimi Nr.148, Dt 29.03.2023 REF-64094-03-29-2023	Njësia e Prokurimit - A. H. - E. D. - F. M.	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr.11 datë 09.01.2023 - A. H. - Kryetar - E. D. - Anëtar - F. M. - Anëtar
Lloji i Procedurës së Prokurimit Blerje me vlerë të vogël		
Fondi Limit (pa TVSH) 999,853 lekë	Oferta fituese (pa TVSH) 932,800 Lekë Fitues “S. & R. S. S.” SHPK	Diferenca me fondin limit 67,053 Lekë
Data e hapjes së tenderit 30.03.2023	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 11 OE b) S’kualifikuar nuk ka, c) Kualifikuar 11 OE
Ankimime Pranë AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
Lidhja e Kontratës nr. 1782/2 prot. datë 12.04.2023	Vlera e Kontratës (me TVSH) 1,119,360 lekë	Afati i Kontratës 4 javë

Burimi, Bashkia Tropojë dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Burimi i financimit: Fonde të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Kërkesë: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Tropojë është bërë Kërkesa me nr.1631 prot., datë 23.03.2023 drejtuar komisionit për blerjet e vogla për rikonstruksionin e sinjalistikës horizontale të qytetit.

Nr.	Përshkrimi i Punimeve	Njësia	Sasia
1	Pastrim e përgatitje për vijëzim	m2	1,200
2	Vijëzim me shirita gjatësore dhe anësore me gjerësi 15 cm akrelike	ml	5,135
3	Bojë akrelike K.Këmbësorësh D.Lëvizjesh	m2	426

Mbi përlogaritjen e fondit limit: Për përlogaritjen e fondit limit komisioni është bazuar në manualin e çmimeve të INSTAT. Grafiku i realizimit është 4 javë.

Specifikimet Teknike: Hartuar nga inxhinier E. M, arkitekt H. I. dhe teknik M. V, janë në përputhje me nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Projekt Zbatimi: Hartuar nga Ing. E. M, Ark. H. I. dhe Tek. M. V.

-Në lidhje me vlerësimin e ofertave:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta ekonomike pa TVSH	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	S. R.	768,000	Kualifikuar
2	E. Z.	890,000	Kualifikuar
3	3E C.	920,000	Kualifikuar
4	S. & R. S. S.	932,800	Kualifikuar
5	HB-G.	945,000	Kualifikuar
6	O. M. M.	969,000	Kualifikuar
7	S. XH.	969,990	Kualifikuar
8	F.	970,000	Kualifikuar
9	K. SHPK	989,000	Kualifikuar
10	O. G. SHPK	989,500	Kualifikuar

Burimi, Bashkia Tropojë dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Operatorë ekonomikë të skualifikuar: Nuk ka operatorë të skualifikuar për këtë procedurë.

Operatorë ekonomikë të kualifikuar:

- Më datë 30.03.2023 nga KPVV është mbajtur renditja e OE në sistem ku ka rezultuar se, OE “S. R. ”, me vlerë totale 768,000 lekë (pa TVSH), është renditur i pari.

Procesverbal datë 30.03.2023 i KPVV ku konstatohet se, sipas renditjes OE “S. R. ” rezulton i renditur i pari me ofertë ekonomike 768,000 lekë pa TVSH për procedurën me objekt: “Rikonstruksion i sinjalistikës horizontale të qytetit faza-1”.

Procesverbal i KPVV datë 31.03.2023 ku njoftohet se OE “S. R. ” i renditur i pari është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Procesverbal i KPVV datë 03.04.2023 ku njoftohet se OE “E. Z.” i renditur i dyti është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Procesverbal i KPVV datë 04.04.2023 ku njoftohet se OE “3E C.” i renditur i treti është tërhequr nga procedura dhe kalohet tek operatori ekonomik i radhës.

-Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël datë 05.04.2023 nëpërmjet sistemit SPE me Njoftim Fituesi ka shpallur fitues operatorin ekonomik renditur në vend të shtatë “S. & R. S. S.” SHPK me ofertë në vlerën 932,800 lekë pa TVSH, për procedurën me objekt: “Rikonstruksion i sinjalistikës horizontale të qytetit faza-1”.

Zbatimi: -Për procedurën e mësipërme është lidhur kontratë furnizimi me objekt: “Rikonstruksion i sinjalistikës horizontale të qytetit faza-1”. me nr. 1782/2 prot. datë 12.04.2023, midis AK Bashkisë Tropojë, përfaqësuar nga Kryetari z. R. B. dhe OE “S. & R. S. S.” SHPK me Nipt: L.....U përfaqësuar nga administratori z. H. Sh. Vlera e kontratës është 932,800 lekë pa TVSH, me afat realizimi 30 ditë nga data e nënshkrimit.

-Urdhër nr.148/1 i Drejtuesit të Institucionit, 1782/3 prot., datë 12.05.2023, Për caktimin e komisionit të marrjes në dorëzim të objektit, “Rikonstruksion i sinjalistikës horizontale të qytetit faza-1” Bashkia Tropojë. Bazuar në ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen

vendore”, Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. Ky komision përbëhet nga: z. M. V. Kryetar, znj. A. H. Anëtar, z. B. S. Anëtar.

-Situacioni përfundimtar datë 12.05.2023 i objektit “Rikonstruksion i sinjalistikës horizontale të qytetit faza-1” Bashkia Tropojë, është nënshkruar nga: Kryetari i Bashkisë z. R. B. dhe Administratori i OE “S. & R. S. S.” z. H. Sh.

-Akt i Marrjes në Dorëzim datë 12.05.2023 për procedurën me objekt “Rikonstruksion i sinjalistikës horizontale të qytetit faza-1” Bashkia Tropojë, ku citohet se përfaqësuesit e Bashkisë Tropojë pasi kontrolluan punimet dhe shërbimet e kryera në këtë objekt i gjetën ato të rregullta dhe në gjëndje të mirë e cilësore, sipas kërkesave paraprahe dhe termave të referencës, si dhe “Kontrollit, disiplinimit të punimeve të ndërtimit”. Për këto arsye punimet merren përfundimisht në dorëzim. Ky dokument është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim z. M. V. Kryetar, znj. A. H. Anëtar, z. B. S. Anëtar si dhe Administratori i OE “S. & R. S. S.” z. H. Sh.

-Nga sa më sipër rezulton se, punimet janë kryer sipas grafikut 4 javë, përcaktuar në DST.

-Urdhër shpenzimi Nr.201, datë 08.06.2023 referuar faturës Nr.41 datë 12.05.2023 me vlerë 1,119,360 lekë me TVSH. Është bërë likuidimi 100% i vlerës së faturës Nr.41 datë 12.05.2023 në vlerën 1,119,360 lekë me TVSH.

Konkluzion: Nga Komisioni për Blerjet e Vogla nuk është mbajtur një procesverbal ku të argumentohet teknikisht dhe ligjërish vendosja e specifikimeve teknike në kundërshtim me Neni 78, pika 2 i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Nga evidencat e marra nga auditimi rezulton se, Ing.E. M. dhe Tek.M. V. nuk janë të pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, sipas të cilit “Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”.

-Procedura me objekt: “Rikonstruksion i sinjalistikës horizontale të qytetit faza-1” Bashkia Tropojë, klasifikohet në kategorinë punë. AK Bashkia Tropojë nuk ka parashikuar procedurë mbikqyrje për këtë punë, veprime në kundërshtim me Neni 7 i Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

- 1) Z. R. B. Kryetar Bashkia Tropojë
- 2) Znj. Z. I. Nënkyetare Bashkia Tropojë
- 3) Z. H. I. ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
- 2) Znj. A. H. me detyrë Kryetare e komisionit për blerjet e vogla
- 3) Znj. E. D. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla
- 4) Znj. F. M. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla

- Mbi copëtimin e fondit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023

Nga auditimi i të dhënave për procedurat e prokurimit, përkatësisht për periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2023 rezultoi se, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Tropojë, janë kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, konkretisht:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2023 deri 31.12.2023		
Objekti i procedurës së prokurimit.	Lloji i procedurës sipas SPE.	Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.
1-Blerje çimento për urën Kuçan	“blerje me vlerë të vogël”	891,000
2-Blereje çimento për urën rruga Sylbicë	“blerje me vlerë të vogël”	1,000,000

TOTALI	2 procedura	1,891,000
---------------	--------------------	------------------

Konkluzion: Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit. Konkretisht, duke u nisur nga ngjashmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “E hapur e thjeshtuar”.

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila konkretisht në nenin 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”, pika 2, përcakton se: “Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasisht dhe llojet e kontratave që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 “Për blerjet e vogla”, pika 3 ku citohet, “Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore ose entet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë përgjegjësi:

- 1) Znj. A. H. me detyrë Kryetare e komisionit për blerjet e vogla
- 2) Znj. E. D. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla
- 3) Znj. F. M. me detyrë anëtare e komisionit për blerjet e vogla

Mbi Procedurat e prokurimit për blerje me vlerë të vogël për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024

Për vitin 2024, nga dokumentacioni dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua si më poshtë vijon:

Nga Bashkia Tropojë, referuar kërkesave dhe nevojave të sektorëve apo drejtorive të të saj, për vitin 2024 ka realizuar 31 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël, me fond limit në shumën 11, 646,301 lekë pa tvsh, dhe me me vlerë kontrate në shumën 10,071,607 lekë pa tvsh, ose 86.5% nga fondi limit.

Prokurimet në vlerë të vogël, janë paraqitur në Regjistrin e Parashikimeve dhe të Realizimit të prokurimeve publike, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 285, datë 19.5.2021, neni 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”.

Me Urdhërin nr.42 prot, datë 25.01.2024, nga titullari i AK z. A.K, është krijuar komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje znj. A.H. kryetare dhe anëtarët znj. E.D. dhe znj. F.M, i cili është ndryshuar me nr.204 datë 27.05.2024 ku është larguar E.D. dhe është shtuar A.M. dhe së fundmi i ndryshuar me urdhrin nr.376 datë 20.11.2024 me përbërje znj. A.H. kryetare dhe anëtarët znj. A.M. dhe znj. S.M, komisioni i cili ka funksionuar deri në fund të vitit.

Ngritja e komisionit, është në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, neni 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” si dhe Udhëzimi nr. 5/2021, pika 2.

Mbi vlerësimin e operatorëve ekonomikë dhe shpalljen e fituesit:

Për të vlerësuar zbatimin e rregullave të prokurimit me vlerë të vogël, u audituan me zgjedhje 5 procedura blerje me vlerë të vogël me fond limit 4,351,405 lekë, dhe me vlerë kontrate 3,972,090 lekë, sa më poshtë vijonë:

“Blerjet me vlerë të vogël të realizuara nga BK dhe të audituara nga KLSH”;

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Urdhër prokurimi Nr.Prot/datë	Data/procesverbalit të OE fitues
1	Blerje veshje tradicionale.	416,667	397,890	T.	nr.223, datë.18.06.2024	17.07.2024
2	Blerje dyer dhe dritare.	999,999	890,000	H. B.	nr.3536 datë 29.08.2024	06.09.2024
3	Blerje ushqime.	1,000,000	944,000	M. – M.	nr.44 datë 30.01.2024	31.01.2024
4	Furnizim dhe vendosje paisje elektrike.	999,999	879,000	H. B.	nr.276 datë 29.08.2024	06.09.2024
5	Furnizim dhe vendosje të mallrave për objektin e Muzeut Historik.	934,740	861,200	O. H.	nr.307 datë 17.09.2024	23.09.2024
6	Total	4,351,405	3,972,090			

Burimi: Të dhëna të Bashkisë Tropojë, përpunuar nga KLSH.

1. Blerje veshje tradicionale;

Për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje veshje tradicionale*”, nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se është parashikuar dhe realizuar bazuar në kërkesën e datës 08.04.2024 nga Qendra Kulturore Dardania. Me urdhërin nr.223 datë 18.06.2024, titullari kërkon të përdoret procedura e prokurimit me vlerë të vogël për veshjet tradicionale.

Komisioni me anë të procesverbalit të datës 18.06.2024 ka përllogaritur fondin limit në vlerën 416,667 lekë, jo në përputhje me nenin 76 “*Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit*”, pika 1 dhe 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, si dhe pika 2, gërma ç), neni 2 “*Dokumentimi procesit*”.

- AK ka hartuar Formularin nr.3 “*Ftesë për ofertë*”, ku janë përcaktuar kriteret për kualifikim, por nuk janë argumentuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.5/2021, pika 11 “*Ftesa për ofertë së bashku me procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve...*” si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 pika 2, gërma c), neni 2 “*Dokumentimi procesit*”.

Për këtë procedurë kanë marrë pjesë 14 operator ekonomik nga të cilët janë skualifikuar/refuzuar 2 dhe kualifikuar 12.

Më datë 17.07.2024, është përcaktuar si fitues operatori “*T.*” shpk, me vlerë të ofertuar 397,890 lekë pa tvsh i renditur i shtati (operatorët e tjerë nuk janë paraqitur ose janë tërhequr).

- Nga verifikimi i dosjes së prokurimit konstatohet se operatori i plotëson të gjitha dokumentet e përcaktuara në kriteret e kualifikimit të Ftesës për Ofertë.

Më datë 18.07.2024, operatori ka nënshkruar edhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe marrjen përsipër të lëvrimit të mallit brenda afateve të përcaktuara. Nga dokumentacioni rezulton se lëvrimi i mallit është kryer më datë 26.07.2024, pra në kundërshtim me Ftesën për Ofertë ku afati ishte përcaktuar brenda 3 ditëve nga konfirmimi i operatorit.

Gjithashtu, nga dokumentacioni konstatohet se nga ana e komisionit nuk është zbatuar në të gjitha rastet afati 24 orë, për kalimin nga një operator në tjetrin, jo në përputhje me Udhëzimin nr.5/2021, pika 16.

Së fundmi, OE ka lëshuar faturën nr.6 datë 26.07.2024 sipas përcaktimeve ligjore dhe është kryer pagesa nga AK nëpërmjet USH nr.302 datë 21.10.2024.

2. Blerje dyer dhe dritare;

Për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje dyer dhe dritare*”, nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se është parashikuar dhe realizuar bazuar në kërkesën e datës 28.08.2024 nga DPZHT, e cila ka përllogaritur edhe fondin limit pa e argumentuar dhe dokumentuar se si është përllogaritur, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr.5/2021, pika 7. Me urdhërin nr.3536 datë 29.08.2024, titullari kërkon të përdoret procedura e prokurimit me vlerë të vogël për punime dyer/dritare.

- AK ka hartuar Formularin nr.3 “*Ftesë për ofertë*”, ku janë përcaktuar kriteret për kualifikim, por nuk janë argumentuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.5/2021, pika 11 “*Ftesa për ofertë së bashku me procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve...*” si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 pika 2, gërma c), neni 2 “*Dokumentimi procesit*”.

Për këtë procedurë kanë marrë pjesë 13 OE dhe janë kualifikuar 13 OE.

Më datë 06.09.2024, është përcaktuar si fitues operatori “H. B.”, me vlerë të ofertuar 890,000 lekë pa tvsh i renditur i pesti (operatorët e tjerë nuk janë paraqitur ose janë tërhequr).

- Nga verifikimi i dosjes së prokurimit konstatohet se operatori **nuk** i plotëson të gjitha dokumentet e përcaktuara në kriteret e kualifikimit të Ftesës për Ofertë pika 3 “Vërtetim që OE nuk është debitor ndaj taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023/2024” dhe pika 5 “Deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike”.

Së fundmi, OE ka lëshuar faturën nr.10 datë 03.12.2024 sipas përcaktimeve ligjore dhe është kryer pagesa nga AK nëpërmjet USH nr.403 datë 31.12.2024.

3. Furnizim vendosje pajisje elektrike dhe hidrosanitare;

Për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizim vendosje pajisje elektrike dhe hidrosanitare”, nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se është parashikuar dhe realizuar bazuar në kërkesën e datës 28.08.2024 nga DPZHT, e cila ka përlllogaritur edhe fondin limit pa e argumentuar dhe dokumentuar se si është përlllogaritur, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr.5/2021, pika 7. Me urdhërin nr.276 datë 29.08.2024, titullari kërkon të përdoret procedura e prokurimit me vlerë të vogël për punime hidrosanitare dhe elektrike.

- AK ka hartuar Formularin nr.3 “Ftesë për ofertë”, ku janë përcaktuar kriteret për kualifikim, por nuk janë argumentuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.5/2021, pika 11 “Ftesa për ofertë së bashku me procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve...”si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 pika 2, gërma c), neni 2 “Dokumentimi procesit”.

Për këtë procedurë kanë marrë pjesë 13 OE dhe janë kualifikuar 13 OE.

Më datë 06.09.2024, është përcaktuar si fitues operatori “H. B.”, me vlerë të ofertuar 879,000 lekë pa tvsh i renditur i treti (operatorët e tjerë nuk janë paraqitur ose janë tërhequr).

- Nga verifikimi i dosjes së prokurimit konstatohet se operatori **nuk** i plotëson të gjitha dokumentet e përcaktuara në kriteret e kualifikimit të Ftesës për Ofertë pika 3 “Vërtetim që OE nuk është debitor ndaj taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023/2024”.

Së fundmi, rezulton se për këtë procedurë nga ana e AK nuk është kryer pagesa, pasi pretendohet se OE nuk ka kryer dhe dokumentuar furnizim vendosjen.

Konkluzion: në lidhje me 2 procedurat e mësipërme, konkretisht “Furnizim vendosje pajisje elektrike dhe hidrosanitare” me fond limit në vlerën 999,999 lekë dhe “Riparim dhe blerje dyer/dritare” me fond limit në vlerën 999,037 lekë, grupi i auditimit konstaton se janë copëzuar me qëllim shmangien e procedurës së hapur të thjeshtuar, pasi shërbimet dhe grupet e mallrave ishin të ngjashëm dhe për të njëjtat institucione mësimore.

Për këtë, AK dhe Komisioni i Blerjeve të Vogla, ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, pika 1 “Autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përlllogaritur është ndërmjet kufijve nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të LPP-së” dhe pika 2 “Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup-mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure” si dhe të Udhëzimit nr.5/2021 pika 3 “Kjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore ose entet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor”.

4. Blerje ushqime për çerdhe dhe kopshte;

Për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje ushqime për çerdhe dhe kopshte*”, nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se është parashikuar dhe realizuar bazuar në kërkesat e drejtorive respektive.

Me urdhërin nr.44 datë 30.01.2024, titullari kërkon të përdoret procedura e prokurimit me vlerë të vogël ushqime për çerdhe dhe kopshte. Komisioni me anë të procesverbalit të datës 31.01.2024 ka përllogaritur fondin limit në vlerën 1,000,000 lekë, jo në përputhje me nenin 76 “*Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit*”, pika 1 dhe 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, si dhe neni 2 “*Dokumentimi procesit*” pika 2, gërma ç.

- AK ka hartuar Formularin nr.3 “*Ftesë për ofertë*”, ku janë përcaktuar kriteret për kualifikim, por nuk janë argumentuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.5/2021, pika 11 “*Ftesa për ofertë së bashku me procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve...*” si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 pika 2, gërma c), neni 2 “*Dokumentimi procesit*”.

Për këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 OE dhe janë kualifikuar 4 OE.

Më datë 31.01.2024, është përcaktuar si fitues operatori “*M.-M.*”, me vlerë të ofertuar 944,000 lekë pa tvsh i renditur i pari.

- Nga verifikimi i dosjes së prokurimit konstatohet se operatori i plotëson të gjitha dokumentet e përcaktuara në kriteret e kualifikimit të Ftesës për Ofertë.

Së fundmi, ndërmjet AK dhe OE janë lidhur kontratat e shërbimit dhe mallrat janë marrë në dorëzim, brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

5. Blerje mallra për objektin e Muzeut Historik;

Për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje mallra për objektin e Muzeut Historik*”, nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se është parashikuar dhe realizuar bazuar në kërkesën e datës 02.08.2024.

Me urdhërin nr.307 datë 17.09.2024, titullari kërkon të përdoret procedura e prokurimit me vlerë të vogël për blerje mallra për objektin e Muzeut Historik. Komisioni me anë të procesverbalit të datës 17.09.2024 ka përllogaritur fondin limit në vlerën 934,740 lekë, jo në përputhje me nenin 76 “*Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit*”, pika 1 dhe 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, si dhe neni 2 “*Dokumentimi procesit*” pika 2, gërma ç.

- AK ka hartuar Formularin nr.3 “*Ftesë për ofertë*”, ku janë përcaktuar kriteret për kualifikim, por nuk janë argumentuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.5/2021, pika 11 “*Ftesa për ofertë së bashku me procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve...*” si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 pika 2, gërma c), neni 2 “*Dokumentimi procesit*”.

Për këtë procedurë kanë marrë pjesë 9 OE dhe janë kualifikuar 9 OE.

Më datë 23.09.2024, është përcaktuar si fitues operatori “*O. H.*”, me vlerë të ofertuar 861,200 lekë pa tvsh i renditur i treti (operatorët e tjerë nuk janë paraqitur).

- Nga verifikimi i dosjes së prokurimit konstatohet se operatori i plotëson të gjitha dokumentet e përcaktuara në kriteret e kualifikimit të Ftesës për Ofertë.

Së fundmi, rezulton se për këtë procedurë nga ana e AK nuk është kryer pagesa e plotë por vetëm vlera prej 486,000 lekë sipas situacionit nr.1 dhe Procesverbalit të marrjes në dorëzim të datës 08.04.2025.

Konstatim: Grupi auditimit, në lidhje me prokurimet me vlerë të vogël, vëren disa mangësi: Në shumicën e prokurimeve me vlerë të vogël nuk nënshkruhet një kontratë për shërbimin e kërkuar/ofruar, në kundërshtim me Ligjin Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, neni 1, pika 2 ku citohet se: “*Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve*” dhe neni 4, pika 14: “*Kontratat publike janë kontratat me shpërbllim, të lidhura me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë*

autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me këtë ligj”.

Në shumë prej procedurave mungonë afati i dorëzimit të mallit apo të kryerjes së shërbimit, pasi në ftesën për ofertë ose specifikimet teknike shkruhet vetëm “lëvrimi sipas nevojës së bashkisë” pa përcaktuar një afat maksimal ose periudhë të kontratës. Në cilësimin tonë kemi të bëjmë me “Hartim jo të plotë të dokumenteve të prokurimit” ose “mungesë e qartësisë në kushtet e kontratës”, gjë që bie ndesh me parimet e transparencës dhe barazisë së trajtimit të operatorëve ekonomikë (neni 3 të ligjit 162/2020).

2.3. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM, për periudhën 01.01.2024 -31.12.2024

2.3.1. -Mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

Administrimi i Aseteve në Bashkinë Tropojë kryhet nga Sektori i Pronave dhe Hartografisë si dhe nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Këto asete janë marë në administrim nëpërmjet VKM përkatëse.

-VKM nr.397, datë 01.06.2011 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Bashkia Tropojë, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 173 (njëqind e shtatëdhjetë e tre) dhe përbëhet nga 37 fletë.

-VKM nr.649, datë 21.05.2008 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Bujan, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 132 (njëqind e tridhjetë e dy) dhe përbëhet nga 3 fletë.

-VKM nr.378, datë 08.04.2009 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Bujan, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 200 (dyqind) dhe përbëhet nga 40 fletë.

-VKM nr.521, datë 23.04.2008 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Bytyç, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 214 (dyqind e katërmëdhjetë) dhe përbëhet nga 7 fletë.

-VKM nr.1209, datë 11.12.2009 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Bytyç, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 863 (tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) dhe përbëhet nga 115 fletë.

-VKM nr.322, datë 19.03.2006 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Margegaj, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 623 (gjashtëqind e njëzetë e tre) prona në inventar me 51 fletë.

-VKM nr.327, datë 19.03.2006 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Margegaj, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 113 (njëqind e tremëdhjetë) prona në inventar me 4 fletë.

-VKM nr.610, datë 14.05.2008 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Llugaj, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 86 (tetëdhjetë e gjashtë) dhe përbëhet nga 3 fletë.

-VKM nr.7, datë 07.01.2009 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Tropojë Fshat, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 370 (treqind e shtatëdhjetë) dhe përbëhet nga 56 fletë.

-VKM nr.473, datë 16.04.2008 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Tropojë Fshat, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 238 (dyqind e tridhjetë e tetë) dhe përbëhet nga 7 fletë.

-VKM nr.555, datë 05.05.2008 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Lekbibaj, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë) dhe përbëhet nga 7 fletë.

-VKM nr.928, datë 02.07.2008 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Lekbibaj, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 842 (tetëqind e dyzetë e dy) dhe përbëhet nga 115 fletë.

-VKM nr.430, datë 15.05.2013 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësia Administrative Fierzë, Qarku Kukës. Lista e inventarit fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me numër 636 (gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) dhe përbëhet nga 97 fletë.

Referuar VKM-ve të paraqitura më lartë rezulton se janë gjithsej **4726** prona të cilat i kanë kaluar në përdorim Bashkisë Bajram Curri. Këto prona përbëhen kryesisht nga; truall, godina, lulishte, terrene sportive, trotuare, rrugë, varreza, kanalizime, ranishte, pyje, etj.

Tabela Nr.1: Numri i pronave të Bashkisë Tropojë dhe Njësive Administrative sipas VKM-ve përkatëse

Nr.	Njësiti Administrative	Numri i Pronave	VKM – Datë
1	NJA.- Bujan	132	Nr.649 datë 21.05.2009
	NJA.- Bujan	200	Nr.379 datë 08.04.2009
2	NJA.- Bytyç	214	Nr.521 datë 23.04.2008
	NJA.- Bytyç	863	Nr.1209 datë 11.12.2009
3	NJA.- Margegaj	623	Nr.322 datë 19.03.2006
	NJA.- Margegaj	113	Nr.327 datë 19.03.2006
4	NJA.- Lugaj	86	Nr.610 datë 14.05.2008
5	NJA.- Tropojë Fshat	370	Nr.7 datë 09.01.2009
	NJA.- Tropojë Fshat	238	Nr.473 datë 16.04.2009
6	NJA.- Lekbibaj	236	Nr.555 datë 05.05.2008
	NJA.- Lekbibaj	842	Nr.928 datë 15.05.2008
7	NJA.- Fierzë	636	Nr.430 datë 15.05.2013
8	Bashkia Tropojë	173	Nr.397 datë 01.06.2011
	Totali	4,726	

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Për sa më sipër rezulton se, nuk ka regjistër me të dhënat dhe modalitetet për secilën pronë të paluajtshme shtetërore. Për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë. Gjatë vitit 2024, nga titullari i Bashkia Tropojë nuk janë ngritur grupe pune për administrimin dhe monitorimin e aseteve. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Tropojë dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë kontabilizuar në bilancin përkatës të bashkisë. Përgjatë vitit 2024, Sektori i Pronave dhe Hartografisë si dhe Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Tropojë nuk kanë certifikuar asnjë pronë, si dhe nuk kanë aplikuar në DVASHK Kukës për regjistrim të aseteve të bashkisë.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” neni 17 “Afatet dhe procedurat e transferimit”, neni 18 “Dokumentacioni i transferimit”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e

qeverisjes vendore”, pikën 18, 22, Ligji nr.20 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike”. Për veprimet dhe mosveprimet më sipër ngarkohen me përgjegjësi Zv.Kryetar i Bashkisë znj. Z. I, Dejtore i Drejtorisë së Planifikimit dhe zhvillimit të territorit z. H. I, Përgjegjës Sektorit të Pronave dhe Hartografisë z. M. K, specialiste e pronave dhe hartografisë znj. M, Gj.

- Referuar VKM-së nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkive”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Kullotave dhe Buqësisë, Bashkia Tropojë ka në pronësi sipërfaqe pyjore si më poshtë:

Gjithsej **49,770.91** ha, nga ku:

- Pyje 33,502.69 ha,
- Kullotë 12,541.8 ha
- Toka joproductive 3,726.42 ha

- Mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura Bashkia Tropojë për krijimin e të ardhurave ka lidhur kontrata për dhënie me qira të aseteve në pronësi apo në përdorim të bashkisë.

Gjatë vitit 2024 Bashkia Tropojë ka pasur në administrim 4 kontrata për qiradhënie të aseteve. Këto kontrata janë me afat 1 vjeçar me objekt “Shfrytëzim të hapësirave dhe ambienteve publike” të lidhuara nga viti 2015 e në vazhdim, me të drejtë rinovimi çdo vit. Nga verifikimi i pagesave të tarifave të qirasë rezulton se, nuk ka detyrime të pashlyera.

Bashkia Tropojë ka në administrim Hotelin e Ish-punëtorëve, ambjentet e të cilit përdoren si banesa sociale për familjet e pastreha. Për këto ambiente gjatë vitit 2024 janë lidhur 15 kontrata qiraje me afat 1-vjeçar me të drejtë rinovimi.

Tabela Nr.2: Debitorët e banesave sociale

Nr.	Emër Mbiemër	Detyrimi në lekë Viti 2024	Pagesa në lekë Viti 2024	Shuma e debisë në lekë deri më 31.12. 2024
1	F. G.	11,520	11,520	0
2	A. H.	11,520	11,520	0
3	E. R.	13,200	13,200	0
4	H. H.	13,680	13,680	0
5	E. T.	13,200	13,200	0
6	A. A.	12,600	12,600	0
7	A. B.	10,800	10,800	0
8	A. M.	13,680	13,680	0
9	K. P.	11,700	11,700	0
10	A. R.	11,700	0	19,320
11	Z. R.	11,520	0	23,040
12	F. D.	13,680	13,680	0
13	Sh. P.	11,700	11,700	0
14	M. U.	10,800	0	16,200
15	L. M.	13,200	13,200	0
	Totali	184,500	150,480	81,600

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arkëtimet për këto 15 kontrata qiraje rezulton se, në fund të vitit 2024 janë debitorë 3 familje në vlerën 81,600 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-Kontratat e lidhura me subjektet juridike/fizike për përdorim të fondit pyjor/kullosor

Në territorin e Bashkisë Tropojë ushtrojnë aktivitet 7 Shoqëri Koncesionare të prodhimit të energjisë elektrike, energjisë së erës të cilat kanë lidhur kontratë qiraje për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor. Nga auditimi i kontratave të qiradhënies rezultoi se, janë 9 kontrata qiraje që

kjo bashki ka në administrim nga të cilat 2 janë lidhur gjatë vitit 2024, ndërsa 7 të tjerat në vitet e mëparshme.

Lejet e paraqitura në tabelën përmbledhëse si më poshtë:

Tabela Nr.3: Lista e HEC-ve dhe aktivitetit për park Eolik në territorin e Bashkisë Tropojë

Nr	Subjekti	Lidhja e Kontratës (Nr. Datë)	Aktiviteti	Sipërfaqja në përdorim HA	Sipërfaqja në përdorim KM	Kohëzgjatja	Vlera e kontratës lekë/vit	Pagesat e kryera 2024 lekë	Detyrimi deri më 31.12.2024 lekë
1	"A.T.A. E. E." SHPK	2365/7, datë 24.08.2017	Shtri rje Tubacioni për ndërtim HEC "Fierzë"	1.3656	0.828	9 vite 23.08.2026	473,495	372,331	2,367,435
2	"B. - R.O.S.P." SHPK	2693/5, datë 18.07.2018	Shtri rje Tubacioni për ndërtim HEC Tropojë	0.59	-	10 vite 17.07.2028	294,925	89,690	Zgjidhur kontrata me Urdhër nr.4148/6 ptot., dt. 05. 11. 2024, me kërkesë të tyre. Kanë deklaruar se puna ka mbaruar. Vlera e paguar është llogaritur deri në datën e mbylljes së kontratës 18.07.2024-05.11.2024
3	"Sh.-Al" SHPK	3359/5, datë 06.12.2018	Shtri rje Tubacioni për ndërtim HEC Bujan	0.29	-	9 vite 05.12.2028	151,730	-	606,520
4	"HEC V. 1 & 2", SHPK	2705/5, datë 24.07.2019	Shtri rje Tubacioni për ndërtim HEC Bujan	0.036	-	10 vite 23.07.2029	965,900	-	6,305,112
5	"B. - R.O.S.P." shpk(HEC-2ER)	2204/5, datë 07.04.2021	Shtri rje tubacioni per ndertim HEC-2ER.	0.32	-	5 vite 01.04.2026	149,600	129,600	-
6	"A." SHPK	573/6, datë 12.05.2023	Vendosje, instalimin e shtyllave matëse për matjen e intensitetit të erës dhe anometri për qëllime studimi. Tropojë, Bytyç Llugaj	8.24	-	3 vite 11.05.2026	839,177	839,177	-
7	"EU G. E." SHPK	820/9, datë 18.04.2024	Zhvillimi i aktivitetit, Park Eolik	7.75	-	10 vite 17.04.2034	1,396,300	1,396,300	-
8	"E. IN. 2" SHPK	4807/2, datë 31.10.2023	Vendosje, instalimin e shtyllave matëse për matjen e intensitetit të erës dhe anometri për qëllime studimi. Tropojë, Bytyç Llugaj	31.06	-	3 vite 30.10.2026	6,136,800	6,136,800	-
9	"E. IN. 2" SHPK	1086/9, datë 18.04.2024	Zhvillimi i aktivitetit, Park Eolik	39.02	-	10 vite 30.04.2034	7,014,996	7,014,996	-

	Totali							15,978,894	9,279,067
--	---------------	--	--	--	--	--	--	-------------------	------------------

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Nga shoqëritë koncesionare që kanë lidhur kontratë qiraje për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë rezulton se, 7 kanë paguar detyrimet sipas kontratave dhe 3 nuk ka shlyer detyrimet kontraktuale. Subjektet me detyrime janë si më poshtë:

-“A.T.A. E. E.” SHPK me Nipt: L.....E ka lidhur kontratë qiraje me Bashkinë Tropojë për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor me nr. 2365/7, datë 24.08.2017 “Shtrirje Tubacioni për ndërtim HEC “Fierzë”. Për vitin 2024 kjo Shoqëri Koncesionare nuk ka shlyer detyrimet kontraktore të akumuluar në vlerën **2,367,435 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-“Sh.-Al” SHPK me Nipt: K.....N ka lidhur kontratë qiraje me Bashkinë Tropojë për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor me nr. 3359/5, datë 06.12.2018 “Shtrirje Tubacioni për ndërtim HEC Bujan”. Për vitin 2024 kjo Shoqëri Koncesionare nuk ka shlyer detyrimet kontraktore të akumuluar në vlerën **606,520 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-“HEC V. 1 & 2” SHPK me Nipt: L.....T ka lidhur kontratë qiraje me Bashkinë Tropojë për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor me nr. 2705/5, datë 24.07.2019 “Shtrirje Tubacioni për ndërtim HEC Bujan”. Për vitin 2024 kjo Shoqëri Koncesionare nuk ka shlyer detyrimet kontraktore të akumuluar në vlerën **6,305,112 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-Për auditimin e kontratave të qirasë lidhur gjatë vitit 2024 ndërmjet Bashkisë Tropojë dhe subjekteve juridik/fizik, jemi referuar kuadrit ligjor më poshtë:

-Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”;

-Ligji nr.57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020;

-VKM nr.54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;

-VKB për miratimin paraprak të heqjes së fondit pyjor/kullosor nga ekonomia pyjore/kullosore;

-Udhëzimi nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

-Për auditimin e kontratave të qirasë lidhur gjatë vitit 2024 ndërmjet Bashkisë Tropojë dhe subjekteve juridik/fizik, saktësinë e tarifave të aplikuara dhe arkëtimin e tyre, të cilat e shtrijnë efektin e tyre deri më datë 31.12.2024, u shqyrtua si vijon:

1. Bashkimi i shoqërive “EU G. E. & W.” SHPK me NIPT L.....L dhe L.....T, përfaqësuar nga administratori z. A. U. i emëruar si përfaqësues i të dy shoqërive, ka lidhur kontratë qiraje me Bashkinë Tropojë përfaqësuar nga kryetari z. R. B. me Nr.820/9 prot., datë 18.04.2024, me objekt “Marje me qira nga fondi pyjor” sipërfaqen prej 7.75 ha. Kjo sipërfaqe është pjesë e ekonomisë pyjore Lugina T’Plan, miratuar me VKB Nr.37 datë 28.03.2024 ku përfshihen ngastrat 116/b, 140/a, 142/a, 143/a, 114/c, 113/c, 114/e, 112/b, 146/b, 109/a, etj., tokë me bimësi pyjore dhe kullotë. Qëllimi i përdorimit është “Për ushtrimin e veprimtarisë në lidhje me zhvillimin e parkut Eolik “ECO-ENERGY” 100 MW Dushaj-T’Plan në zonën e Bashkisë Tropojë. Afati i kontratës është për 10 vite, vlera e qirasë vjetore është 1,396,300 lekë. Procedura është kryer referuar Udhëzimi nr.1 i MTM, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

Nga auditimi i kësaj kontrate konstatohet se:

Referuar DPK Bashkia Tropojë, tarifa e përcaktuar është 1,396,300 lekë/vit. Për përcaktimin e kësaj tarife DPK është bazuar në VKM nr 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, i ndryshuar, shtojca nr. 1 “Tarifat për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e ushtruara në këtë fond”, pika 8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj.).

Referuar më lart është bërë llogaritja e vlerës sipas tipit të bimësisë:

- ❖ Trungishte 0.95 ha x 210,000 lekë/ha = 199,500 lekë
- ❖ Cungishte 5 ha x 176,000 lekë/ha = 880,000 lekë
- ❖ Kullotë 1.8 ha x 176,000 lekë/ha = 316,800 lekë

Nga verifikimi i ngastrave të ekonomisë pyjore Dushaj-T’Plan dhe vlerave të përcaktuara në VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, i ndryshuar, shtojca nr.1, pika 8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj.), për kohëzgjatje 10 vjet, nuk konstatohen diferenca në përlllogaritjen e vlerës së qirasë vjetore.

Nga verifikimi rezulton se, subjekti ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas, Udhëzimi nr.1 i MTM, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Konkluzion: Nga Bashkia Tropojë nuk është ngritur njësi e monitorimit të kontratave të qirasë, e cila pas lidhjes së kontratës bën dorëzimin te qiramarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Gjithashtu konstatohet se, nuk është mbajtur procesverbal për dorëzimin e ngastrave subjektit qiramarrës. Veprime dhe mos veprime në kundërshtim me, Kreu VI. “Monitorimi i kontratave” i VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.1 i MTM, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 18.

2. Subjekti “E. IN. 2” SHPK me NIPT M.....B përfaqësuar nga z. P. K. ka lidhur kontratë qiraje me Bashkinë Tropojë përfaqësuar nga kryetari z. R. B. Nr.4807/2 prot., datë 31.10.2023 me objekt, “Marje me qira nga fondi pyjor” sipërfaqe prej 31.06 ha. Kjo sipërfaqe është pjesë e ekonomisë pyjore “Lugina Tropojës” ngastrat 225/a, 243/b, 225/b, 204/a, etj., “Lugina T’Planit” ngastrat 202/a, 192/c, 7/b, 199/a, 200/e, 188/a, 56/a, 19/b, 3/b, etj., “Berishë-Bytyç” ngastrat 164/a, 197/b, 225/a, 271/c, 153/c, etj., mraturar me VKB Nr.120 datë 22.12.2022. Qëllimi i përdorimit është “Për instalimin e shtyllave matëse për matjen e intensitetit të erës dhe anometri për qëllime studimi”, në zonën e Bashkisë Tropojë. Afati i kontratës është për 3 vite, vlera e qirasë vjetore është 6,136,800 lekë. Procedura është kryer referuar Udhëzimi nr.1 i MTM, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Nga auditimi i kësaj kontrate konstatohet se:

Referuar DPK Bashkia Tropojë, tarifa e përcaktuar është 6,136,800 lekë/vit. Për përcaktimin e kësaj tarife DPK është bazuar në VKM nr 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, i ndryshuar, shtojca nr. 1 “Tarifat për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e ushtruara në këtë fond”, pika 8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj.).

Referuar më lart është bërë llogaritja e vlerës sipas tipit të bimësisë:

- ❖ Trungishte 7.6 ha x 230,000 lekë/ha = 1,748,000 lekë
- ❖ Cungishte 11.6 ha x 184,000 lekë/ha = 2,134,400 lekë
- ❖ Kullotë 11.6 ha x 184,000 lekë/ha = 2,134,400 lekë
- ❖ Inproduktive 0.8 ha x 150,000 lekë/ha = 120,000 lekë

Nga verifikimi i ngastrave të ekonomisë pyjore “Lugina Tropojës”, “Lugina T’Planit”, “Berishë-Bytyç” dhe vlerave të përcaktuara në VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, i ndryshuar, shtojca nr.1, pika 8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj.), për kohëzgjatje 3 vjet, nuk konstatohen diferenca në përllogaritjen e vlerës së qirasë vjetore.

Nga verifikimi rezulton se, subjekti ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas, Udhëzimi nr.1 i MTM, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Nga informacioni i marë nga Sektori Juridik Bashkia Tropojë, kjo kontratë është zgjidhur me datë 31.04.2024 me dakordësinë e të dy palëve pasi ka mbaruar faza e studimit.

3. Subjekti “E. IN. 2” SHPK me NIPT M.....B përfaqësuar nga z. P. K. ka lidhur kontratë qiraje me Bashkinë Tropojë përfaqësuar nga kryetari z. R. B. Nr.1086/9 prot., datë 18.04.2024 me objekt, “Marrje me qira nga fondi pyjor” sipërfaqe prej 39.02 ha. Sipërfaqe e cila është pjesë e ekonomisë pyjore “Lugina Tropojës” ngastrat 225/a, 243/b, 225/b, 204/a, etj., “Lugina T’Planit” ngastrat 202/a, 192/c, 7/b, 199/a, 200/e, 188/a, 56/a, 19/b, 3/b, etj., “Berishë-Bytyç” ngastrat 164/a, 197/b, 225/a, 271/c, 153/c, etj., mratuar me VKB Nr.36 datë 28.03.2024. Qëllimi i përdorimit është ndërtimi i “Viçidol Wind Farm”, në territorin e Bashkisë Tropojë. Afati i kontratës është për 10 vite, vlera e qirasë vjetore është 7,014,996 lekë. Procedura është kryer referuar Udhëzimi nr.1 i MTM, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Nga auditimi i kësaj kontrate konstatohet se:

Referuar DPK Bashkia Tropojë, tarifa e përcaktuar është 6,136,800 lekë/vit. Për përcaktimin e kësaj tarife DPK është bazuar në VKM nr 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, i ndryshuar, shtojca nr. 1 “Tarifat për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e ushtruara në këtë fond”, pika 8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj.).

Referuar më lart është bërë llogaritja e vlerës sipas tipit të bimësisë:

- ❖ Trungishte 6.806 ha x 210,000 lekë/ha = 1,429,260 lekë
- ❖ Cungishte 6.569 ha x 176,000 lekë/ha = 1,156,144 lekë
- ❖ Kullotë 20.19 ha x 176,000 lekë/ha = 3,553,440 lekë
- ❖ Inproduktive 3.228 ha x 150,000 lekë/ha = 484,200 lekë
- ❖ Shkurre 2.227 ha x 176,000 lekë/ha = 391,952 lekë

Nga verifikimi i ngastrave të ekonomisë pyjore “Lugina Tropojës”, “Lugina T’Planit”, “Berishë-Bytyç” dhe vlerave të përcaktuara në VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, i ndryshuar, shtojca nr.1, pika 8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj.), për kohëzgjatje 10 vjet, nuk konstatohen diferenca në përllogaritjen e vlerës së qirasë vjetore.

Nga verifikimi rezulton se, subjekti ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas, Udhëzimi nr.1 i MTM, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Konkluzion: Nga Bashkia Tropojë nuk është ngritur njësisë e monitorimit të kontratave të qirasë, e cila pas lidhjes së kontratës bën dorëzimin të qiramarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Gjithashtu konstatohet se, nuk është mbajtur procesverbal për dorëzimin e ngastrave subjektit qiramarrës. Veprime dhe mos veprime në kundërshtim me, Kreu VI. “Monitorimi i kontratave” i VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.1 i MTM, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 18.

Referuar informacionit të marrë nga Drejtoria Juridike, gjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Tropojë kanë ushtruar aktivitetet minerar 11 subjekte, të cilat kanë kontrata ekzistuese qiraje me bashkinë për të shfrytëzuar sipërfaqe të fondit pyjor/kullor.

Tabela më poshtë jep më shumë informacion për aktivitetin dhe detyrimet e këtyre subjekteve:

Tabela Nr.4: Pasqyra e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet minerar Bashkia Tropojë dhe detyrimet për 2024

Nr.	Subjekti	Lidhur Kontrata	Data e përfundimit	Sipërfaqe Ha	Arkëtuar për 2024 (Lekë)	Detyrime për 2024 + kamat vonesa (Lekë)
1	“S. A” SHPK	28.07.2018	28.03.2025	0.25 ha, 0.2 km	0	340,000
2	“L.” SHPK	11.04.2017	10.04.2026	0.15 ha, 2 km	0	1,266,000
3	“M.” SHPK	19.04.2018	28.03.2025	0.2 ha, 0.2 km	0	575,000
4	“BL-A.” SHPK	16.05.2017	15.05.2026	0.1 ha	68,000	0
5	“M.” SHPK	12.07.2017	11.07.2026	0.08 ha, 0.08 km	0	356,000
6	“A.” SHPK	21.08.2017	27.09.2024	0.12 ha	12,592	0
7	“A. G” SHPK	30.11.2016	29.12.2025	0.075 ha	83,000	0
8	“S.&Xh.” SHPK	09.05.2017	08.05.2026	1.2 km	52,900	0
9	“M.” SHPK	18.09.2018	17.09.2027	0.08 ha, 0.3 km	55,700	0
10	“A.-L.” SHPK	01.11.2018	31.10.2027	0.24 ha	121,350	0
11	“V. M. A”	18.01.2019	17.01.2028	0.2 ha, 0.3 km	0	591,000
	Total				393,542	3,128,000

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Mbështetur në tabelën më sipër, detyrimet financiare që subjektet minerare kanë kundrejt bashkisë deri më 31.12.2024 arrijnë vlerën **3,128,000 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-Sipas informacionit të marrë nga Sektori i Pronave, Bashkia Tropojë ka lidhur 8 kontrata qiradhënie me shoqëritë e telefonisë celulare dhe internetit të cilat shfrytëzojnë fondin pyjor/kullor. Për periudhën 01.01.2024 deri 31.12.2024 këto kompani kanë kryer pagesat si më poshtë:

Tabela Nr.5: Lista e operatorëve të telefonisë celulare dhe internetit në Bashkinë Tropojë, detyrimet 2024

Nr	Subjekti	Lidhur Kontrata	Data përfundimit	Sipërfaqe Ha	Arkëtuar për vitin 2024 (Lekë)	Detyrime për vitin 2024 (Lekë)
1	“T. A”, Margegaj	20.12.2016	19.12.2025	0.03 Ha	150,000	0
2	“T. A”, Bytyç	20.11.2016	19.11.2025	0.02 Ha 0.4 Km rrugë	190,000	0
3	“V. A”, Margegaj	15.11.2019	14.11.2024	0.003 Ha	300,000	255,000
4	“V. A, Lekbibaj	31.05.2019	30.05.2024	0.05 Ha	300,000	0
5	“IH-N.”, Bytyç	21.06.2017	20.06.2026	0.0042 Ha 0.7 Km rrugë	58,100	0
6	“T. A”, Lekbibaj	18.10.2019	17.10.2028	0.0025 Ha	25,000	0
7	“O. A”, Lekbibaj	15.04.2023	14.04.2028	0.007 Ha	59,520	0
8	“V. A”, B. Curri	02.10.2023	01.10.2028	0.002 Ha	500,000	0
	TOTALI			0.1187 Ha 1.1 Km rrugë	1,582,620	255,000

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Nga sa më sipër rezulton se, nga operatorët e telefonisë celulare dhe internetit nuk janë shlyer detyrimet kontraktuale në vlerën **255,000 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Për sa më sipër janë paraqitur observacionet: për Projektraportin e Auditimit nga Bashkia Tropojë me nr. 3219/36, datë 02.02.2026 ardhur në KLSH me nr. 467/7, datë 05.02.2026 nga F. M, E. M, për sa më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Spektori i Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Tropojë në kuadër të projektit të regjistrimit fillestar të pasurive të tipit pyje dhe kullota, të azhornimit të listës së inventarit të fondit pyjor kullor për ndryshimin në VKM nr.433 dhe përmbylljen e procesit të regjistrimit të pyjeve dhe kullotave bashkiake ka përfunduar procedin e regjistrimit të pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Tropojë. Në zbatim të Urdhrit Nr.16, datë 28.01.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe certifikimin e pronave të Bashkisë Tropojë”, Spektori i Pyjeve dhe Kullotave po bashkëpunon me Spektorin e Pronave për certifikimin e aseteve dhe konkretisht po përgatit plan rilevimi për çdo aset që të bëjmë të mundur marrjen e certifikatës së pronësisë nga ASHK Kukës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi u njoh me observacionin e subjektit thekson se, dokumentacioni shtesë i paraqitur nga subjekti i përket vitit 2025 dhe kjo periudhë nuk i përket periudhës auditimit që mbulon vitin 2024. Nga subjekti nuk është paraqitur asnjë certifikim prone i kryer gjatë vitit 2024 dhe jemi vënë në dijeni se gjatë këtij viti nga Bashkia Tropojë nuk është kryer asnjë aplikim apo certifikim në DVASHK Kukës. **Për këtë arsye ky observacion nuk merret në konsideratë.**

Pretendimi i subjektit:

Përsa i përket regjistrimit për pyjet dhe kullotat, Spektori i Pyjeve dhe Kullotave ka regjistruar e pyjeve dhe kullotave bashkiak të pasqyruar në atë që quhet nga ky sektor si kadastrë pyjore ku përfshihen: ekonomitë pyjore dhe kullotore, ngastrat sipas ekonomive, përdorimi i territorit, pyjet, karakteristikat e grumbullit, pyjet, treguesit sipas llojeve, kullotat e menaxhuara, infrastruktura, pronësia administrimi dhe rivlerësime.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi u njoh me pretendimet e subjektit në lidhje me regjistrimin e pyjeve e **merret në konsideratë këtë observacion.**

Pretendimi i subjektit:

Spektori i Pyjeve dhe Kullotave pretendon se nuk ka lidhje me kontratat e qirasë që janë lidhur në Bashkinë Tropojë për Banesa Sociale, HEC dhe të Telefonisë Celulare.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit thekson se, përgjegjësitë gjatë auditimit janë ndarë sipas sektorëve përkatës dhe Spektori i Pyjeve dhe Kullotave nuk është ngarkuar me përgjegjësi për këto kontrata. **Për këtë arsye ky observacion nuk merret në konsideratë.**

2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit me nr. 777/1 prot; datë 20.10.2025, me objekt: “Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, prej datës 01.01.2023 deri më 31.12.2024, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “E-leje”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;

- Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.

Bashkia Tropojëka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor** (këtu e në vazhdim PPV) dhe **Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (këtu e në vazhdim KKT), nr. 2, datë 09.12.2017, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit.

Lejet e ndërtimit, zhvillimit dhe përdorimit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Tropojë, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2023 deri në 31.12.2024**, ka pasur **83 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe çertifikata përdorimi, etj., përkatësisht: 13 aplikime për leje zhvillimi, 4 aplikime për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m², 6 aplikime për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m², 2 leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. më të madhe se 250 m², 2 leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni, 21 aplikime për deklarata paraprake për kryerje punimesh, 5 aplikim për çertifikatë përdorimi, 3 leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, 4 leje për ndryshimin e subjektit zhvillues, 12 aplikime për njoftim fillim punimesh, 6 leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit dhe 6 leje infrastrukture të evidentuara në **Tabelën nr. 1**.

Tabela nr. 1: aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2023-31.12.2024

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	13	8	5
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ²	4	3	1
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	6	3	3
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. deri në 250 m ²	-	-	-
Leje ndërtimi për shtesë në nd. ekzistues me sip. më të madhe se 250 m ²	1	1	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	2	2	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	-	-	-
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	21	14	7
Leje rind., rikonst. dhe ripar. të nd. së dëmtuar pa shtim apo ndrysh. funk.	-	-	-
Çertifikatë përdorimi	5	4	1
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	3	2	1
Leje për ndryshim funksioni	-	-	-
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	4	3	1
Njoftim fillim punimesh	12	9	3
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	6	4	2
Leje infrastrukture	6	6	0

Burimi: Bashkia Tropojë

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (këtu e në vazhdim DPZHT) e Bashkisë Tropojë, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e evidentuara në **Tabelën nr. 2**, bashkëlidhur këtij akt-konstatimi.

Tabela nr. 2 – Rastet e audituara

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratuar	Prevetivi
Leje ndërtimi				
1	Kompleks bujtinë me prespektivë për agroturizëm 2 dhe 1 kate + 1 kat nëntokë	B. P. M.	27.06.2023	48,211,496 lekë

2	Agroturizëm me struktur akomodimi dhe shërbimi 1 dhe 2 kat dhe me aktivitetet rekreativ	A. Ç. K.	27.11.2024	45,074,744 lekë
Certifikata përdorimi				
1	Objekt banimi 2 kt + bodrum	Xh. I.	14.06.2024	4,390,682 lekë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në lidhje me auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se tre raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4, datë 27/06/2023, për objektin “Kompleks bujtinë me prespektivë agroturizëm 2 dhe 1 kat + 1 kat nëntokë”, me adresë në fshatin Plaç, Bashkia Tropojë, me zhvillues B. P. M. me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon studimi gjeologo-inxhinierik dhe studimi sizmiko-inxhinierik. Këto veprime nuk janë në përputhje me VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020 *“Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”*;

- Zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin “Njoftim për fillimin e punimeve”. “Njoftimi për fillimin e punimeve” është dokumenti që jepet pas marrjes së sigurisë së zhvilluesi ka plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe kushtet e nevojshme për të filluar punimet. Gjithashtu, ky dokument shënon datën e saktë të fillimit të punimeve, referuar së cilës llogaritet respektimi ose jo i grafikut të punimeve dhe afatit të përfundimit të punimeve. Duke iu referuar pikës 8 të dokumentit të lejes së ndërtimit, si dhe nenit 40 të ligjit 107/2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, afati për fillimin e punimeve është një vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit.

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë, plani i piketimit të strukturës; plani organizimeve të punimeve dhe plani i mbulimit me kuotat përkatëse në plan dhe kuotat në parapete dhe mbi elementet teknike si dhe ne kullime veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1/1, nënpika i);

- Mungon projekti arkitektonik në formatin DWG, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç);

- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit që ka hartuar projektin e mbrojtjes ndaj zjarrit (znj. M. Sh.), kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, nënpika.e);

- Mungon certifikata e ekspertit zjarrfikës, i cili ka hartuar projektin për mbrojtjen ndaj zjarrit (znj. M. Sh.), veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë, instalimet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe detajet e montimit të sistemit rrufe-pritës veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1/1, nënpika iii).

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1, datë 27/11/2024, për objektin “Agroturizëm me struktur akomodimin dhe shërbim 1 dhe 2 kat dhe me aktivitet rekreativ”, me adresë në fshatin Buçaj, Bashkia Tropojë, me zhvillues A. Ç. K. me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon studimi gjeologo-inxhinierik dhe studimi sizmiko-inxhinierik. Këto veprime nuk janë në përputhje me VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020, *“Për përcaktimin e procedurave dhe*

të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”;

- Mungon projekti arkitektonik në formatin DWG, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç);

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 84 ditësh pune, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore të nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, si dhe nenin 44 të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, pika 2.

3. Çertifikatë përdorimi e miratuar me Vendim nr. 4, datë 14/06/2024, për objektin “Objekt banimi 2kt+bodrum”, me adresë qyteti Bajram Curri, Bashkia Tropojë, me zhvillues Xh. I. me problematika si më poshtë vijon:

- Mungojn fotot ne 4 drejtime të objektit, më konkretisht mungon foto në drejtim nga lindja kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika j);

- Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane, kjo jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Mungon planvendosje e objektit, veprim ky jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika j).

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit, të trajtuara më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. R. B**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tropojë (për rastet 1,2 dhe 3);

- **Z. E. M**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastet 1,2 dhe 3);

- **Z. M. K**, në cilësinë spec.sek i shqyrtimit lejeve të DPZHT (për rastet 1 dhe 2);

- **Z. H. I**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastet 2 dhe 3);

- **Z. M. V**, në cilësinë spec. sektori i shqyrtimit lejeve të DPZHT (për rastin 3).

Në lidhje me lejimin e fillimit të punimeve pa u pajisur paraprakisht me dokumentin e miratuar “Njoftim për fillimin e punimeve”, ngarkohet me përgjegjësi:

- **Z. N. R**, në cilësinë e kryeinspektorit të IMTV (për rastin 1).

Për sa më sipër janë paraqitur observacionet: për Projektraportin e Auditimit nga Bashkia Tropojë me nr. 3219/36, datë 02.02.2026 ardhur në KLSH me nr. 467/7, datë 05.02.2026 nga H. I, E. M, M. V, M. K, për sa më poshtë:

1.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje për objektin “Kompleks bujtinë me prespektivë agroturizëm 2 dhe 1 kat + 1 kat nëntokë”, me konstatimin se mungon studimi gjeologo-inxhinierik dhe studimi sizmiko-inxhinierik shprehen se: “Ne si grup pune tek sistemi i lejeve të Bashkisë Tropojë sqarojmë në bazë të pikës 6 , nenit 10/1 dhe pikës 6 nenit 21 të VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” në rastin e aplikimit për leje zhvillimi dërguam për mendim tek autoriteti UPT-IGJEUM si autoritet përgjegjës për studimin gjeologo-inxhinierik dhe sizmiko-inxhinierik për të na informuar nëse ishte nevoja për realizimin e këtyre studimeve dhe pajisjen e tyre në rastin kur të aplikonte me leje ndërtimit (sic bëhet dhe në rastin e Efiçensës së Energjisë). Por kemi marr një miratim në heshtje nga ana e tyre dhe sipas pikes 6 të nenit 10/1 “..Në mungesë të përgjigjes së autoriteteve publike nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit brenda 10 ditëve pune, kërkesa konsiderohet e miratuar në heshtje dhe autoriteti përgjegjës i zhvillimit ka detyrimin të vijoje me shqyrtimin e kërkesës për leje..”, pra kemi vlerësuar në bazë të kësaj përgjigje që, leja në fjalë s'kishte nevojë për studim gjeologo-inxhinierik dhe sizmiko-inxhinierik. Theksojmë gjithashtu se, sipas

VKM-së nr. 1162, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi", pikës 1 "Të gjitha subjektet, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi ose leje ndërtimi, për të cilat nuk nevojitet pajisja paraprake me një leje zhvillimi, duhet që fillimisht të pajisen me një vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen, për të cilën këto subjekte paraqesin kërkesë." nderkohë që aplikimi në fjalë nevojitet leja e zhvillimit dhe nuk futet tek pika 1".

1.2 Qëndrimi grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj shprehemi se studimi gjeologo-inxhinierik dhe studimi sizmiko-inxhinierik janë të detyrueshëm sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi". Dhenia e mendimit nga UPT-IGJEUM nuk ndikon në miratimin e lejes së ndërtimit. Për sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

2.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin se zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin "Njoftim për fillimin e punimeve" shprehen se: "Ne si grup pune në sistemin elektronik të e-lejeve sqarojmë se aplikuesi N. Sh. dhe zhvilluesi B. M. për leje e ndërtimit nuk kanë aplikuar në asnjë moment për njoftim fillim punimesh sipas nenit 40 të ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, prandaj si mund të pajisjet me Njoftim Fillim Punimesh nga ana jonë ndërkohë që skemi një aplikim të tillë. Pra kjo pikë e lënë në akt konstatim nuk është pasojë e mosveprimit të strukturës së Urbanistikës, por rezultat i mosaplikimit nga ana e zhvilluesit dhe aplikuesit".

2.2 Qëndrimi grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se, **merret në konsideratë dhe se nuk do të ngarkoheni me përgjegjësi për këtë çështje.**

3.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin se mungon licenca individuale e hartuesit të projektit për mbrojtjen ndaj zjarrit shprehen se: "Në sistemin elektronik të e-lejeve është paraqitur licenca individuale e hartuesit të projektit për mbrojtjen ndaj zjarrit (znj. M. Sh.) si më poshtë, duke u vlerësuar nga neve si pikë e plotësuar duke qenë e listuar në licensë".

3.2 Qëndrimi grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se grupi i auditimit ka konstatuar se mungon certifikata e ekspertit zjarfikës. Për sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

4.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin se kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 84 ditësh pune shprehen se: "Ne si grup pune te sistemi i lejeve të Bashkisë Tropojë\+ sqarojme se aplikimi në fjalë ka kaluar në këto etapa, për shkak të natyrës që kishte: 5 ditë kohë që mori shqyrtimi te dokumentacioni ku u vlerësua që kishte mangësi dhe u njoftua aplikuesi për ti plotësuar ato, 15 ditë kohë që mori aplikuesi për të plotësuar dokumentacionin që kishte mangut dhe hodhi në sistem, 5 ditë kohë që mori shqyrtimi i dokumentacionit tani të plotësuar nga aplikuesi dhe u vlerësua i plotë. Kemi sipas pika 6, nenit 21 të VKM 408/2015 "Për miratimin dhe rregullimin e Territorit " i ndryshuar që u dergua për mendim tek autoritet e tjera publike, 10 ditë kohë që morën autoritet e tjera publike për të kthyer përgjigje, ku projekti kishte nevojë të ndryshohej për të plotësuar kriteret e Ministrisë së Turizmi, 5 ditë kohë për aplikuesin dhe zhvilluesin që rregullonin projektin dhe të hidhej në sistem nga ana e tyre, 5 ditë kohë që ndërmori grupi i shqyrtimit, duke i konsideruar të plotë dhe ridërgoi në sistem për mendim tek autoritet e tjera publike kjo në bazë të pikës 6, nenit 21 të VKM 408/2015 "Për miratimin dhe rregullimin e Territorit " i ndryshuar, 10 ditë kohë që morën autoritet e tjera publike për të ridërguar mendimet e tyre, 15 ditë pune që u nevojiten për të realizuar Vlerësimin Teknik Pozitiv nga grupi i shqyrtimit të kërkesave për leje, dhe ky informacion u kalua te Sektori i Taksave për përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, 5 ditë pune që u ndërmorë nga Sektori i Taksave për përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe njoftimi i saj drejt aplikuesit, 4 ditë kohë që u ndërmor për tu paguar kjo taksë dhe për tu konfirmuar nga ana e Bashkisë Tropojë, 5 ditë kohë për të

përgatitur miratimin e lejes së ndërtimit dhe hedhjen e saj në sistem nga grupi i shqyrtimit të kërkesave tek sistemi i lejeve. Të gjitha keto afate u ndërmorën duke u mbështetur në nenet 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, ku të cilat ishin përcaktuar dhe si afat kohor në sistemin elektronik të e-lejeve. Sqarohet gjithashtu që kjo leje nuk është e miratuar në heshnje e cila do ndodhte nëse do kalohej afati i caktuar kohor max që lejohet për shqyrtim, prandaj si rrjedhojë janë respektuar të gjitha afatet e nevojshme".

4.2 Qëndrimi grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se, referuar dispozitave ligjore, afati maksimal për shqyrtimin e aplikimeve për leje ndërtimi është 65 ditë, dhe jo 84 ditë. Për sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

5.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin se mungojnë foto në 4 drejtimet; mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mungon planvendosja e objektit shprehur se: "Rasti 1, sqarohet se në sistemin elektronik të lejeve në aplikimin AN090220240039, nën rubrikën "Dokumente të detyrueshme" ndodhet dokumenti me emër "Foto e objektit" që përmban këto të dhëna. Rasti 2, sqarohet se, në sistemin elektronik të lejeve në aplikimin AN090220240039, nën rubrikën "Të Tjera" ndodhet dokumenti me emër "DOK .E INSTITUCIONEVE, OSHE, UJS, MZSH, SHËRBIME" ku në faqen 3 përmban këto të dhëna. Rasti 3, Sqarohet se, në sistemin elektronik të lejeve në aplikimin AN090220240039, nën rubrikën "Dokumenta të detyrueshme" ndodhet dokumenti me emër "Projekti Arkitektonik" ku në faqen 2 përmban këto të dhëna".

5.2 Qëndrimi grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se, në lidhje me konstatimin se mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe planvendosja e objektit, duke qenë se këto dokumente janë vendosur në dispozicion, argumentimi juaj pranohet dhe nuk do të ngarkohen me përgjegjësi për këto çështje. Në lidhje me konstatimin se mungon foto e fasadës lindore, duke qenë se nga ana juaj nuk është vendosur në dispozicion ndonjë dokumentacion shtesë, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në një rast, objekti i miratuara nuk respekton kondicionet urbane, siç janë lartësia e lejuar për objektet bujqësore dhe distancat urbane nga kufiri i pronës. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastin e mëposhtëm:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4, datë 27/06/2023, për objektin "**Kompleks bujtinë me prespektivë agroturizëm 2 dhe 1 kat + 1 kat nëntokë**", me adresë në fshatin Plaç, Bashkia Tropojë, me zhvillues B. P. M. me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar. Sipas përcaktimeve në nenin 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.04.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, 3, nën-pika c), ku përcaktohet se: "Kati për përdorim shërbimi, lartësia minimale dysheme–dysheme është 4.00 m.", shprehemi se se objekti nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar në dy raste, DPZHT ka miratuar dy objekte me lartësi 3.4m restoranti dhe 3.78 m SPA. Për gjetjen e konstatuara në procedurën e miratimit të lejes të ndërtimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. R. B.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tropojë;
- **Z. E. M.**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT;
- **Z. M. K.**, në cilësinë spec. sektori i shqyrtimit lejeve të DPZHT.

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Tropojë, jo gjithmonë ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika

6, DPZH ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Gjithashtu, në dispozitat nënligjore të sipërcituara, specifikohet gjithashtu se informacioni, që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4, datë 27/06/2023, për objektin “Kompleks bujtinë me prespektivë agroturizëm 2 dhe 1 kat + 1 kat nëntokë”, me adresë në fshatin Plaç, Bashkia Tropojë, me zhvillues B. P. M. me problematika si më poshtë vijon:

- Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, pika 6, DPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se:

- Leja e ndërtimit është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DV ASHK, edhe pse në dispozitat rregullatorë të sipërcituara shprehet qartësisht se informacioni, që mundësojnë DV ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1, datë 27/11/2024, për objektin “Agroturizëm me struktur akomodimin dhe shërbim 1 dhe 2 kat dhe me aktivitet rekreativ”, me adresë në fshatin Buçaj, Bashkia Tropojë, me zhvillues A. Ç. K. me problematika si më poshtë vijon:

- Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, pika 6, DPZH ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se:

- Leja e ndërtimit është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DVASHK, edhe pse në dispozitat rregullatorë të sipërcituara shprehet qartësisht se informacioni, që mundësojnë DVASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. R. B**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tropojë (*për rastin 1 dhe 2*);
- **Z. E. M**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (*për rastin 1*);
- **Z. H. I**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (*për rastin 2*);
- **Z. M. K**, në cilësinë spec. sektori i shqyrtimit lejeve të DPZHT (*për rastin 1*).
- **Z. M. V**, në cilësinë spec. sektori i shqyrtimit lejeve të DPZHT (*për rastin 2*).

Për sa më sipër janë paraqitur observacionet: për Projektraportin e Auditimit nga Bashkia Tropojë me nr. 3219/36, datë 02.02.2026 ardhur në KLSH me nr. 467/7, datë 05.02.2026 nga H. I, E. M, M. V, M. K, për sa më poshtë:

6.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin se nuk është marrë mendimi DVASHK, shprehen se: *“Ne si grup pune tek sistemi i lejeve të Bashkisë Tropojë sqarojmë se në bazë të pikës 6, nenit 10/1 dhe pikës 6, nenit 21 të VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” kemi kërkuar mendim tek të gjitha autoritet e nevojshme që duhet të shprehen për miratimin e kësaj leje si më poshtë. Theksojmë gjithashtu se kjo*

kërkesë është dërguar për mendim tek “Zyra Vendore ASHK Tropojë” në sistemin elektronik të e-lejeve, si dhe në mënyrë shkresore për të cilën “Zyra Vendore ASHK Tropojë” ka miratuar në heshtje. Duke qenë se, sipas pikës 6, nenit 21 “Përjashtimisht, në kuptim të këtij neni, informacioni, që mundësojnë drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e kërkesës aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën...” sqarojme se: Në sistemin elektronik të lejeve paraqitet vërtetimi hipotekor , kartela e pasurisë dhe harta treguese për pronën në fjalë të firmosur dhe vulosur nga ASHK Zyra Vendore Tropojë ku jepen të gjitha të dhënat si, statusi i pronësisë, vol, faqja, sipërfaqja etj.”

6.2 Oëndrimi grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se, mendimdhënia nga ana e DVASHK është një proces i detyrueshëm, pasi, në bazë të përgjigjes së këtij autoriteti, Bashkia Tropojë merr informacion në kohë reale nëse mbi pronë janë kryer tjetërsime ose jo, nga riferskimi më i fundit i dokumentacionit pronësor deri në aplikimin për pajisje me leje ndërtimi. Gjithashtu, dispozitat nënligjore shprehen qartë mbi kushtin që ASHK-të kanë për dhënien e informacionit mbi statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e kërkesës aplikimit, kusht i cili është i detyrueshëm të zbatohet nga Bashkia Tropojë. Për sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Tropojë, jo gjithmonë ka kërkuar/respektuar

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4, datë 27/06/2023, për objektin “Kompleks bujtinë me prespektivë agroturizëm 2 dhe 1 kat + 1 kat nëntokë”, me adresë në fshatin Plaç, Bashkia Tropojë, me zhvillues B. P. M. me problematika si më poshtë vijon:

- Bashkia Tropojë ka miratuar ndërtimin e një objekti në tre njësi strukturore ku nuk është i lejuar ndërtimi i kësaj tipologjie. Objekti i miratuar është një strukturë agroturistike. Njësitë strukturore në të cilën është menduar të zhvillohet objekti janë: N1-520, me të dhëna si vijon: i. Sistemi: *N-Natyror*; ii. Kategori 1: *N.Natyre 100%*; iii. Përdorime të lejuara: *Shtigje rekreative me biciklete; Shtigje për këmbësorët; Aktivitete rekreative*; iv. Përdorime të ndaluara: *Të gjitha të tjerat*. B1-567, me të dhëna si vijon: i. Sistemi: *B-Bujqësor*; ii. Kategori 1: *B.Bujqësi 100%*; iii. Përdorime të lejuara: *Tokë bujqësore e kultivuar; sipërfaqe bujqësore; Kullotë; Struktura bujqësore ndihmëse; Aktivitete bujqësore mbështetëse*; iv. Përdorime të ndaluara: *Të gjitha të tjerat*. B3-138, me të dhëna si vijon: i. Sistemi: *B-Bujqësor*; ii. Kategori 1: *B.Bujqësi 100%*; iii. Përdorime të lejuara: *Sipërfaqe Agro-Pyjore; Struktura bujqësore ndihmëse; Aktivitete bujqësore mbështetëse*; iv. Përdorime të ndaluara: *Të gjitha të tjerat*. Siç konstatohet, ndërtimi i strukturave agroturistike nuk është i lejuar në këto njësi strukturore. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika c), ç) dhe nenin 12 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Tropojë, pika 1, 2.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1, datë 27/11/2024, për objektin “Agroturizëm me struktur akomodimin dhe shërbim 1 dhe 2 kat dhe me aktivitet rekreativ”, me adresë në fshatin Buçaj, Bashkia Tropojë, me zhvillues A. Ç. K. me problematika si më poshtë vijon:

Bashkia Tropojë ka miratuar ndërtimin e një objekti në një njësi strukturore ku nuk është i lejuar ndërtimi i kësaj tipologjie. Objekti i miratuar është një strukturë agroturistike. Njësi strukturore në të cilën është menduar të zhvillohet objekti është **N1-444**, me të dhëna si vijon: **i.** Sistemi: *N-Natyror*; **ii.** Kategori 1: *N.Natyre 100%*; **iii.** Përdorime të lejuara: *Shtigje rekreative me biciklete; Shtigje për këmbësorët; Aktivitete rekreative*; **iv.** Përdorime të ndaluara: *Të gjitha të tjerat*. Siç konstatohet, ndërtimi i strukturave agroturistike nuk është i

lejuar në këto njësi strukturore. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika c), ç) dhe nenin 12 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Tropojë, pika 1 dhe 2.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. R. B**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tropojë (për rastin 1 dhe 2);
- **Z. E. M**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastin 1);
- **Z. H. I**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastin 2);
- **Z. M. K**, në cilësinë spec. sektori i shqyrtimit lejeve të DPZHT (për rastin 1).
- **Z. M. V**, në cilësinë spec. sektori i shqyrtimit lejeve të DPZHT (për rastin 2).

Për sa më sipër janë paraqitur observacionet: për Projektraportin e Auditimit nga Bashkia Tropojë me nr. 3219/36, datë 02.02.2026 ardhur në KLSH me nr. 467/7, datë 05.02.2026 nga H. I, E. M, M. V, M. K, për sa më poshtë:

7.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin, ka miratuar ndërtimin e një objekti në tre njësi strukturore ku nuk është i lejuar ndërtimi i kësaj tipologjie, shprehen se: “Ne si grup pune tek sistemi i lejeve të Bashkisë Tropojë sqarojmë që objekti që shtrihet në njësitë strukturore Natyrë (N) dhe Bujqësi (B) sipas rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor Tropojë miratuar me Vendim të KKT nr.2 datë 09.12.2017 cituar dhe në konstatim, si objekt që kërkon të ushtrojë agroturizimin, sipas aplikimit, kjo leje është vlerësuar në bazë të Vendim nr. 12 KKT dt 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)” i ndryshuar ku sipas pikës 1 thotë: “Në bashkitë të cilat kanë Plane të Përgjithshme Vendore të miratuara, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të japin leje zhvillimi/ndërtimi, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N), për objektet e strukturat si më poshtë: a) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial; b) Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial.” Pra Bashkia Tropojë sipas pikës 1, të këtij Vendimi, duke qenë se ka të miratuar Plan të Përgjithshëm Vendor i lejohet të miratojë leje ndërtimi/zhvillimi për strukturat ku ushtrohet agroturizimi. Gjithashtu meqenëse për miratimin e kësaj leje zhvillimi/ndërtimi po vlerësohej sipas Vendimit nr.12 KKT dt 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)” i ndryshuar, në bazë të pikës 6. U dërgua dhe me shkresën nr.1012/1 Prot, datë 16.02.2023 për marrjen e konfirmimit nga AZHT dhe Ministria e Linjës gjithashtu u njoftua Këshilli Kombëtar i Territorit në mënyrë që të mund të vijohet me miratimin e kërkesës për leje zhvillimit/ndërtimi. Duke qenë se, Projektideja përmbush këto pika të cituara nga Ministria e Turizmit, u vlerësua se kemi një konfirmim nga ana e tyre për realizimin e këtij projekti dhe nuk kemi një refuzim pra, që ky projekt të mos realizohet. Pra Bashkia Tropojë mund të vijojë për shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij projekti për pajisje me Leje Ndërtimi në përputhje me Vendimin nr.12 datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit, (Pra vendimit të cituar në pikën 1 që kemi marrë neve për bazë), pas marrjes së konfirmimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (që sic u sqarua më sipër ne kishim konfirmimin nga ana e tyre). Pra kemi konfirmimin e tyre për realimin e këtij projekt ideje për tu pajisur me leje ndërtimi duke qenë se përmbushet kriteri i vendosur prej tyre. Duke qenë se sipas pikës 6, përmbusheshin dy pikat e nevojshme, pra kishim konfirmimin e AZHT dhe Ministrisë së Turizmit. Njoftimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me shkresë nr. 1012/1 Prot, datë 16.02.2023 u vlerësua e arsyeshme dhe me bazë vijimësia miratimi i lejes së ndërtimit për objektin “Kompleks Bujtinë me prespektivë për agroturizëm 2 dhe 1 kate + 1 kat nëntokë” me zhvillues Z.B. P. M.”.

7.2 Oëndrimi grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se, kemi të bëjmë me një keqinterpretim nga ana juaj të dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara. **Së pari**, në përcaktimin “Në bashkitë të cilat kanë Plane të Përgjithshme Vendore të miratuara, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të japin leje zhvillimi/ndërtimi, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N), për objektet e strukturat si më poshtë: a) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial: b) Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial” nuk citohet se Bashkia Tropojë ka të drejtë të miratojë leje ndërtimi të çfarëdolloji në secilën prej këtyre sistemeve (Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N). Per t’a ilustruar, Bashkia Tropojë nuk mund të miratojë një aplikim për ndërtimin e një stalle për mbareshtimin e gjedheve në sistemin Urban, për aq kohë sa në njësinë strukturore ndërtimi i objekteve bujqësore/blegtorale është i ndaluar. I njëjti interpretim vlen dhe për rastin në fjalë. Për aq kohë sa ndërtimi i strukturave agro-turistike nuk është i lejuar/është i ndaluar për njësinë strukturore ku zhvillohet objekti, Bashkia Tropojë nuk ka kompetencë të shqyrtoje/miratojë leje ndërtimi për këto lloj strukturash. **Së dyti**, marrja e mendimit nga autoritetet që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, është një proces që kryehet pasi Bashkia ka shqyrtuar procedurën, ka vlerësuar dokumentacionin, ka kërkuar (ose jo) kryerjen e ndryshimeve në projekt dhe plotësimin e dokumentacionit. Pra, për Bashkinë Tropojë, miratimi i lejes së ndërtimit në një njësi strukturore ku nuk lejohet zhvillimi i një tipologjie të caktuar, nuk ka përbërë motiv për refuzimin e aplikimit. Per sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

8.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin se është miratuar një leje ndërtimi në një njësi strukturore ku nuk është i lejuar ndërtimi i kësaj tipologjie, shprehen se: “Ne si grup pune tek sistemi i lejeve të Bashkisë Tropojë sqarojmë që objekti që shtrihet në njësitë strukturore Natyrë (N) sipas rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor Tropojë miratuar me VKKT nr.2 datë 09.12.2017 cituar dhe në konstatim, si objekt që kërkon të ushtrojë agroturizimin, sipas aplikimit, kjo leje është vlerësuar në bazë të Vendim nr.12 KKT dt 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)” i ndryshuar, ku sipas pikës 1 thotë: “Në bashkitë të cilat kanë Plane të Përgjithshme Vendore të miratuara, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të japin leje zhvillimi/ndërtimi, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N), për objektet e strukturat si më poshtë: a) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial: b) Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial.” Pra Bashkia Tropojë sipas pikës 1, të këtij Vendimi, duke qenë se ka të miratuar Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar i lejohet të miratojë leje ndërtimi/zhvillimi për strukturat ku ushtrohet agroturizmi. Gjithashtu meqenëse se për miratimin e kësaj leje zhvillimi/ndërtimi po vlerësohej sipas Vendimit nr.12 KKT dt 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)” i ndryshuar, në bazë të pikës 6. U dërgua dhe me shkresën nr.4384/IProt, datë 19.10.2023 për marrjen e konfirmimit nga AZHT dhe Ministria e Linjës, gjithashtu u njoftuat Këshilli Kombëtar i Territorit në mënyrë që të mund të vijohet me miratimin e kërkesës për leje zhvillimit/ndërtimi. Ministria e Turizmit dha mendimin që: Duke qenë se Projektideja përmbush këto pika të cituara nga Ministria e Turizmit, u vlerësua se kemi një konfirmim nga ana e tyre për realizimin e këtij projekti dhe nuk kemi një refuzim pra që ky projekt të mos realizohet. Agjencia Kombëtare E Zonave Të Mbrojtura Drejtoria E Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit informon se, në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit për Leje zhvillimi, sipërfaqja ku do të zhvillohet projekti: “Agroturizëm me struktura akomodimi dhe shërbimi 1

dhe 2 kat dhe aktivitete rekreative”, Fshati Buçaj, Bashkia Tropojë, pronë private, tokë arë, me zhvillues “A. K.” dhe aplikues “Z. K.”, me nr. Aplikimi AN021020230023, ndodhet brenda PK “Alpet e Shqipërisë”, shpallur me VKM-në Nr. 59, datë 26.01.2022 “Për Miratimin e Ndryshimit të Statusit dhe Sipërfaqes së Ekosistemeve Natyrore “Park Kombëtar” (Kategoria II) e zonave të mbrojtura mjedisore”, në nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (ZPT/Q). Sipas VKM-së së mësipërme, Aneksi 1, për nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (ZPT/Q), citohet se: “Kjo nënzonë përfshin tokat bujqësore e kullotat dhe territore ujore ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale si bujqësi, kullotje, grumbullimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit. Në nënzonën e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm, zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive ekonomike, sociale, agrobiznesit, argëtuese, sportive e ekoturistike, ndërtimi i infrastrukturës sipas planeve të zhvillimit urban e turistik të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), të cilat nuk çenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor”. Sipas nenit 29, pika 12 të rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendim Nr.02 datë 09.12.2017, Agroturizmi bën pjesë tek Shërbimet Private në shkallë të vogël pra, që ka një ndikim të ulët dhe të kontrolluar duke respektuar integritetin ekologjik të ekosistemit dhe funksionet e zonës së mbrojtur, prandaj si grup pune kemi sugjeruar për vazhdimin e procedurës vlerësimit të mëtejshëm të kësaj leje. Agjencia Kombëtare E Mjedisit Drejtoria E Shqyrtimit Dhe Monitorimit Të Lejeve Mjedisore dhe VNM informon se, në bazë të ligjit nr.10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, sipas Shtojcave I dhe II, aktiviteti “Agroturizëm me struktura akomodimi dhe shërbimi 1 dhe 2 kat dhe aktivitete rekreative”, vendodhja Tropojë, me zhvillues “A. K.”, është pajisur me Vendim për VNM Paraprake në Komisionin Nr.93, datë 25.07.2024. Ju sjellim në vëmendje se në bazë të Ligjit Nr. 10 440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” të ndryshuar, Neni 20, Pika 5: Nëse veprimtaria nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 viteve nga data e miratimit të vendimit për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para. Agjencia e Zhvillimit informon se: Pra Bashkia Tropojë mund të vijojë për shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij projekti për pajisje me Leje Ndërtimi në përputhje me Vendimin nr.12 datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit (Pra vendimit të cituar në pikën 1 që kemi marr neve për bazë), pas marrjes së mendimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (që sic u sqarua më sipër ne e kshim marrë atë) dhe mendimi pozitiv nga Agjencia Kombëtare E Zonave Të Mbrojtura (që dhe kjo si më sipër ishte marrë nga ana jonë). Pra duke u përmbushur këto dy pika kishim konfirmimin nga ana e AZHT që Bashkia mund të vijojë me dhe vlerësimin e këtij projekti për pajisje me Leje Ndërtimi në përputhje me Vendimin nr.12 datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit. Pra kemi konfirmimin e tyre për realimin e këtij projekt ideje për tu pajisur me leje ndërtimi duke qenë se përmbushet kriteri i vendosur prej tyre. Duke qenë se sipas pikës 6, përmbusheshin dy pikat e nevojshme, pra kishim Konfirmimin e AZHT dhe Ministrisë së Turizmit , Njoftimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me shkresë nr. 4384/1 Prot, datë 19.10.2023 u vlerësua e arsyeshme dhe me bazë vijimësia miratimi i lejes së ndërtimit për objektin: “Agroturizëm me strukturë akomodimin dhe shërbim 1 dhe 2 kat dhe me aktivitet rekreativ”, me adresë fshati Buçaj, Bashkia Tropojë, me subjekt zhvillues A. Ç. K.

8.2 Qëndrimi grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se, kemi të bëjmë me një keqinterpretim nga ana juaj të dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara. **Së pari**, në percaktimin “Në bashkitë të cilat kanë Plane të Përgjithshme Vendore të miratuara, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të japin leje zhvillimi/ndërtimi, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N), për objektet e strukturat si

*më poshtë: a) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial: b) Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial” nuk citohet se Bashkia Tropojë ka të drejtë të miratojë leje ndërtimi të gfarëdolloji në secilën prej këtyre sistemeve (Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N). Për t’u ilustruar, Bashkia Tropojë nuk mund të miratojë një aplikim për ndërtimin e një stalle për mbarëshkrimin e gjedhëve në sistemin Urban, për aq kohë sa në njësinë strukturore ndërtimi i objekteve bujqësore/blegtorale është i ndaluar. I njëjti interpretim vlen dhe për rastin në fjalë. Për aq kohë sa ndërtimi i strukturave agro-turistike nuk është i lejuar/është i ndaluar për njësinë strukturore ku zhvillohet objekti, Bashkia Tropojë nuk ka kompetencë të shqyrtojë/miratojë leje ndërtimi për këtë lloj strukturash. **Së dyti**, marrja e mendimit nga autoritetet që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, është një proces që kryhet pasi Bashkia ka shqyrtuar procedurën, ka vlerësuar dokumentacionin, ka kërkuar (ose jo) kryerjen e ndryshimeve në projekt dhe plotësimin e dokumentacionit. Pra, për Bashkinë Tropojë, miratimi i lejes së ndërtimit në një njësi strukturore ku nuk lejohet zhvillimi i një tipologjie të caktuar, nuk ka përbërë motiv për refuzimin e aplikimit. Per sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.***

Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit:

1. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se tre raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Më konkretisht, këto parregullsi kanë të bëjnë me: mungon studimi gjeologo-inxhinierik dhe studimi sizmiko-inxhinierik; mungon deklarata e përgjegjësis profesionale të hartuesit të projektit për mbrojtjen ndaj zjarrit; mungon licenca individuale e hartuesit të projektit për mbrojtjen ndaj zjarrit; proejkti elektrik nuk është i plotë pasi mungojn instalimet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe detajet e montimit të sistemit rrufe-pritëse; mungon projekti arkitektonik në formatin DWG; në një rast, zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin “Njoftim për fillimin e punimeve”.
2. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në një rast objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane, si janë distancat urbane nga kufiri i pronës dhe lartësia maksimale e lejuar për objektet bujqësore.
3. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Në dy raste, DPZHT ka miratuar lejen e ndërtimit pa marrë mendim pozitiv nga DV ASHK.
4. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, DPZHT ka miratuar leje ndërtimi për struktura agro-turistike në njësi strukturore në të cilat nuk është e lejuar të ndërtohet kjo tipologji.

2.5. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)

- Mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.
- Mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.
- Mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) ushtron aktivitet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, struktura organizative e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është miratuar me Vendim Nr.473, datë 20.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, “Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2023”. Struktura e miratuar e IMTV ka 2 punonjës, 1 Kryeinspektor (inxhinieri) dhe 1 Inspektor (Juridik).

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, struktura organizative e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është miratuar me Vendim Nr.818, datë 13.02.2024 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, “Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2024”. Struktura e miratuar e IMTV ka 2 punonjës, 1 Kryeinspektor (inxhinieri) dhe 1 Inspektor (Juridik).

Referuar vendimeve të sipërcituara dhe strukturës organizative të IMTV-së, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024, IMTV ka pasur në strukturën e tij, punonjësit sipas tabelës në vijim:

Tabela nr. 1: Struktura e IMTV, Bashkia Tropojë

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Lloji i Diplomimit	Data e fillimit	Shënime
1	N. R.	Inspektore	Inxhinieri	15.07.2020	Dal në pension 30.08.2025
2	A. N.	Inspektor	Juridik	20.10.2023	Aktualisht në punë

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet t’i ushtrorë detyrat e tij funksionale në bazë të planeve mujore të punës, sipas planifikimit, i cili hartohet nga kryeinspektori i IMTV-së, në zbatim të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore”.

Nga IMTV Tropojë janë vendosur në dispozicion planet e punës, të miratuara nga kryeinspektori për çdo muaj.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet të përgatisë dhe t’i japë të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për masat e marra, si p.sh. vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licencave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika e, të Ligjit nr.9780, datë 16/07/2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

Nga ana e IMTV Tropojë gjatë viteve 2023-2024 është dërguar raport pranë IKMT Drejtoria Rajonale Kukës çdo tre muaj.

- Mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi

Në ushtrimin e detyrave funksionale të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Tropojë për periudhën objekt auditimi, aktiviteti i veprimtarisë së punës në terren i cili është pasqyruar dhe dokumentuar me procesverbale konstatimi dhe për më tej me vendime pezullimi punimesh dhe vendime për prishje objekti të ndërtuar pa leje ndërtimi, në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela Nr.2: Pasqyra e vendimeve të mara për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024

Nr.	Lloji i aktit	2023	2024
1	PV/Akte konstatimi	4	16
2	Vendime gjobe	4	16
3	Vendime pezullimi	3	14
4	Vendime prishje	2	6
5	PV ekzekutimi të prishjeve	0	0
6	Kallëzime penale	1	1
7	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	0	0
8	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	4	4
9	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	12	12

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunoi Grupi i Auditimit

-Për periudhën 2023-2024 nga Inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Tropojë janë kryer **20 kontrole dhe janë proceduar 20 subjekte** për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi të shoqëruara me Vendim për “Prishje të Objektivit të Kundërligjshëm” dhe me Vendim për “Dënim me Gjobë” refruar ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Konkluzion: Përgjatë viteve 2023-2024 rezulton se:

-Në 8 raste, Nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar për Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohen inspektorët e IMT në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar.

-Në 7 raste, nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Prishje e Objektivit të Kundërligjshëm” në kundërshtim me nenin 5 pika “d” dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Në 2 raste, nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar procedura me nxjerrjen e vendimit për “Pezullimin e Punimeve” në kundërshtim me nenin 5 pika “ç” dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Në 2 raste, nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është bërë “Kërkesë për mbështetje” drejtuar “Drejtorisë Rajonale IKMT Kukës” në lidhje me ekzekutimin për prishjen e objekteve të kundërligjshëm.

-Gjatë viteve 2023-2024, në 20 raste kundërvajtja e konstatuar nga IMTV Tropojë nuk është dokumentuar me fotografi ose video si dhe nuk është hapur dosje individuale për secilën praktikë apo subjekt. Në kundërshtim me, neni 41, Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të kundërvajtjes së konstatuar me foto ose video, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.

-Kryeinspektori IMTV Tropojë ka përdorur fletë të fotokopjuara për nxjerrjen e vendimeve për “Dënim me gjobë” dhe “Prishje të objektit të kundërligjshëm” deri më 26.10.2023, duke pretenduar se nuk ka pasur blloqe në formatin zyrtar për mbajtjen e këtyre vendimeve. Veprime në kundërshtim me pika 6,7, të VKM nr.894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

-Në 5 raste, edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektorët në terren, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm”, në kundërshtim me nenin 5 pika “d” dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë

16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Tabela Nr.3: Subjektet që nga Kryeinspektori i IMT-së Tropojë nuk janë nxjerrë vendime për "Prishjen e Objektivit të kundërligjshëm"

Nr.	Emri Subjektit (Shoqëria)	Lloj objektit	Vendimi	
			Nr.	Datë
1	4 A.sh.p.k	Hapje Rruge	-	17.08.2023
2	S. N.	Hapje Rruge	-	04.10.2023
3	V. M.	Hapje Rruge	-	14.11.2023
4	R. D.	Ndërtim pa leje	-	02.10.2024
5	I. S.	Ndërtim pa leje	-	17.12.2024

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunoi Grupi i Auditimit

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMTV Tropojë nuk është bërë kallëzim penal për subjektet e mësipërme që kanë kryer ndërtime informale pa leje ndërtimi, në kundërshtim të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, pika dh), si dhe nenit 52 i Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, pika 7, kryeinspektori i IMTV ka detyrimin e përgatitjes së kallëzimit penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe të paraqitjes së tij pranë organeve përgjegjëse. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi znj. N. R. me detyrë ish-Kryeinspektore, z. A. N. me detyrë Inspektor.

- **Gjatë viteve 2023-2024** nga IMT-ja e Bashkisë Tropojë është bërë kallëzim penal për 2 subjekte që kanë kryer ndërtime informale pa leje ndërtimi, më konkretisht:

Tabela Nr.4: Pasqyra mbi kallëzimet penale të IMTV, periudhën gjendje 31/12/2023 dhe 31/12/2024

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i objektit	Kallëzim penal	
			Nr.	datë
1	F. B.	Hapje Rruge	5128	09. 11. 2023
2	P. Gj.	Ndërtim pa leje	1321	11. 03. 2024

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunoi Grupi i Auditimit

Mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit me zgjedhje i procedurave të ndjekura nga IMTV-ja për ekzekutimin e vendimeve në lidhje me ndërtimet informale të ndërtuar pa leje ndërtimi si dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit rezultoi:

Subjekti F. B.:

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 11.12.2023 nga Inspektorët N. R. dhe A. N, në subjektin F. B. me adresë Lagja Koj, Bashkia Tropojë, është konstatuar se subjekti ka kryer punime hapje, gërmim dhe rrethim të pronës publike pa dokumentacion tekniko-ligjor.

Me datë 11.12.2023 nga Kryeinspektori IMT është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej 100,000 lekë për kryerjen e punimeve për hapje, gërmim dhe rrethim të pronës publike pa dokumentacion tekniko-ligjor.

Konkluzion: Konstatohet se, vlera e gjobës nuk është llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika e).

Nga Kryeinspektori IMT Tropojë nuk është vijuar procedura me nxjerrjen e vendimit për "Pezullimin e Punimeve" në kundërshtim me nenin 5 pika "ç" dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Me datë 15.12.2023 nga Kryeinspektori IMT është marrë vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm dhe kthimin në gjendjen e mëparshme.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar për Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohen inspektorët e IMT në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar,

Subjekti Shoqëria “A. E.” SHPK:

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 14.11.2023 nga Inspektorët N. R. dhe A. N, në subjektin “A. E.” SHPK me adresë aktiviteti, vendi i quajtur “Perlinat e Bardha”, Njësia Administrative Tropojë Fshat, Bashkia Tropojë, është konstatuar se subjekti ka kryer punime për ndërtim HEC dhe vendosje tubacionesh pa dokumentacion tekniko-ligjor.

Me datë 14.11.2023 nga Kryeinspektori IMT është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej 500,000 lekë për ndërtim pa dokumentacion tekniko-ligjor.

Me datë 14.11.2023 Kryeinspektori IMT Tropojë ka marrë vendim për pezullimin e punimeve të subjektit “A. E.” SHPK për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor.

Me datë 18.12.2023 Kryeinspektori IMT ka marrë vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm dhe kthimin në gjendjen e mëparshme.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Prishje e Objektit të Kundërligjshëm“ në kundërshtim me nenin 5 pika “d” dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar për Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohen inspektorët e IMT në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

Subjekti S. S.:

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 26.01.2024 nga Inspektorët N. R. dhe A. N, në subjektin S. S. me adresë fshati Valbonë, Njësia Administrative Margegaj, Bashkia Tropojë, është konstatuar se subjekti ka ndërtuar dy Bujtina druri pa dokumentacion tekniko-ligjor.

Me datë 04.06.2024 nga Kryeinspektori IMT është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej 500,000 lekë për ndërtim pa dokumentacion tekniko-ligjor. Gjoha e datës 26.01.2024 është anuluar sipas kërkesës së bërë nga IKMT Drejtoria Rajonale Kukës duke qenë se nuk ka qenë në përputhje me ligjin 10279/2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Me datë 26.01.2024 Kryeinspektori IMT Tropojë ka marrë vendim për pezullimin e punimeve të subjektit S. S. për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor.

Me datë 13.02.2024 Kryeinspektori IMT ka marrë vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm dhe kthimin në gjendjen e mëparshme.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Prishje e Objektit të Kundërligjshëm“ në kundërshtim me nenin 5 pika “d” dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar për Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohen inspektorët e IMT në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

Subjekti P. Gj.:

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 14.02.2024 nga Inspektorët N. R. dhe A. N, në subjektin P. Gj. me adresë Njësia Administrative Fierzë, Bashkia Tropojë, është konstatuar se subjekti ka ndërtuar mur me derdhje betoni pa dokumentacion tekniko-ligjor.

Me datë 04.06.2024 nga Kryeinspektori IMT është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej 500,000 lekë për kryerjen e punimeve pa dokumentacion tekniko-ligjor. Gjoha e datës 14.02.2024 është anuluar sipas kërkesës së bërë nga IKMT Drejtoria Rajonale Kukës duke qenë se nuk ka qenë në përputhje me ligjin 10279/2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Me datë 14.02.2024 Kryeinspektori IMT Tropojë ka marrë vendim për pezullimin e punimeve të subjektit P. Gj. për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor.

Me datë 11.03.2024 nga Kryeinspektori IMT është marrë vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm dhe kthimin në gjendjen e mëparshme.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditore për nxjerrjen e vendimit për “Prishje e Objektit të Kundërligjshëm“ në kundërshtim me nenin 5 pika “d“ dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar për Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohen inspektorët e IMT në kundërshtim me nenin 5 pika “d“ të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar. Për këtë subjekt nga IMT Tropojë është bërë kallëzim penal nr.1321 datë 11.03.2024.

Subjekti “V.” SHPK:

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 04.06.2024 nga Inspektorët N. R. dhe A. N, në subjektin “V.” SHPK me adresë aktiviteti, Lagja “28 Gushti”, Qyteti Bajram Curri, Bashkia Tropojë, është konstatuar se subjekti ka kryer shkelje të lejes ndërtimit në shtesa dhe vëllim ndërtimor.

Me datë 04.06.2024 nga Kryeinspektori IMT është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej 500,000 lekë.

Me datë 04.06.2024 Kryeinspektori IMT Tropojë ka marrë vendim për pezullimin e punimeve të subjektit “V.” SHPK për shkelje të lejes së ndërtimit.

Datë 21.06.2024 Kryeinspektori IMT ka marrë vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditore për nxjerrjen e vendimit për “Prishje e Objektit të Kundërligjshëm“ në kundërshtim me nenin 5 pika “d“ dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar për Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohen inspektorët e IMT në kundërshtim me nenin 5 pika “d“ të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

Subjekti S. S.:

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 21.10.2024 nga Inspektorët N. R. dhe A. N, në subjektin S. S. me adresë fshati Valbonë, Njësia Administrative Margegaj, Bashkia Tropojë, është konstatuar se subjekti ka ndërtuar vendstrehim për bagëti pa dokumentacion tekniko-ligjor.

Me datë 06.11.2024 nga Kryeinspektori IMT është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej 500,000 lekë për ndërtim pa dokumentacion tekniko-ligjor. Gjoha për këtë subjekt është falur referuar ligjit 127/2024.

Me datë 21.10.2024 Kryeinspektori IMT Tropojë ka marrë vendim për pezullimin e punimeve të subjektit S. S. për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor.

Me datë 18.11.2024 Kryeinspektori IMT ka marrë vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm dhe kthimin në gjendjen e mëparshme.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditore për nxjerrjen e vendimit për “Prishje e Objektit të Kundërligjshëm“ në kundërshtim me nenin 5

pika "d" dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar për Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohen inspektorët e IMT në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Subjekti A. Z.:

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 23.10.2024 nga Inspektorët N. R. dhe A. N., në subjektin A. Z. me adresë fshati Begaj, Njësia Administrative Tropojë Fshat, Bashkia Tropojë, është konstatuar se subjekti ka ndërtuar mur rrethues dhe zaptim i hapësirës publike pa dokumentacion tekniko-ligjor.

Me datë 04.11.2024 nga Kryeinspektori IMT është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej 500,000 lekë për ndërtim pa dokumentacion tekniko-ligjor. Gjoha për këtë subjekt është falur referuar ligjit 127/2024.

Me datë 23.10.2024 Kryeinspektori IMT Tropojë ka marrë vendim për pezullimin e punimeve të subjektit A. Z. për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor.

Me datë 19.11.2024 Kryeinspektori IMT ka marrë vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm dhe kthimin në gjendjen e mëparshme.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm" në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar për Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohen inspektorët e IMT në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Subjekti Gj. N.:

Nga inspektimi i bërë në terren më datë 02.12.2024 nga Inspektorët N. R. dhe A. N, në subjektin Gj. N. me adresë fshati Cernicë, Njësia Administrative Llugaj, Bashkia Tropojë, është konstatuar se subjekti ka hapur themele dhe ngritur kollona pa dokumentacion tekniko-ligjor.

Me datë 17.12.2024 nga Kryeinspektori IMT është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën prej 500,000 lekë për ndërtim pa dokumentacion tekniko-ligjor. Nga Kryeinspektori IMT Tropojë nuk është vijuar procedura me nxjerrjen e vendimit për "Masë Administrative" brenda afatit 10 ditor, në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori IMT Tropojë nuk është vijuar procedura me nxjerrjen e vendimit për "Pezullimin e Punimeve" në kundërshtim me nenin 5 pika "ç" dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Me datë 30.12.2024 Kryeinspektori IMT ka marrë vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm dhe kthimin në gjendjen e mëparshme.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Prishje e Objektit të Kundërligjshëm" në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar për Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohen inspektorët e IMT në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi znj. N. R. me detyrë ish-Kryeinspektore, z. A. N. me detyrë Inspektor.

-Informacion më i detajuar në lidhje me vendimet për masë administrative dhe likuidimin e tyre jepet nga tabela më poshtë:

Tabela Nr.5: Vlera dhe numri i gjobave të vendosura nga IMTV Tropojë 2023-2024

Nr	Viti	Nr.Subjek.	Vlera e Gjebes total	Arketuar				Debitor	% Realizim
				Gjoba	Kamatë	Totali	Të falura		
1	01.01.2023-31.12.2023	7 gjoba	1,450,000	200,000	-	200 000	-	1,250,000	13.8
2	01.01.2024-31.12.2024	13 gjoba	5,350,000	650,000	-	650,000	1,500,000	3,200,000	12.2
	SHUMA	20	6,800,000	850 000	-	850 000	1,500,000	4,450,000	12.5

Burimi: Bashkia Tropojë pregatiti grupi i auditimit

Tabela më poshtë tregon në mënyrë më të detajuar subjektet që janë debitorë dhe ata që kanë kryer pagesën e masës administrative 2023-2024. Referuar ligjit 127/2024 “Për faljen e masave administrative” janë falur masat për 3 subjekte si vijon në tabelë:

Tabela Nr.6: Pasqyra e gjobave të aplikuara dhe vendimeve respektive, për periudhën 01.01.2023– 31.12.2024

Nr .	Subjekti	Arsyeja/Shkaku i gjobës		Vlera e gjobës	Situata aktuale e gjobës			Shënime	
		Data			Likuiduar	Proces gjyqësor	Pa likuiduar	Kamatëvonesa	Të falura
1	4 A. sh.p.k	17.08.2023	Hapje rruge pa leje	200,000	200,000	-	-	Paguar 18.08.2023	-
2	S. N.	04.10.2023	Hapje rruge pa leje	200,000	-	Po	200,000	-	-
3	P, F, C. B.	26.10.2023	Hapje rruge	100,000	-	Po	100,000	-	-
4	S.V.	26.10.2023	Shkelje e Lejes	150,000	-	-	150,000	-	-
5	M. H.	02.11.2023	Hedhje Inertesh në lumë	200,000	-	-	200,000	-	-
6	V. M.	14.11.2023	Hapje rruge	500,000	-	Po	500,000	-	-
7	F. B.	11.12.2023	Rrethim dhe Gjermim pa leje	100,000	-	-	100,000	-	-
8	A. S.	09.04.2024	Rikonstruksion dhe shtesë pa leje	150,000	150,000	-	-	Paguar 11.04.2024	-
9	P. Gj.	04.06.2024	Ndërtim pa leje	500,000	-	Po	500,000	-	-
10	V. SHPK	04.06.2024	Shkelje e Lejes	500,000	-	Po	500,000	-	-
11	S. S.	04.06.2024	Ndërtim Bujtina druri	500,000	-	Po	500,000	-	-
12	E. I.	04.06.2024	Devijim nga projekti i ndërtimit	300,000	-	-	300,000	-	-
13	V. Resort	25.09.2024	Shkelje e Afatit të përfundimit të punimeve	300,000	300,000	-	-	Paguar 27.09.2024	-
14	R. D.	02.10.2024	Mure rrethues guri pa dokumentacion	500,000	-	-	-	-	Falur sipas ligjit 127/2024
15	A. Z.	04.11.2024	Ndërtim pa leje	500,000	-	-	-	-	Falur sipas ligjit 127/2024
16	S. S.	06.11.2024	Ndërtim shkalle pa	500,000	-	-	-	-	Falur sipas ligjit 127/2024

			dokumentacion						
17	Gj. N.	17.12.2024	Shtëpi pa dokumentacion	500,000	-	Po	500,000	-	-
18	I. S.	17.12.2024	Ndërtim shtëpia druri	500,000	-	Po	500,000	-	-
19	St. Valbona	20.12.2024	Shkelje e kushteve të lejes ndërtimit	400,000	-	-	400,000	-	-
20	A. S.	23.12.2024	Shtyrje e afatit të lejes së ndërtimit	200,000	200,000	-	-	Paguar 23.12.2024	-
	Totali			6,800,000	850,000		4,450,000		1,500,000

Burimi: Bashkia Tropojë pregatiti grupi i auditimit

-Në lidhje me ekzekutimin e dënimit me gjobë rezultoi se nga IMTV Tropojë janë marrë gjithsej 20 vendime me gjobë nga 20 kontrole të kryera, me një shumë totale 6,800,000 lekë, nga këto janë arkëtuar 4 vendime në vlerën 850,000 lekë, janë falur 3 vendime në vlerën 1,500,000 për qëllim banimi përkatësisht për subjektet, “Rr. D.”, “A. Z.” dhe “S. S.”. referuar ligjit 127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative”.

Mbeten për të arkëtuar 13 vendime në vlerën 4,450,000 lekë.

-Nga IKMT Drejtoria Rajonale Kukës me anë të shkresave 230,231,299 prot., datë 30.05.2024 i është kërkuar IMT-së Tropojë rimbajtje procedurash për 3 subjekte përkatësisht, “V.” SHPK, “S. S.”, “P. Gj.”, pasi vlera e gjobës vendosur subjektit ka qenë nën kufirin minimal të lejuar nga ligji 10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Ka pasur mangësi në plotësimin e fletës së gjobës, procedura nuk ka qenë e shoqëruar me foto në momentin e inspektimit dhe nuk janë bërë matje.

Rezulton se, përsëri nga IMT Tropojë nuk është shoqëruar procedura me foto dhe matje sipas kërkesës së IKMT Drejtoria Rajonale Kukës. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me, neni 41, Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të kundërvajtjes së konstatuar me foto ose video, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: znj. N. R. në cilësinë e ish-Kryeinspektorit të IMTV Tropojë, z. A. N. në cilësinë e inspektorit të IMTV Tropojë.

- Në 8 raste IMT Bashkia Tropojë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv në vlerën 3,300,000 lekë, për subjektet e mëposhtme:

Tabela Nr.7: Subjektet për të cilat është kërkuar kthimi i gjobave në titull ekzekutiv

Nr.	Procesverbali nr., datë	Vendimi Gjobës	Vlera	Subjekti	Përshkrimi
1	0000021, 04.10.2023	Nr.08, 04.10.2023	200,000	S. N.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 06.05.2025. Në proces.
2	0000002, 26.10.2023	Nr.02, 26.10.2023	100,000	P. B. C. B.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 06.05.2025. Në proces.
3	0000005, 14.11.2023	Nr.05, 14.11.2023	500,000	V. M.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 06.05.2025. Në proces.
4	0000014, 04.06.2024	Nr.09, 04.06.2024	500,000	P. Gj.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 06.05.2025. Në proces.
5	0000013, 04.06.2024	Nr.08, 04.06.2024	500,000	B. B.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 06.05.2025. Në proces.
6	0000015, 04.06.2024	Nr.10, 04.06.2024	500,000	S. S.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 06.05.2025. Në proces.
7	0000023,	Nr.17, 17.12.2024	500,000	Gj. N.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në

	17.12.2024				datën 06.05.2025. Në proces.
8	0000024, 17.12.2024	Nr.18, 17.12.2024	500,000	I. S.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 06.05.2025. Në proces.

Burimi: Bashkia Tropojë pregatiti grupi i auditimit

-Mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Në zbatim të përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, pika a) Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Nga rakordimi i aktivitetit të IMTV me lejet e miratuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tropojë, është konstatuar si më poshtë:

a. Për leje ndërtimi për objektin “Kompleks bujtinë me prespektivë për agroturizëm 2 dhe 1 kat+1 kat nëntokë”, me zhvillues z. B. P. M. me nr. 2336.

- Nga verifikimi i projektit ndërtimor dhe krahasimi i tij me situatën faktike në terren është konstatuar se kemi të bëjmë me devijime të dukshme të projektit pasi në katin përdhe nuk është respektuar lartësia minimale e objektit. Lartësia minimale është 4 metra.

Konkluzion: Nga verifikimi i blloqeve të masave rezulton se, për subjektin “Kompleks bujtinë me prespektivë për agroturizëm 2 dhe 1 kat+1 kat nëntokë”, me zhvillues z. B. P. M. me nr. 2336 nuk është mbajtur asnjë masë administrative nga IMTV Bashkia Tropojë. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me, Neni 5, Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, Neni 52, Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi znj. N. R. me detyrë ish Kryeinspektore, z. A. N. me detyrë Inspektor.

2.6. Të ndryshme të dala gjatë auditimit

-Verifikimi i ankesës së znj. B. M., sipas e mail datë 10.11.2024; administruar në KLSH me nr. 1356 prot; datë 11.11.2024.

Znj. B. M. ka trajtuar shqetësimin në ankesën e saj, referuar tenderit "Meremetimi I Muzeut Historik te qytetit Bajram date 29.04.2024 me nr. REF-01511-04--16-2024, tender i fituar nga firma “O.”, Kukës.

Në projekt dhe në specifikimet teknike është e përcaktuar që mbulesa duhet të jetë me dërrase pishe sakice(Sopate), dhe me dimensionin 3 cm trashësi. Në preventiv zëri i mbulesës së objektit me dërrasë pishe sakice(sopate) mbulon 35% të vlerës totale të preventivit.

Tani vëmë re që gjatë zbatimit të punimeve, nuk po përdoret dërrasat që janë të parashikuar në projekt dhe në specifikimet teknike, gjithashtu dhe punimet e tjera po kryhen jashtë specifikat teknike të para përcaktuara në tender.

Nga verifikimi rezultoi se:

Nga ana Grupit të auditimit të KLSH u kryen verifikime si në dosjen teknike dhe është kryer kontrolli në terren ku u konstatua se: Sipas ankesës së ardhur në Kontrollin e Lartë Të Shtetit se mbulesa e çatisë së Muzeut Historik të qytetit Bajram Curri është kryer me dimensione më të vogla se parashikimet në projekt preventiv pra më të vogla se 3cm dhe se 25 cm.

Pretendimet e ngritura nuk qëndrojnë tërësisht pasi gjithë mbulesa e çatisë së Muzeut Historik të qytetit Bajram Curri ishte realizuar me dërrasë pishe me përmasa 70 cm x 15cm x 3cm. Vetëm njëra nga përmasat e dërrasës ishte realizuar me dimensione më të vogla në gjerësi nga 25 cm në 15 cm, por kjo gjë nuk ndikon në mbulimin e çatisë pasi e gjithë sipërfaqja rezulton e mbuluar. Ndërsa në lidhje me pretendimet që copat e mbulesës duhet të jenë të prera me sëpatë u konstatua se copat e dërrasës ishin të prera me makineri. Për këtë shkelje mban

përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve OE “V. E.” përfaqësuar nga Z. M. Sh. i cili ka lejuar përdorimin dhe miratimin e materialit jo sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST.



Konkluzion: Nga subjekti nuk janë respektuar në mënyrë korrekte përmasat e kërkuara në Specifikimet Teknike të DST të dërrasave për mbulimin e çatisë pasi, nga përmasat 70cm x 25cm x 3cm e përcaktuara për mbulim janë përdorur pllake pishë me përmasat 70cm x 15cm x 3cm, si dhe dërrasat janë prerë në sharrë e jo me sëpatë si është parashikuar në DST. Konstatohet se e gjithë sipërfaqja e çatisë rezulton e mbuluar dhe nuk janë konstatuar probleme teknike.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 5 procedurave të prokurimit të përzgjedhura për vitin 2023, rezultoi se në 3 raste me fond limit prej 117,540,836 lekë konkretisht: “Sistemim asfaltim Rruga: Bukovë-Nigegaj-Qendër Luzhë” shpallur fitues OE “Sh.” ShPK me ofertë 23,266,167.8lekë pa TVSh; “Rikonstruksion i Rrugës Fshati Kasaj” shpallur fitues OE “N.” ShPK me ofertë 57,519,605.4 lekë pa TVSh; “Shërbime rrugësh, mbushje gropash me asfalt, Bashkia Tropojë” shpallur fitues BOE “V. & G.” ofertë 5,580,765 lekë pa TVSh. Burimi i financimit: janë të ardhurat e Bashkisë Tropojë, vlera e pritshme kontratës së punimeve do të shlyet në periudhën e 2 ose 3 viteve, miratuar edhe me Vendim të Këshillit Bashkiak. Kontratat e lidhura me OE shpallur fitues në vlerë 86,366,537 lekë, afatin e realizimit të kontratës është nga 1 muaj deri në 12 muaj dhe sipas nenit 3 të kontratës shlyerja e detyrimit bëhet me përfundimin e punimeve. Për sa më lart në lidhje me financimin e kontratës është vepruar në kundërshtim me nenin 85 pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 29-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Tropojë në prokurimin e fondeve të marrë masa, që për rastet kur financimi parashikohet të realizohet në më shumë se një vit buxhetor, përpara shpalljes së fituesit dhe lidhjes së kontratave, të përcaktojë në kontratë një nen të

posaçëm ku të specifikohet qartë mënyra e financimit dhe pagesës, përfshirë pagesat me këste, afatet përkatëse, si dhe lidhja e tyre me planin buxhetor/vjetor apo afatmesëm të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 11 procedurave të prokurimit të përzgjedhura, u konstatuan mangësi sa i takon hartimit të kriterëve të kualifikimit dhe konkretisht:

- aplikimi në mënyrë të gabuar i masës së vlerës për paraqitjen e punëve të ngjashme, në të gjitha rastet,

- në 2 raste për procedurat e prokurimit “Blerje dru Zjarri 2023” Oferta fituese: OE “L. AL. ”, me vlerë 4,370,000 lekë pa TVSh; “Blerje dru Zjarri 2024” Oferta fituese: OE “L. AL. ”, me vlerë 4,500,410 lekë pa TVSh, vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, nuk përputhet me natyrën dhe volumin e punës të prokuruar,

- në 1 rast për procedurën e prokurimit “Rehabilitimi i Rrugës Lagjia Hysenukaj ” Oferta fituese: BOE “V. & G. ”, me vlerë 1,755,450 lekë pa TVSh, kërkesa për disponimin e mjeteve nuk argumentohet se mbulon të gjithë zërat e punimeve lidhur për objektin që prokurohet.

- në 1 rast, procedura e prokurimit “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare “Besëlidhja e Malësisë” me Oferta fituese: OE “M./S & N. ” me ofertë 55,277,700.44 lekë pa TVSh, kërkesa për posedimi i certifikatave ISO është e pa azhurnuar pasi OE duhet të disponojnë/paraqesin edhe certifikatën për standardin e përditësuar (ISO 45001-2023)

- në 1 rast procedura e prokurimit “Rikonstruksion i Kanaleve Vaditëse Ura Vigi i Vakës-Cerrnicë” me Oferta fituese: OE “G. ” me vlerë 26,999,633.44 lekë pa TVSh, vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit, nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, janë kërkesa në mospërputhje pasi për punimet sipas licencës NP.1A nuk është kërkuar që OE të disponojë drejtues teknik Inxhinier Ndërtimi, kërkesë e zërave të punimeve përcaktuar në zërin e licencës.

- në 1 rast procedura e prokurimit “Rehabilitimi i Ujëmbledhësit Zherka 1-2” Oferta fituese: OE “A. In. ” ShPK me vlerë 8,090,904 lekë pa TVSh, vendosja e kriterëve të Licencës në kategorinë NS-18 A kjo e përcaktuar edhe nga karakteristikat dhe llojin e punimeve të parashikuara në preventiv nuk ishte shoqëruar edhe me disponimin e Inxhinier Topograf (ose gjeodet).

- në 1 rast procedura e prokurimit “Rehabilitimi i Ujëmbledhësit Radogosh” Oferta fituese: OE “H. ” ShPK me vlerë 2,775,235 lekë pa TVSh, vendosja e kriterëve për disponimin e 3 tre punëtorë (specialistë dhe të thjeshtë) nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, nuk është e përcaktuar qartë ndarja midis punëtorëve të thjeshtë ose punëtorëve specialistë për të mundësuar një konkurrencë të drejtë dhe deklaram sa me real të disponibiliteteve të pjesëmarrësve në konkurrim. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 2 dhe 77 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 2, 39, 43 dhe 55. (Më hollësisht trajtuar në faqet 29-82 të Raport Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Njësia e prokurimit e Bashkisë Tropojë, gjatë përcaktimit të kriterëve të kualifikimit, të marrë masa që ato të mos kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, duke argumentuar kërkesat jo vetëm në funksion të objektit të prokurimit, por edhe sipas zërave të preventivit dhe specifikimit përkatës nga ekspertët e fushës rast pas rasti.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit me vlera të vogla me objekt “Riparim tubacionesh për vitin 2023” Bashkia Tropojë, duke

përfshirë dosjen fizike të prokurimit, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e disponueshme në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), u konstatua:

-Titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim. Konstatohet se nuk është mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim si dhe nuk është dokumentuar me foto dhe dokumente të tjerë vërtetues kryerja e procedurës së marrjes në dorëzim. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, pika 35 “Dokumentimi i Lëvizjes së aktiveve”, pika 42 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

-Referuar faturës së lëshuar e cila në këtë rast ka vlerën e kontratës, OE “O. H.” nuk ka respektuar grafikun i punimeve sipas kërkesave në dokumentet të tenderit ku parashikohet si afat 1 muaj për realizimin e procedurës. Veprime në kundërshtim me Kreu II i Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 1, pika 2 dhe Neni 4, pika 14 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu 3.10 i Udhëzimit Nr.7, datë 30.07.2021 i APP “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”.

-Nga AK nuk është vendosur si kriter kualifikues fuqia punëtore dhe mjete pune duke qenë se, procedura e prokurimit është “Furnizim Vendosi”. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe neni 78, pika 2 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 29-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Nga Titullari i Bashkisë Tropojë të merren masa që, për çdo procedurë prokurimi të nxirret urdhër për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim edhe për procedurat e prokurimit me mjete elektronike për punë, mallra dhe shërbime.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurat e prokurimit, për procedurën me objekt: “**Blerje beton për urën Kojel-Shumicë**”, procedurën e prokurimit me objekt: “**Blerje goma të makinerive**”, procedurën me objekt: “**Shërbim për mirëmbajtje automjetesh për Bashkinë Tropojë**”, duke përfshirë dosjen fizike të prokurimit, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e disponueshme në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), u konstatua:

-Nga komisioni për blerjet e vogla nuk janë mbajtur në procesverbal treguesit e çmimeve për përcaktimin e fondit limit. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me neni 76, pika 2 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pika 7, Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 i APP “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

-Nga komisioni për blerjet e vogla nuk është mbajtur një procesverbal ku të argumentohen specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për këtë procedurë. Veprime në kundërshtim me pikën 11, Udhëzimi nr.5, datë 25.06.2021 i APP “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

-Nga AK është vendosur në DST si kriter kualifikues “Afati i lëvrimit të mallit do të jetë 24 orë, duke filluar nga momenti i publikimit në Sistemin Elektronik të njoftimit të fituesit”. Ky kriter nuk është argumentuar dhe ka qenë penalizues për operatorët ekonomikë që janë shpallur fitues, duke i detyruar të tërhiqen nga kjo procedurë për arsye të pamjaftueshmërisë së kohës për realizimin e saj. Veprime në kundërshtim me pikën 1,2 c, neni 2 “Dokumentimi i procesit”, neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 29-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Komisioni për blerjet e vogla Bashkia Tropojë për çdo procedurë prokurimi duhet të listojë treguesit e çmimeve në përcaktimin e fondit limit. Komisioni për blerjet e vogla të marrë masa që hartimi i kriterëve të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht dhe sipas udhëzimeve të APP.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “**Rikonstruksion i sinjalistikës horizontale të qytetit faza-1**”, Bashkia Tropojë duke përfshirë dosjen fizike të prokurimit, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e disponueshme në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

Nga Komisioni për Blerjet e Vogla nuk është mbajtur një procesverbal ku të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht vendosja e specifikimeve teknike.

-Nga evidencat e marra nga auditimi rezulton se, Ing.E. M. dhe Tek.M. V. nuk janë të pajisur me licencën e projektimit. Veprime në kundërshtim me Neni 78, pika 2 i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 29-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Bashkia Tropojë të marrë masa që në të ardhmen për çdo projekt zbatimi, të hartohen nga Inxhinierë të pajisur me licencën përkatëse për projektim, ose në mungesë të inxhinierëve të licencuar, projektet e zbatimit t’i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik, duke siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i prokurimeve me vlerë të vogël u konstatua se Autoriteti Kontraktor Bashkia Tropojë, në vitin 2023 ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, konkretisht: Për procedurën me objekt: “Blerje çimento për urën Kuçan” me vlerë 891,000 lekë pa TVSH dhe për procedurën me objekt: “Blerje çimento për urën rruga Sylbicë” me vlerë 1,000,000 lekë pa TVSH, duke u nisur nga ngjashmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokurorëshin bashkë nëpërmjet procedurës “E hapur e thjeshtuar”. Për sa konstatuar, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 56, pika 2. Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 “Për blerjet e vogla”, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 29-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Autoriteti Kontraktor i Bashkisë Tropojë të marrë masa që në regjistrin e parashikimeve të bëhen përcaktime të sakta, që mallrat apo shërbimet me natyrë të njëjtë nuk duhet të prokurorohen veçmas, në mënyrë që të shmanget copëzimi i fondit të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit të Sektorit të Pronave në Bashkinë Tropojë rezulton se nuk ka regjistër me të dhënat dhe modalitetet për secilën pronë të paluajtshme shtetërore. Për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë. Gjatë vitit 2024, nga titullari i Bashkia Tropojë nuk janë ngritur grupe pune për administrimin dhe monitorimin e aseteve. Përgjatë vitit 2024, Sektori i Pronave dhe Hartografisë si dhe Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Tropojë nuk kanë certifikuar asnjë pronë, si dhe nuk kanë aplikuar në DVASHK Kukës për regjistrim të aseteve të bashkisë.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” neni 17 “Afatet dhe procedurat

e transferimit”, neni 18 “Dokumentacioni i transferimit”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18, 22, Ligji nr.2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 82-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Tropojë duhet të ngrejë një grup pune për verifikimin në terren dhe përditësimin e statusit të të gjithë asetëve që kjo Bashki ka në administrim, së bashku me njësitë administrative. Grupi i punës duhet të përditësojë listën e inventarit dhe ta nisi për miratim në organet përkatëse. Në vijimësi për çdo aset të përfshirë në listën e inventarit, duhet të aplikohet pranë DVASHK Kukës për marrjen e certifikatës së pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit të kontratave të qirasë lidhur nga Bashkia Tropojë gjatë vitit rezulton se nuk është ngritur njësia e monitorimit të kontratave të qirasë, e cila pas lidhjes së kontratës bën dorëzimin të qiramarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Gjithashtu konstatohet se, nuk është mbajtur procesverbal për dorëzimin e ngastrave subjektit qiramarrës. Veprime dhe mos veprime në kundërshtim me, Kreu VI. “Monitorimi i kontratave” i VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.1 i MTM, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 18. (Më hollësisht trajtuar në faqet 82-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandim: Titullari i Bashkia Tropojë të ngrejë një grup pune për monitorimin e kontratave të qirave që administrohen nga kjo bashki dhe njësitë administrative. Grupi i punës duhet të raportojë për monitorimin e të gjithë kontratave ekzistuese.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se dy raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4, datë 27/06/2023, për objektin **“Kompleks bujtinë me prespektivë agroturizëm 2 dhe 1 kat + 1 kat nëntokë”**, me adresë në fshatin Plaç, Bashkia Tropojë, me zhvillues B. P. M. me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon studimi gjeologjiko-inxhinierik dhe studimi sizmiko-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesve, vërtetim i NIPT-it), veprime këto jo në përputhje me VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi;

- Zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin “Njoftim për fillimin e punimeve”. “Njoftimi për fillimin e punimeve” është dokumenti që jepet pas marrjes së sigurisë se zhvilluesi ka plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe kushtet e nevojshme për të filluar punimet. Gjithashtu, ky dokument shënon datën e saktë të fillimit të punimeve, referuar së cilës llogaritet respektimi ose jo i grafikut të punimeve dhe afatit të përfundimit të punimeve. Duke iu referuar pikës 8 të dokumentit të lejes së ndërtimit, si dhe nenit 40 të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, pika 1, afati për fillimin e punimeve është një vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit;

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë, plani i piketimit të strukturës; plani organizimeve të punimeve dhe plani i mbulimit me kuotat përkatëse në plan dhe kuotat në parapete dhe mbi elementet teknike si dhe ne kullime veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1/1;
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DWG, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç).
- Mungon deklarata e përgjegjësive profesionale e inxhinierit që ka hartuar projektin e mbrojtjes ndaj zjarrit (znj. M. Sh.), kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1;
- Mungon licenca individuale e hartuesit të projektit për mbrojtjen ndaj zjarrit (znj. M. Sh.), veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);
- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë, instalimet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe detajet e montimit të sistemit rrufe-prites veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1/1, nënpika iii);

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1, datë 27/11/2024, për objektin **“Argo turizëm me strukturë akomodimin dhe shërbim 1 dhe 2 kat dhe me aktivitet rekreativ”**, me adresë në fshatin Buçaj, Bashkia Tropojë, me zhvillues A. Ç. K. me problematika si më poshtë vijon:

Mungon studimi gjeologo - inxhinierik dhe studimi sizmiko-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale, licenca individuale e hartuesve, vërtetim i NIPT-it), veprime këto jo në përputhje me VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”;

- Mungon projekti arkitektonik në formatin DWG, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç);

- **Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tej zgjatura prej 84 ditësh pune**, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore të nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, si dhe nenin 44 të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në faqet 91-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Tropojë, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, të shqyrtojnë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në një rast, objekti i miratuara nuk respekton kondicionet urbane, siç është lartësia minimale dysheme -dysheme e lejuar për përdorim shërbimi. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastin e mëposhtëm:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4, datë 27/06/2023, për objektin **“Kompleks bujtinë me prespektivë agroturizëm 2 dhe 1 kat + 1 kat nëntokë”**, me adresë në fshatin Plaç, Bashkia Tropojë, me zhvillues B. P. M. me problematika si më poshtë vijon:

- **Objekti nuk respekton lartësinë maksimale.** Sipas përcaktimeve në nenin 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.04.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i

ndryshuar, pika 3, nënpika c), ku përcaktohet se: *Kati për përdorim shërbimi, lartësia minimale dysHEME–dysHEME është 4.00 m..*”, shprehem se objekti nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar në dy raste, DPZHT ka miratuar dy objekte me lartësi 3.4m restoranti dhe 3.78m spa. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 91-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit, Bashkia Tropojë, të merren të gjitha masat për të miratuar vetëm ato aplikime për pajisje me leje ndërtimi të cilat respektojnë kondicionet urbane sipas parashikimeve ligjore, si janë lartësia maksimale dysHEME-dysHEME e lejuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Tropojë, jo gjithmonë ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, pika 6, DPZH ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Gjithashtu, në dispozitat nënligjore të sipërcituara, specifikohet gjithashtu se informacioni, që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4, datë 27/06/2023, për objektin **“Kompleks bujtinë me prespektivë agroturizëm 2 dhe 1 kat + 1 kat nëntokë”**, me adresë në fshatin Plaç, Bashkia Tropojë, me zhvillues B. P. M. me problematika si më poshtë vijon:

- Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, pika 6, DPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se:

- Leja e ndërtimit është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DVASHK edhe pse në dispozitat rregullatorë të sipërcituara shprehet qartësisht se informacioni, që mundësojnë DVASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1, datë 27/11/2024, për objektin **“Agroturizëm me struktur akomodimin dhe shërbim 1 dhe 2 kat dhe me aktivitet rekreativ”**, me adresë në fshatin Buçaj, Bashkia Tropojë, me zhvillues A. Ç. K. me problematika si më poshtë vijon:

- Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, pika 6, DPZH ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se:

- Leja e ndërtimit është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DVASHK edhe pse në dispozitat rregullatorë të sipërcituara shprehet qartësisht se informacioni, që mundësojnë DVASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 91-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Tropojë, të merren të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në dy raste, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Tropojë ka miratuar leje ndërtimi në njësi strukturore në të cilat nuk lejohet të ndërtohen. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtëm:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4, datë 27/06/2023, për objektin **“Kompleks bujtinë me prespektivë agroturizëm 2 dhe 1 kat + 1 kat nëntokë”**, me adresë në fshatin Plaç, Bashkia Tropojë, me zhvillues B. P. M. me problematika si më poshtë vijon:

- Bashkia Tropojë ka miratuar ndërtimin e një objekti në tre njësi strukturore ku nuk është i lejuar ndërtimi i kësaj tipologjie. Objekti i miratuar është një strukturë agroturistike. Njësitë strukturore në të cilën është menduar të zhvillohet objekti janë: N1-520, me të dhëna si vijon: i. Sistemi: *N-Natyror*; ii. Kategori 1: *N. Natyre 100%*; iii. Përdorime të lejuara: *Shtigje rekreative me biçikletë; Shtigje për këmbësorët; Aktivitete rekreative*; iv. Përdorime të ndaluara: *Të gjitha të tjerat*. B1-567, me të dhëna si vijon: i. Sistemi: *B-Bujqësor*; ii. Kategori 1: *B. Bujqësi 100%*; iii. Përdorime të lejuara: *Tokë bujqësore e kultivuar; sipërfaqe bujqësore; Kullotë; Struktura bujqësore ndihmëse; Aktivitete bujqësore mbështetëse*; iv. Përdorime të ndaluara: *Të gjitha të tjerat*. B3-138, me të dhëna si vijon: i. Sistemi: *B-Bujqësor*; ii. Kategori 1: *B. Bujqësi 100%*; iii. Përdorime të lejuara: *Sipërfaqe Agro-Pyjore; Struktura bujqësore ndihmëse; Aktivitete bujqësore mbështetëse*; iv. Përdorime të ndaluara: *Të gjitha të tjerat*.

Siç konstatohet, ndërtimi i strukturave agroturistike nuk është i lejuar në këto njësi strukturore. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, gërma c), ç) dhe nenin 12 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Tropojë, pika 1 dhe 2.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1, datë 27/11/2024, për objektin **“Agroturizëm me struktur akomodimin dhe shërbim 1 dhe 2 kat dhe me aktivitet rekreativ”**, me adresë në fshatin Buçaj, Bashkia Tropojë, me zhvillues A. Ç. K. me problematika si më poshtë vijon:

- **1. Bashkia Tropojë ka miratuar ndërtimin e një objekti në një njësi strukturore ku nuk është i lejuar ndërtimi i kësaj tipologjie.** Objekti i miratuar është një strukturë agroturistike. Njësi strukturore në të cilën është menduar të zhvillohet objekti është **N1-444**, me të dhëna si vijon: **i.** Sistemi: *N-Natyror*; **ii.** Kategori 1: *N. Natyrë 100%*; **iii.** Përdorime të lejuara: *Shtigje rekreative me biçikletë; Shtigje për këmbësorët; Aktivitete rekreative*; **iv.** Përdorime të ndaluara: *Të gjitha të tjerat*. Siç konstatohet, ndërtimi i strukturave agroturistike nuk është i lejuar në këto njësi strukturore. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, nënpika c), ç) dhe nenin 12 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Tropojë, pika 1 dhe 2. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 91-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit, Bashkia Tropojë, të merren të gjitha masat për të respektuar të gjitha kufizimet ligjore që janë vendosur në njësit strukturore, kufizime të cilat duhet të jenë të padiskutueshme. Të miratoj vetëm ato leje të cilat përmbushin kriteret që janë të lejuara në njësinë strukturore përkatëse.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur nga Kryeinspektori i IMT Tropojë, blloqet e vendimit të prishjes u konstatua se, nga 20 raste gjithsej **në 8 raste**, Nga Kryeinspektori i IMT Tropojë nuk është vijuar për Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishje, vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Tropojë. **Në 7 raste**, nga Kryeinspektori i IMT nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditore për nxjerrjen

e vendimit për “Prishje e Objektivit të Kundërligjshëm“ në kundërshtim me nenin 5 pika “d“ dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. Më konkretisht:

1. Subjekti F. B, Vendim për prishje datë 15.12.2023 (ka kryer punime hapje, gërmim dhe rrethim të pronës publike pa dokumentacion tekniko-ligjor).
2. Subjekti Shoqëria “A. E.” SHPK, Vendim për prishje datë 18.12.2023 (ka kryer punime për ndërtim HEC dhe vendosje tubacionesh pa dokumentacion tekniko-ligjor).
3. Subjekti S. S, Vendim për prishje datë 13.02.2024 (ka ndërtuar dy Bujtina druri pa dokumentacion tekniko-ligjor).
4. Subjekti P. Gj, Vendim për prishje datë 11.03.2024 (ka ndërtuar mur me derdhje betoni pa dokumentacion tekniko-ligjor).
5. Subjekti “V.” SHPK, Vendim për prishje datë 21.06.2024 (ka kryer shkelje të lejes ndërtimit në shtesa dhe vëllim ndërtimor).
6. Subjekti S. S, Vendim për prishje datë 18.11.2024 (ka ndërtuar vendstrehim për bagëti pa dokumentacion tekniko-ligjor).
7. Subjekti A. Z, Vendim për prishje datë 19.11.2024 (ka ndërtuar mur rrethues dhe zaptim i hapësirës publike pa dokumentacion tekniko-ligjor).
8. Subjekti Gj. N, Vendim për prishje datë 30.12.2024 (ka hapur themele dhe ngritur kollona pa dokumentacion tekniko-ligjor). *(Më hollësisht trajtuar në faqet 102-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1 Rekomandim: Kryeinspektori IMT-së Bashkia Tropojë, të vijojë Ekzekutimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, për subjekte F. B.; “A. E.” Shpk; S. S.; P. Gj.; “V.” Shpk; S. S.; A. Z.; Gj. N, që janë me Vendim për “Prishje Objekti të Kundërligjshëm”.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur nga Kryeinspektori i IMT në **2 raste**, nuk është vijuar procedura me nxjerrjen e vendimit për “Pezullimin e Punimeve” konkretisht Subjekti F. B. dhe Subjekti Gj. N, në kundërshtim me nenin 5 pika “ç“ dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 114-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1 Rekomandim: Kryeinspektori IMT-së Bashkia Tropojë, në çdo rast të konstatimit të ndërtimeve pa dokumentacion tekniko ligjor të nxjerrë menjëherë Urdhër për pezullimin e punimeve të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur nga Kryeinspektori i IMT në **5 raste**, për subjektet “4 A.”, S. N, V. M, Rr. D. dhe I. S. – nga procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektorët në terren, Kryeinspektori i IMT-së nuk ka vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm”, nuk është bërë kallëzim penal për subjekte që kanë kryer ndërtime informale pa leje ndërtimi, veprime në kundërshtim me nenin 5 pika “d”, “dh”, si dhe nenin 13, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar si dhe pika 7 e nenit 52 i Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 102-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1 Rekomandim: Kryeinspektori i IMT Bashkia Tropojë, në vijimësi të nxjerrë Vendim për prishjen e objekteve të kundërligjshëm brenda afatit 10 ditor nga data e mbajtjes së akt konstatimeve dhe në të gjitha rastet kur konstatohen punime pa leje ndërtimi për banesa apo njësi shërbimi, të referohen me kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga IMT gjatë viteve 2023-2024, në 20 raste nga 20 kontrole të kryera, kundërvajtja e konstatuar nga IMTV Tropojë nuk është dokumentuar me fotografi ose video si dhe nuk është hapur dosje individuale për secilën praktikë apo subjekt. Në kundërshtim me, neni 41, Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të kundërvajtjes së konstatuar me foto ose video, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.

-Kryeinspektori IMTV Tropojë ka përdorur fletë të fotokopjuara për nxjerrjen e vendimeve për “Dënim me gjobë” dhe “Prishje të objektit të kundërligjshëm” deri më 26.10.2023, duke pretenduar se nuk ka pasur blloqe në formatin zyrtar për mbajtjen e këtyre vendimeve. Veprime në kundërshtim me pika 6,7 të VKM nr.894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësive vendore”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 102-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandim: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Tropojë të marrë masa të menjëhershme që për çdo subjekt të konstatuar në shkelje të krijojë dosje personale dhe shkeljet të dokumentohen me foto dhe video si dhe dokumente të tjera vërtetuese. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Tropojë të marrë masa të menjëhershme që të pajiset me blloqet zyrtare për mbajtjen e konstatimeve sipas standarteve kombëtare.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacioni të lejeve të ndërtimit dhe dokumentacionit të konstatimit për ndërtimet pa leje apo në shkelje të lejes së ndërtimit rezulton se, subjekti “Kompleks bujtinë me perspektivë për agroturizëm 2 dhe 1 kat+1 kat nëntokë”, me zhvillues z. B. P. M, i konstatuar në shkelje të lejes së ndërtimit nuk është mbajtur asnjë masë administrative nga IMTV Bashkia Tropojë. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me, Neni 5, Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, Neni 52, Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 102-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandim: Kryeinspektori i IMT Bashkia Tropojë, të kryejë kontrolloje në subjektin “Kompleks bujtinë me perspektivë për agroturizëm 2 dhe 1 kat+1 kat nëntokë”, me zhvillues z. B. P. M. duke marrë dhe masa administrative sipas rastit.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, geramat b) dhe c) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësive publike Bashkisë Tropojë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësisht, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **5,583,541 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me objektin “Rikonstruksion i rrugës së fshatit “Kasaj”

sipas kontratës me nr.2319 prot., datë 04.05.2023, lidhur midis AK Bashkisë Tropojë dhe Kontraktorit OE "N."shpk. Vlera e kontratës është 69,023,526.48 lekë me Tvsh. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj dhe punimet janë zbatuar në 12 muaj. Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm rezultuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës në kapitullin 1 Punime dherash prishje dhe riparime me nr analize An.164/1b "Mbushje me çakëll e gurë gurorë në trupin e rrugës përhapur e ngjeshur me makineri për nivelet" i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 529.5m³ në vlerën 529,500 lekë; konstatohet se ky zë pune nuk është i justifikuar me vizatime dhe detaje se ku është përdorur. Referuar librezave të masave ky zë pune është raportuar në të njëjtat progresiva që janë raportuar gërmimet në pjesën e trupit të rrugës, pra nuk mund të kemi si gërmime dhe mbushje në të njëjtat progresiva. Vlera e përfutur padrejtësisht nga ana e Kontraktorit **529,500 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik.** -Në lidhje me zërin e punës në kapitullin 4 Vepra të vogla arti me nr analize 3.366 "Tombino me tuba betoni, mbi shtresë betoni" i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 63.8ml në vlerën 638,000 lekë, u konstatua se në terren gjatësia totale e tombinove ishte 58.9 ml, pra më e vogël sesa është raportuar kjo diferencë përbën vlerën **49,000 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.** -Gjithashtu në lidhje më këtë zë pune u konstatua se në terren tombinot ishin realizuar me Ø600 dhe jo me Ø800 siç është parashikuar në preventivin e punimeve. Sipas portalit të çmimeve dhe historikut të tij, ky zë pune në periudhën e firmosjes së situacionin përfundimtar rezulton në vlerën 5,858.19 lekë/ml, pra ka një diferencë midis çmimit të fituar në tender 10,000 lekë/ml me çmimin me të cilin duhet të ishte korrigjuar preventive sipas punimeve faktike 5,858.19 lekë/ml. Vlerës 638,000 lekë duhet ti zbresim vlerën 63.8mlx5,858.19 lekë/ml=373,753 lekë. Diferenca në vlerën 638,000 lekë -373,753 lekë = **264,247 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik.** -Në lidhje me zërin e punës në kapitullin 4 Vepra të vogla arti me nr analize 3.24 *Struktura monolite betoni me çakëll c12/15 shtresa*" i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 14.23m³ në vlerën 113,840 lekë, u konstatua se në terren tombinot nuk ishin realizuar me shtresë beton sipas përcaktimit në preventiv. Rrjedhimisht vlera **113,840 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik.** Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën **956,587.5 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "M.A. P." shpk, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". (Më hollësisht trajtuar në faqet 57-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **956,587 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria OE "N." ShPK.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me objektin "Rikonstruksion i shkollës 9-Vjeçare Besëlidhja e Malësisë" sipas kontratës me nr. 3888 prot., datë 26.09.2024, lidhur midis AK Bashkisë Tropojë dhe Kontraktorit BOE "M./S".shpk & "N."shpk. Vlera e kontratës është 66,333,240.44 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 9 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm

rezultuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit, projekt-preventivit të rishikuar si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “2.426/12 *“Prishje suvatim solete ($h < 4m$)”* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2,923 m², gjatë kontrollit të punimeve në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte realizuar pasi në një pjesë të madhe të klasave u vu re se nuk ishte ndërhyrë në prishjen e suvatimeve të soletës. Gjithashtu tek fotografitë e dosjes tekniko ligjore si dhe fotografi të gjetura në rrjetet sociale vihet re se nuk janë kryer prishjet e suvatimit. Sipas ligjit të mbikëqyrjes së punimeve çdo proces pune në lidhje me punimet e maskuara duhet të jetë i shoqëruar me fotografi. Referuar situacionit përfundimtar konstatohet se kjo sasi 2,923 m² nuk përputhet as edhe me sasinë e raportuar për suvatimet e soletës 2,513 m². Rrjedhimisht volumi i raportuar prej 2,923 m² në vlerën **1,169,560 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “2.37/2a-*Transport mat. ndërtimi me auto deri 2km*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 327.7 m³, gjatë kontrollit të librezave të masave u vu re se në llogaritjen e këtyre volumeve janë futur disa zëra pune të cilat e kanë transportin të përfshirë në analizën e çmimit, rrjedhimisht sasia prej 213.9 m³ përbën dëm ekonomik i cili shkon në vlerën **32,085 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “2.326 *Veshje me pllakë majolike*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 524.9m², gjatë kontrollit në terren u konstatua se veshja e pllakave në tualete ishte realizuar në lartësinë 1.8m, ndërsa në librezat e masave kjo lartësi ishte llogaritur në mënyrë të gabuar me lartësinë 2m. Rrjedhimisht rezultuan diferenca në sasinë 71.96m² e cila përbën vlerën **158,312 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “2.196/b-*Hidroizolim me një shtresë astar me bazë çimento. Përgatitur nga dy komponentë A+B*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 510.7m². Gjatë kontrollit të librezave të masave rezultuan diferenca në volume në sasinë 230.72 m² e cila përbën vlerën **149,968 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “2.386/2-*Dyer të blinduara importi*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 11.3m². Gjatë kontrollit në terren dhe librezave të masave rezultuan diferenca në volume në sasinë 4.3 m² e cila përbën vlerën **150,500 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “2.465-F.V. *Ndriçues tip plafoniere, emergjence, 1x18w, IP65*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 26 copë. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se nuk ishin vendosur ndriçues emergjence, vlera e tyre është përftuar padrejtësisht në situacionin përfundimtar në **vlerën 62,400 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “2.490/g *F.V Kasetë plastike KE me 48 modular (vende)*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 4 copë. Gjatë kontrollit në terren u konstatua kasetat plastike të automatëve ishin vendosur të tipit 24 modular pra më të vogla sesa preventivi i tenderuar duke pamundësuar Autoritetin Kontraktor për të shtuar automat të tjerë në rast nevojë. Vlera e tyre është përftuar padrejtësisht në situacionin përfundimtar në **vlerën 19,600 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “*Pompa Riqarkulluese 65 PN 10 Temp. Punuese (-10..+120 °C) Presioni Nominal - max. 10 bar Lidhja e tubacionit: DN 65/PN10*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2 copë. Sipas preventivit janë parashikuar 2 pompa PN 65 dhe 1 pompë PN40 gjatë kontrollit në terren u konstatua ishin vendosur vetëm 2 pompa nga 3 të parashikuara. Rrjedhimisht vlera e pompës së gjetur në mangësi prej **90,000 lekë pa TVSH, përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës “2.375/1 *F V dritare d/alumini plastike me dopio xham*” i

raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 290m², gjatë kontrollit në terren dhe librezave të masave u konstatua se ishin përfshirë në mënyrë të gabuar nga një dritare tualetesh shtesë për të dy faqet anësore të objektit dhe për çdo kat. Sasia e dritareve llogaritet 4.48 m² e cila përbën vlerën **51,577.5 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës “*Shtresë betoni me stampim, me ngjyrë*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 846.1m², gjatë kontrollit në terren dhe librezave të masave u konstatua kjo sasi nuk është llogaritur në mënyrë të saktë referuar matjeve faktike. Sipas matjeve sipërfaqja e betonit të stampuar është 585.4 m². Diferenca midis volumeve të raportuara dhe atyre faktike shkon në vlerën **646,498.8 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “2.239/a Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2,436.8 m², gjatë kontrollit të fotografive të dosjes tekniko ligjore vihet re se ky zë pune nuk është kryer në mënyrë korrekte pasi në korridore janë vendosur copa polisteroli në mënyrë jo të çrregullt dhe të përzierë me tuba dhe rërë (ref fotografisë në akt konstatimi). Ndërkohë që sipas preventivit të punimeve duhet të ishte kryer në fillim mbulimi i tubave dhe linjave sipas zërit rërë për nivelizim, pastaj duhej të realizohej shtresa e termoizolimit me polisterol. Për korridoret kryejmë zbritjet në sasinë 451.7 m² sasi e cila përbën vlerën **451,680 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës “2.404 *Bojë hidroplastike*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 10,747.3 m², gjatë kontrollit të librezave të masave dhe gjatë kontrollit në terren u matën lartësitë e kateve Hk0=3.1m, Hk1=3.2m, Hk2=3.6m, Hk3=3.1m, ku u konstatua se në librezat e masave këto lartësi janë raportuar më të mëdha sesa fakti. Për rrjedhim rezultuan diferenca në sasinë 480.46m² sasi e cila përbën vlerën **69,438 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën 3,051,619 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve **BOE PF D. Ll. & “A. MK” shpk**, Për sa më sipër, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”. (*Më hollësisht trajtuar në faqet 57-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, masa për arkëtimin e vlerës **3,051,619 lekë pa TVSh** për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria BOE “*M./S*”.shpk & “*N.*” Shpk.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me objektin “*Rikonstruksion sistemim asfaltim rruga Bukovë-Qendër Luzhë*”, sipas kontratës nr.2319 prot., datë 04.05.2023, lidhur midis AK Bashkisë Tropojë dhe Kontraktorit OE “*Sh.*”shpk. Vlera e kontratës është 27,919,401.3 lekë me TVSH -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj ose 180 ditë. Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm rezultuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “3.An-9 *Mbushje me zhavorr pas mureve*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 157.3m³ dhe në vlerën 163,120 lekë, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte realizuar. Rrjedhimisht vlera **163,120 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “3.212/c *Shtresë stabilizant t = 15 cm për trupin e*

rrugës”, i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 5,901m² dhe në vlerën 2,065,350 lekë, gjatë kontrollit të dokumentacionit si dhe kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune është raportuar në mënyrë të gabuar në sasinë 5901m², ndërkohë që duhet të ishte raportuar i barabartë me sasinë e shtresës së binderit 4836.6m². Diferenca midis sasisë së raportuar me sasinë e llogaritur $5,901m^2 - 4,836.6m^2 = 1,064 m^2$ që përbën vlerën **425,760 lekë pa TVSH, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit, kjo vlerë përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “3.366-Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtresë betoni” në sasinë 31ml dhe në vlerën 303,769 lekë, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune ishte realizuar në sasinë 28.6 ml. Diferenca prej 2.4ml përbën vlerën **23,517.6 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën 612,398 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

-Mbikëqyrësi i punimeve OE “M. Ch.”shpk &P.F “B. Y.” në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 57-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, masa për arkëtimin e vlerës **778,512 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria OE “Sh.” ShPK.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me objektin “Sistemim asfaltim i lagjes Dardania”, sipas kontratës me nr. 1215 prot., datë 24.20.2023, lidhur midis AK Bashkisë Tropojë dhe Kontraktorit OE “Z.”shpk. Vlera e kontratës është 32,423,422 lekë me TVSH -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj ose 180 ditë. Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm rezultuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “3.212/b Shtresë stabilizant $t = 10$ cm për trupin e rrugës”, i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 5,780.6m² dhe në vlerën 1,271,732 lekë, gjatë kontrollit të dokumentacionit si dhe kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune është raportuar në mënyrë të gabuar në sasinë 5,780.6m², ndërkohë që duhet të ishte raportuar i barabartë me sasinë e shtresës së binderit 5,414.2m². Diferenca midis sasisë së raportuar me sasinë e llogaritur $5,780.6m^2 - 5,414.2m^2 = 366.4 m^2$ që përbën vlerën **80,608 lekë pa TVSH, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit, kjo vlerë përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “3.158/5a -Transport dheu me auto deri në 5.0 km” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1,582.6 m³ dhe në vlerën 69,634.4 lekë, ky zë pune është llogaritur në mënyrë të gabuar pasi duhet të ishte raportuar si rezultat i diferencës së zërave të gërmimeve me zërin “3.47/1b -Mbushje, rrafshim, ngjeshje materialin të gërmuar më parë” pra do të kemi llogaritjen: $1,186.5 m^3 + 396.1 m^3 - 423.4 m^3 = 1,159.2 m^3$ kjo sasi përbën sasinë e llogaritur e cila duhet të ishte raportuar në situacion. Diferenca midis sasisë së raportuar me sasinë e llogaritur $1,582.6 m^3 - 1,159.2 m^3 = 423.4m^3 \times 44 \text{ lekë/m}^3 = \mathbf{18,630 \text{ lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.}}$

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “2.552-Tub betoni Ø 200 mm në bazament për

montimin e shtyllave” i raportuar në situacionin përfundimtar në vlerën 15,435 lekë; sipas fotografive të vëna në dispozicion në dosjen tekniko-ligjore vihet re se ky zë pune nuk është realizuar me tuba betoni por fiksimi i shtyllave është kryer me tuba korrogato. **Vlera 15,435 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “*Analizë F.V Stola me skelet metalik dhe ndenjese druri*” i raportuar në situacionin përfundimtar sasinë 15 copë në terren u konstatua se ishin vendosur 14 copë. **Vlera e një stoli i cili u gjet në mangësi prej 13,230 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize “*Analizë F.V Kosha për hedhjen e mbeturinave*” i raportuar në situacionin përfundimtar sasinë 30 copë në terren u konstatua se ishin vendosur 14 copë. Vlera e 16 koshave të cilët u gjetën në mangësi llogaritet në vlerën 493,920 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën 621,823 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

-Mbikëqyrësi i punimeve OE “*V. E.*” shpk në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 57-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **621,823 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria OE “*Z.*” ShPK.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurat e prokurimit me objekt: “**Blerje mobilje për sallën e muzeut**”, referuar Procesverbalit të marrjes në dorëzim rezultoi se, lëvrimi i mallit nga OE fitues “*K. B.*” nuk është bërë (sipas përcaktimit në DST) brenda 24 orëve duke filluar nga momenti i publikimit në Sistemin Elektronik të njoftimit të fituesit,. Njoftimi i Fituesit në SPE është mbajtur në datën 05.06.2023 dhe malli është lëvruar datë 05.10.2023, pra 4 muaj me vonesë. Nga autoriteti Kontraktor nuk është aplikuar penalti prej 175,000 lekë (4/1000 për ditë vonese jo më shumë se 25% të vlerës së kontraktuar) për vonesën në lëvrimin e mallit sipas DST.

Veprime në kundërshtim, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” si dhe Udhëzimin Nr.5, date 25.06.2021 “*Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik i APP*”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 57-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Titullarit të njësisë publike Bashkisë Tropojë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme, në vlerën **175,000 lekë** si penaltit për vonesën e dorëzimit të mallrave nga Subjekti *K. B.*

Menjëherë

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë të Taksave vendore u konstatua se ushtrimi i aktivitetit gjatë vitit 2024 të subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore, ka sjell të ardhura të munguara për Bashkinë Tropojë në vlerën prej 5,201,096 lekë nga subjektet: “P.” në vlerën 480,000 lekë, “A. A.” në vlerën 800,000 lekë, “H. 1” në vlerën 900,000 lekë, “S.” (L. Dardania) në vlerën 800,000 lekë, “S.” (Sopot) në vlerën 721,096 lekë, “E. Oksigjen” në vlerën 900,000 lekë, “D.-Oil” në vlerën 900,000 lekë. Këto detyrime të cilat konsiderohen të ardhura të munguara(dhe dëm ekonomik), janë krijuar nga mos zbatimi i përcaktimeve ligjore të:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9, si dhe:

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, kreu II, pika 14; pasi subjektet duhej të pajiseshin me autorizimin përkatës vetëm pas kryerjes së plotë të pagesës prej 1,000,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 15-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, nga subjektet: “P.” në vlerën 480,000 lekë, “A. A” në vlerën 800,000 lekë, “H. 1” në vlerën 900,000 lekë, “S” (L.Dardania) në vlerën 800,000 lekë, “S” (Sopot) në vlerën 721,096 lekë, “E. Oksigjen” në vlerën 900,000 lekë, “D.-Oil” në vlerën 900,000 lekë si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve. Bashkia Tropojë të ndërpresë praktikën e hartimit të aktmarrëveshjeve për pagesën me këste të detyrimit të për pajisjen me autorizim për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë të Taksave vendore u konstatua se sipas Censurit dhe dokumentacionit të gjendjes civile në Bashkinë Tropojë dhe NJA janë 9450 familje, ndërkohë në vitin 2024 janë taksuar/tarifuar 1399 familje, ose 8051 familje më pak. Në të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e Shërbimit (pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit) për qytetin Tropojë dhe NJA, për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim mesatarisht 2500 lekë tarif/taksë(për familje sipas paketës fiskale për NjA Bajram Curri) * 2373 familje të pa taksuara = 5,932,500 lekë, si dhe 1250 lekë tarif/taksë (për familje sipas paketës fiskale për NjA të tjera) * 5678 familje të pa taksuara = 7,097,500 lekë. Pra në total, për mos tarifimin/taksimin e të gjitha familjeve të Bashkisë kemi të paktën 13,030,000 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.

–Situata e mësipërme, vazhdojnë të tregojë se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018 , e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në këtë drejtim kërkohet

më tepër përkushtim nga Bashkia Tropojë duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Tropojë dhe NJA.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; kapitulli II pika II.1 Tabela 11 në Paketën Fiskale të Bashkisë Tropojë. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 15-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrin masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2024, rezultojnë 13,030,000 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2023 është në vlerën 33,117,410 lekë, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2024 është 6,490,214 lekë dhe pakësimet gjatë vitit 2024 janë 4,508,771 lekë, gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2024 është në vlerën **35,098,853 lekë**.

Sa më sipër, në krahasim me vitin 2023, borxhi është rritur me 6,364,038 lekë (rreth 7%), e cila mund të krijohet si rezultat i mos njoftimit në mënyrë të rregullt i individëve apo i subjekteve të cilët mund të mos jenë të vetëdijshëm për borxhin e krijuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 15-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Tropojë, të marrin masa konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjorë të parashikuar për mbledhjen me forcë të detyrimeve të papaguara me qëllim uljen e borxhit nga taksat dhe tarifat vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë të Taksave vendore u konstatua se për Bashkinë Tropojë, konstatohet se nga drejtoria e PZHT, nuk është ndërmarrë asnjë masë, qoftë edhe komunikim shkresor me ASHK-në, për tu informuar dhe për të përditësuar regjistrat për ndërtimet të cilat janë legalizuar vitet e fundit, me qëllim vjeljen e taksës. Pasi taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, gjithashtu parashikuar edhe në Paketën Fiskale miratuar me nr.47 datë 11.12.2023, të Bashkisë Tropojë, pika 1.4, tabela nr.7 (0.5% e vlerës së investimit).

Sa më sipër, grupi i auditimit nga informacioni marrë nga DVASHK-së Kukës, konstatoj se nga Janar 2023-në Tetor 2024, janë legalizuar të paktën 11,337.13 m² ndërtim, duke e llogaritur me kosto mesatare sipas EKB me vlerën 32,899 lekë, rezulton një investim prej 372,975,963 lekë, nga i cili lind detyrimi taksës prej 0.5% **në vlerën 1,864,879 lekë, të cilat janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.** *(Më hollësisht trajtuar në faqet 15-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të pronave u konstatua se Bashkia Tropojë ka dhënë me qira ish Hotelin e punëtorëve për banesa sociale ku ka lidhur 15 kontrata qiradhënie. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arkëtimet për këto 15 kontrata qiraje rezulton se, në fund të vitit 2024 janë debitorë 3 familje në vlerën 81,600 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

- Nga shoqëritë koncesionare që kanë lidhur kontratë qiraje për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë rezulton se, 7 kanë paguar detyrimet sipas kontratave dhe 3 nuk ka shlyer detyrimet kontraktuale. Subjektet me detyrime janë si më poshtë:

-“A.T.A. E. E.” SHPK me NIPT: L.....E ka lidhur kontratë qiraje me Bashkinë Tropojë për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor me nr. 2365/7, datë 24.08.2017 “Shtirrije Tubacioni për ndërtim HEC “Fierzë”. *Për vitin 2024 kjo Shoqëri Koncesionare nuk ka shlyer detyrimet kontraktore të akumuluar në vlerën 2,367,435 lekë, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.*

-“Sh.-Al” SHPK me Nipt: K.....N ka lidhur kontratë qiraje me Bashkinë Tropojë për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor me nr. 3359/5, datë 06.12.2018 “Shtirrije Tubacioni për ndërtim HEC Bujan”. *Për vitin 2024 kjo Shoqëri Koncesionare nuk ka shlyer detyrimet kontraktore të akumuluar në vlerën 606,520 lekë, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.*

-“HEC V. 1 & 2” SHPK me Nipt: L.....T ka lidhur kontratë qiraje me Bashkinë Tropojë për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor me nr. 2705/5, datë 24.07.2019 “Shtirrije Tubacioni për ndërtim HEC Bujan”. *Për vitin 2024 kjo Shoqëri Koncesionare nuk ka shlyer detyrimet kontraktore të akumuluar në vlerën 6,305,112 lekë, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.*

- Në Bashkinë Tropojë gjatë vitit 2024 kanë ushtruar aktivitet minerar 11 subjekte, të cilat kanë kontrata ekziktuese qiraje me bashkinë për të shfrytëzuar sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor. *Detyrimet financiare që subjektet minerare kanë kundrejt bashkisë deri më 31.12.2024 arrijnë vlerën 3,128,000 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë. (Më hollësisht trajtuar në faqet 82-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Sektori i Pronave në bashkëpunim me Sektorin Juridik Bashkia Tropojë të marrin masa të menjëhershme dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerave konkretisht: nga 3 familje qira në ish Hotelin e punëtorëve për vlerën 81,600 lekë; “A.T.A. E. E.” Shpk për vlerën 2,367,435 lekë; “Sh.-Al” Shpk për vlerën 606,520 lekë; -“HEC V. 1 & 2” Shpk për vlerë 6,305,112 lekë; nga 11 subjekte, të cilat kanë kontrata ekzistuese qiraje me bashkinë për të shfrytëzuar sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor për vlerën 3,128,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga Auditimi i procedurave të prokurimit, rezultoi se në dy raste operatorë ekonomikë u skualifikuan për mangësi të ngjashme me ato të operatorëve të shpallur fitues, kryesisht në pjesën e vetëdeklarimeve:

- Në procedurën e Prokurimit “Rikonstruksion i Rrugës Fshati Kasaj” me fond limit 79,863,397 lekë pa TVSH. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE rezulton se shkualifikimi i OE “Sh.” nuk është i bazuar në prova e fakte të plota po për mangësi e devijime të vogla që mund të kërkohej sqarim me shkrim nga subjekti. Veprim që ka sjellë *një efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Tropojë për 1,943,468.4 lekë pa TVSH* ardhur nga diferenca e ofertës së shpallur fituese e OE “N.” prej 57,519,605.40 lekë dhe ofertës të shkualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të OE “Sh.” prej 55,576,137.00 lekë pa TVSH.

- Në procedurën e Prokurimit “Rehabilitimi i Ujëmbledhësit Zherka 1-2” me fond limit 9,739,487.45 lekë pa TVSH. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE rezulton se shkualifikimi i BOE “B. & H.” nuk është i bazuar në prova e fakte të plota po për mangësi e devijime të vogla që mund të kërkohej sqarim me shkrim nga subjekti, ose paraqitjen e dokumentacioni shtesë, veprim që ka sjellë ***një efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Tropojë për 162,517.8 lekë pa TVSH*** i ardhur nga diferenca e ofertës së shpallur fituese e OE “A. I.” prej 8,090,904.0 lekë dhe ofertës të shkualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të BOE “B. & H.” prej 7,928,386.2 lekë pa TVSH. Veprime në kundërshtim me nenet 2 dhe 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 29-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrejë një grupi pune për verifikimin e pasaktësive, dhe identifikimin e shkaqeve dhe përgjegjësive që kane shkaktuar problematiken me efekt financiar negativ në buxhetin e Shtetit.

1.2. Rekomandimi: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Bashkisë Tropojë marrë masa për garantimin e përdorimit me efektivitet të fondeve në dispozicion, duke vlerësuar me kujdes dhe paanshmëri mangësitë që çojnë në skualifikimin e operatorëve ekonomik, sidomos në rastet kur kjo vendimmarrje shoqërohet me pasoja financiare.

Menjëherë e në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 15 geramat (b, c, ç); nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, në Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neni 37 i Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Titullarit të Bashkisë Tropojë, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion, me përgjegjësitë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT